



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

BPK

RAPORT VJETOR

2005

Prishtinë, maj 2006

PËRMBAJTJA

Fjala Përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm drejtuar PSSP-së _____	11
Anëtarët e Bordit Drejtues, Komitetit të Auditimit dhe Komitetit Ekzekutiv _____	13
Struktura Organizative e BPK-së _____	14
1. Përmbledhje Ekzekutive _____	17
2. Zhvillimet Ekonomike Botërore _____	21
2.1. Ekonomia Botërore _____	21
2.2. Bashkimi Evropian _____	24
2.3. Ballkani Perëndimor _____	29
3. Zhvillimet Ekonomike në Vend _____	37
3.1. Sektori Real _____	40
3.1.1. Prodhimi i Brendshëm Bruto _____	40
3.1.2. Çmimet _____	44
3.1.3. Punësimi _____	45
3.1.4. Privatizimi _____	47
3.2. Sektori Fiskal _____	48
3.2.1. Të Ardhurat Buxhetore _____	49
3.2.2. Shpenzimet Buxhetore _____	49
3.2.3. Skema Pensionale _____	51
3.3. Sektori Financiar _____	52
3.3.1. Karakteristika të Përgjithshme _____	52
3.3.2. Zhvillimet në Sektorin Bankar _____	56
3.3.3. Zhvillimet në Kompanitë e Sigurimeve _____	77
3.3.4. Zhvillimet në Fondet Pensionale _____	78
3.3.5. Zhvillimet në Ndërmjetësuesit e Tjerë Financiarë _____	79
3.4. Sektori i Jashtëm _____	80
4. Mbikëqyrja Financiare _____	84
4.1. Veprimtaria Rregullative e Sektorit Financiar _____	85
4.2. Veprimtaria Mbikëqyrëse dhe Zbatuese _____	86
4.2.1. Licencimi dhe Struktura _____	86
4.2.2. Veprimtaritë e Mbikëqyrjes Financiare _____	89
4.2.3. Autoritetet Formale të Mbikëqyrëse (Masat Zbatuese) _____	94
4.3. Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar _____	94
5. Shërbimet dhënë Autoriteteve, Komunitetit Financiar dhe Publikut _____	98
5.1. Operacionet e <i>Cash</i> -it dhe Manaxhimi _____	97

BPK Raport Vjetor 2005

5.2. Shërbimet për Thesarin _____	102
5.3. Manaxhimi i Mjeteve _____	103
5.4. Shërbimet për Komunitetin Financiar _____	106
5.4.1. Sistemi i Pagesave _____	106
5.4.2. Kos-Giro _____	108
5.4.3. Regjistri i Kredive të Kosovës _____	109
5.5. Veprimtaritë lidhur me Kërkimet dhe Statistikat _____	110
6. Zhvillimet e Brendshme _____	112
6.1. Drejtimi dhe Kontrolli i Brendshëm _____	112
6.2. Zhvillimet në Burimet Njerëzore _____	115
7. Pasqyrat Financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës _____	120
8. Shtojca Statistikore _____	160

Listë e grafikëve, tabelave dhe bokseve
Grafikë

1. Kursi i këmbimit të euros kundrejt GBP, USD, JPY, 2003 – 2005	22
2. Rritja e PBB-së reale në SHBA dhe kontributi sipas përbërësve, 2002 – 2005	23
3. Rritja e PBB-së reale në Japoni dhe kontributi sipas përbërësve, 2002 – 2005	24
4. Rritja e PBB-së reale në euro zonë dhe kontributi sipas përbërësve, 2002 – 2005	26
5. Inflacioni (ndryshimi në IHÇK-në vjetore), euro zonë, 2004 – 2005	25
6. Prodhimi i Brendshëm Bruto (vjetore), Ballkani Perëndimor, 2003 – 2005	29
7. Inflacioni (ndryshimi në IÇK-në vjetore) në Ballkanin Perëndimor, 2003 – 2005	29
8. Kursi i këmbimit të euros kundrejt HRK, ALL, CSD, MKD, ROL, 2003 – 2005	30
9. Bilanci fiscal dhe i llogarisë korrente si % ndaj PBB-së, Ballkani Perëndimor, 2003 – 2005	31
10. Rritja e PBB-së, çmimet konstante të vitit 2002, 2001 – 2005	40
11. Kërkesa private, 2000 – 2005	41
12. Kërkesa e qeverisë, 2000 – 2005	42
13. Kërkesa donatore, 2000 – 2005	42
14. Të Ardhurat Kombëtare Bruto të Disponueshme (AKBD), 2000 – 2005	43
15. Çmimet (IÇK), mesatare vjetore, 2001 – 2005	44
16. Numri i punëkërkesve të regjistruar, të dhëna rrjedhëse, 2001 – 2005	46
17. Numri i punëkërkesve të regjistruar sipas moshës, deri në vitin 2005	46
18. Të ardhurat kumulative nga procesi i privatizimit	47
19. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK), 2000 – 2005	48
20. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës – Struktura e të ardhurave, 2004 dhe 2005	49
21. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës – Struktura e shpenzimeve, 2004 dhe 2005	50
22. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, shuma kumulative, 2002 – 2005	51
23. Struktura e pretendimeve të brendshme (në mijë euro), 2004 and 2005	52
24. Pretendimet e korporatave financiare ndaj jorezidentëve, 2004 and 2005	53
25. Paraja e gjerë, 2000 – 2005	54
26. Bankat e nivelit të dytë Indeksi Herfindahl-Hirschman, 2001 – 2005	58
27. Struktura e aseteve të bankave të nivelit të dytë në Kosovë, 2001 – 2005	59
28. Struktura e kredive sipas sektorit, 2002 – 2005	60
29. Struktura e kredive sipas industrisë për vitin 2004 dhe 2005	61
30. Struktura e maturitetit të kredive, 2002 – 2005	62
31. Totali i aseteve dhe kredive të sektorit bankar si % ndaj PBB-së, disa vende të Ballkanit Perëndimor	63
32. Zhvillimi i strukturës së detyrimeve të bankave të nivelit të dytë në Kosovë, 2001 – 2005	64
33. Struktura e depozitave sipas maturitetit, 2001 – 2005	65
34. Struktura e depozitave sipas sektorëve për vitin 2004 dhe 2005	67

35. Totali i depozitave të sektorit bankar si % ndaj PBB-së për vitin 2005 (disa vende të Ballkanit Perëndimor)	68
36. Struktura e të ardhurave, 2001 – 2005	69
37. Struktura e shpenzimeve, 2001 – 2005	70
38. Treguesit e kthimit, 2000 – 2005	71
39. Treguesit e efikasitetit, 2001 – 2005	72
40. Zhvillimi i treguesve të likuditetit të bankave të nivelit të dytë, 2000 – 2005	72
41. Klasifikimi i maturitetit të kredive dhe depozitave të bankave të nivelit të dytë, fundi i vitit 2005	73
42. Zhvillimi i Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (RMK) në Kosovë, 2002 – 2005	74
43. Treguesit e rentabilitetit të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor për vitin 2005	75
44. Treguesit e efikasitetit të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor në vitin 2005	76
45. Raporti i kredive ndaj depozitave në disa vende të Ballkanit Perëndimor për vitin 2005	76
46. Zhvillimi i veprimtarisë kredituese të ndërmjetësve të tjerë financiarë, 2000 – 2005	80
47. Struktura e eksporteve sipas shteteve dhe grupmallrave, në %, fundi i vitit 2005	82
48. Struktura e importeve sipas shteteve dhe grupmallrave, në %, fundi i vitit 2005	82
49. Furnizimi me kartëmonedha euro	98
50. Furnizimi me monedha euro	98
51. Kartëmonedhat e njollosura të hequra nga qarkullimi në vitin 2005	100
52. Raporti i kartëmonedhave të reja të furnizuara ndaj totalit	100
53. Kartëmonedhat e raportuara të falsifikuara	101
54. Zhvillimi i depozitave të Thesarit dhe të IPVQ-ve të tjera dhe të ATK-së, 2004 – 2005	102
55. Burimet financiare sipas origjinës, fundi i vitit 2005	104
56. Shpërndarja e burimeve të BPK-së, fundi i vitit 2005	105
57. Cilësia e aseteve të investimeve të BPK-së, fundi i vitit 2005	105
58. Zhvillimi i vëllimit të transaksioneve SNK (të dhëna standarde), 2002 – 2005	107
59. Zhvillimi i vlerës së transaksioneve SNK (të dhëna standarde), 2002 – 2005	107

Tabela

1. Treguesit Kryesorë Makroekonomikë, 2001 – 2005	38
2. Veprimtaria e Kompanive të Sigurimeve, 2001 – 2005	77
3. Bilanci i Pagesave, nga vitin 2001 në 2005	81
4. Veprimtaria Licencuese e Sigurimeve, 2002 – 2005	88
5. Veprimtaria e Fondeve Pensionale, 2002 – 2005	88
6. Veprimtaria Licencuese e Ndërmjetësuesve, 2002 – 2005	88
7. Sektori Financiar: Inspektimet në vend të kryera gjatë vitit 2005	93
8. Trajnimet në Kosovë gjatë vitit 2005	117
9. Trajnimet jashtë Kosovës gjatë vitit 2005	118
10. Pasqyrë e Korporatave Financiare	160

11. Pasqyrë e Korporatave Depozituese	161
12. Agregatët Monetarë	162
13. Pasqyrë e BPK-së	163
14. Pasqyrë e Korporatave të Tjera Depozituese	164
15. Pasqyrë e Korporatave të Tjera Financiare	165
16. Pasqyrë e Ndërmjetësuesve të Tjerë Financiarë	166
17. Pasqyrë e Kompanive të Sigurimeve dhe të Fondeve Pensionale	166
18. Pasqyrë e Kompanive të Sigurimeve	167
19. Pasqyrë e Fondeve Pensionale	167
20. Bilanci i Korporatave të Tjera Depozituese – Asetet	168
21. Bilanci i Korporatave të Tjera Depozituese – Detyrimet	169
22. Depozitat Euro në KTD, sipas Maturitetit Fillestar	170
23. Depozitat Jo-Euro në KTD, sipas Maturitetit Fillestar	171
24. Kreditë e KTD-ve, sipas Maturitetit Fillestar	171
25. Kreditë e KTD-ve, sipas Industrisë	172
26. Normat Efektive të Interesit të KTD-ve	173
27. Pasqyra e të Ardhurave të KTD-ve	174
28. Sistemi Ndërbankar i Kleringut në BPK	174
29. Eksportet dhe Importet, sipas Partnerëve Tregtarë	175
30. Eksportet, sipas Grupmallrave	176
31. Importet, sipas Grupmallrave	176

Bokset

1. Statusi ligjor i euros në Kosovë	56
2. Asetet dhe Sfidat e Euroizimit në Kosovë	56
3. Përmasa dhe roli i ndërmjetësimit të sistemit bankar në Ballkanin Perëndimor	63
4. Depozitat e sistemit bankar si % ndaj PBB-së në vendet e Ballkanit Perëndimor	68
5. Rentabiliteti, Likuiditeti dhe Aftësia Paguese e sektorit bankar në disa vende të Ballkanit Perëndimor	74

Listë e shkurtesave

ATM	Bankomat
BPK	Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës
RMK	Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
NJIFV	Njësia Investiguese e Falsifikimit të Valutës
IÇK	Indeksi i Çmimit të Konsumit
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
AER	Agjencia Evropiane për Rindërtim

BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BE	Bashkimi Evropian
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IRJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
AKBD	Të Ardhura Kombëtare Bruto të Disponueshme
IHH	Indeksi i Herfindalf – Hirschman
IHÇK	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit
SNK	Sistemi Ndërbankar i Kleringut
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ONMP	Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KEK	Korporata Energjitike e Kosovës
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
ATK	Agjencia e Trustit të Kosovës
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MM	Memorandumi i Mirëkuptimit
MHN	Mjete të Huaja Neto
OJSHEF	Organizata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
KTD	Korporata të Tjera Depozituese
KTF	Korporata të Tjera Financiare
NTF	Ndërmjetësuesit e Tjerë Financiarë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes
PSH	Pikat e Shitjeve
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, SH.A.
MPRR	Mjete të Ponderuara me Rrezik
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
TPL	Third Party Liability
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

I nderuari z. Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara,

Gjatë viteve të fundit, sektori financiar i Kosovës, me asistencën e komunitetit ndërkombëtar, ka arritur një progres të dukshëm në dhënien e shërbimeve financiare, duke favorizuar në këtë mënyrë rrugën e saj drejt një ekonomie tregu. Pavarësisht nga kushtet e vështira ekonomike që karakterizuan territorin, gjatë vitit 2005 sektori financiar ka rritur vëllimin e ofertës për të gjithë aktorët, ekonomitë familjare, si dhe për sektorin e korporatave. BPK-ja ka dhënë ndihmën e saj në zhvillimin e këtyre shërbimeve duke siguruar një mjedis të duhur rregullativ dhe mbikëqyrës, duke nivelizuar gjithashtu shkallën e shërbimeve të saj për ekonominë në vend.

Pas rritjes reale të PBB-së në vitin 2004 prej 3.7%, ndikuar në mënyrë të ndjeshme nga deficit i madh buxhetor gjatë vitit të kaluar, veprimtaria ekonomike u ngadalësua ndjeshëm në vitin 2005, me një rënie të PBB-së prej 0.5%, në terma realë. Vetëm sektori privat dha një kontribut të vogël pozitiv në rritjen ekonomike, ndërkohë që sektori i jashtëm dhe sektori publik i Kosovës patën një kontribut negativ në ekonominë e vendit. Përgjithësisht, veprimtaria e sektorit privat u mbështet nga një rritje e lartë e huadhënies bankare (+37,5%). Zgjerimi i sektorit bankar ka sjellë një rritje të lartë të fondeve (kryesisht rritje të depozitave), ndonëse kjo rritje nuk është mbështetur për shkak të mungesës së projekteve të mira bankare. Me fjalë të tjera, oferta e parasë ka siguruar fonde të mjetueshme për huamarrësit e vegjël dhe të mesëm, me përjashtim të huamarrësve të mëdhenj, ndërkohë që inisiativat e investimit nga sipërmarrësit e mëdhenj në sektorë të rëndësishëm ende janë shumë të pakta.

Dhënia e shërbimeve në sektorin e sigurimeve përgjithësisht mbetet e kufizuar në kontratat e sigurimit të detyrueshëm të automjeteve, me zgjerim tejet të vogël ose aspak ekzistues në segmente të tjera, si p.sh. sigurimi ndaj rreziqeve industriale, sigurimi i ekonomive familjare apo sigurimi i jetës. Në sajë të asistencës teknike nga agjencitë ndërkombëtare, kuadri rregullativ i sektorit financiar në tërësi i është përafuar standardeve ndërkombëtare; ky kuadër është përmirësuar në shumë aspekte, por ajo duhet të përditësohet në disa fusha, si p.sh. qeverisja dhe kontrolli i brendshëm. Në periudhën afatshkurtër, zhvillimi i një kuadri rregullativ është gjithashtu i nevojshëm për të mbështetur dhënien e shërbimeve të reja financiare, siç janë qiradhënia dhe sigurimi i jetës.

Në kontekstin e zgjerimit të tregut të huadhënies, BPK-ja ka qenë e vendosur në mosuljen e standardeve të saj rregullative dhe mbikëqyrëse, dhe ka shfaqur gatishmëri në zbatimin e rregulloreve në rastet e mospajtueshmërisë së tyre. Së pari, zgjerimi i madh i huadhënies nga të gjitha bankat në gjysmën e parë të vitit, bëri që BPK-ja të vendoste rregulla më të rrepta për disa institucione për

mbajtjen e nivelit të duhur të kapitalit, riskut të kredisë dhe likuiditetit. Së dyti, për mbajtjen e një sistemi të shëndoshë dhe të sigurtë, BPK-ja, në bazë të inspektimeve të saj në vend, ka nxitur përmirësimin e procedurave të qeverisjes, të kontrollit të brendshëm, si dhe ka inkurajuar praktikën e mira profesionale dhe manaxhuese. Një masë e tillë nga BPK-ja bëri që në mars 2006, një institucioni huadhënës t'i revokohej licenca për mospajtueshmëri me rregullat dhe praktikën e lartpërmendura.

Lidhur me veprimtarinë e saj qendrore bankare, BPK-ja ka ndërmarrë disa inisiativa për të përmirësuar shërbimet e saj ndaj komunitetit financiar, Institucioneve të Përkohshme të Vetë-Qeverisjes, dhe publikut në tërësi. Për shembull, është rritur cilësia dhe sasia e furnizimit me para *cash* (kartëmonedha dhe monedha euro); ka filluar të operojë një sistem pagesash *jo-cash* (sistemi *giro*); regjistri i kredive është zgjeruar, konsoliduar dhe është bërë i detyrueshëm; sistemi i mbledhjes së statistikave për bilancin e pagesave është konsoliduar; funksioni i kërkimeve është përmirësuar, etj.

Në aspektin ndërkombëtar, BPK-ja ka zvogëluar izolimin e saj nga organizatat profesionale dhe zyrtare. Për shembull, BPK-ja është bërë Anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, si edhe e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Fondit Pensional; ka marrë pjesë në organizime të ndryshme rajonale, duke përfshirë konferencat e mbikëqyrësve bankarë. Gjithashtu, BPK-ja ka nënshkruar disa Memorandume Mirëkuptimi me vendet e rajonit.

Progrese të mëdha dhe të dukshme janë bërë në drejtim të delegimit të pozicioneve të larta drejtuese në BPK stafit vendor; në fillim të vitit 2006, dy pozicionet e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm iu deleguan stafit kosovar. Përsa i përket rritjes së pjesëmarrjes të kosovarëve në Bordin Drejtues, duhet theksuar se për këtë është hartuar një projektligj me mbështetjen ndërkombëtare, i cili pritet të miratohet së shpejti. Në kontekstin e ndryshimeve institucionale, të cilat do të ndodhin në Kosovë gjatë viteve 2006 dhe 2007, BPK-ja do t'i përkushtojë të gjitha mjetet dhe mundësitë e saj për kryerjen e detyrave të ngarkuara në mënyrën më të pavarur dhe profesionale, me synim integrimin e sektorit financiar në organizatat rajonale. Dhe këtu nuk ka nevojë të theksohet se kjo është mënyra e vetme për të përballuar sfidat e mëdha që gjenden përpara Kosovës. Këto sfida lidhen me vështirësitë aktuale ekonomike që do të vazhdojnë edhe pas vitit 2006, si dhe me mangësitë strukturore të ekonomisë në vend.

Në këtë kontekst, kam kënaqësinë t'ju paraqes Raportin Vjetor të BPK-së për vitin 2005.

Michel Svetchine

Drejtor i Përgjithshëm

Deri më 31 dhjetor, 2005, Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Bordi Drejtues i BPK-së:

- Z. Ajri Begu, Kryetar i Bordit Drejtues,
- Z. Michel Svetchine, Drejtor i Përgjithshëm i BPK-së,
- Z. Edward Nolan, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Mbikëqyrjen e Sektorit Financiar,¹
- Z. Benoit Waelkens, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Sistemin e Pagesave,²
- Z. Joachim Rücker, ZPSSP, Shtylla BE e UNMIK-ut,
- Z. Gazmend Luboteni, Profesor, Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës
- Zj. Chiara Bronchi, Kryetare e Zyrës për Çështje Fiskale – Shtylla BE e UNMIK-ut

Komiteti i Auditimit të Bordit Drejtues të BPK-së:

- Z. Gazmend Luboteni, Profesor, Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës
- Zj. Chiara Bronchi, Kryetare e Zyrës për Çështje Fiskale – Shtylla BE e UNMIK-ut


Komiteti Ekzekutiv i BPK-së:

- Z. Michel Svetchine, Drejtor i Përgjithshëm i BPK-së,
- Z. Edward Nolan, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Mbikëqyrjen e Sektorit Financiar
- Z. Hashim Rexhepi, Zyrtar Kryesor i Mbikëqyrjes
- Z. Benoit Waelkens, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Sistemin e Pagesave
- Z. Gani Gërguri, Zyrtar Kryesor i Operacioneve
- Z. Agron Dida, Inspektor i Përgjithshëm

¹ Zëvendësuar nga z. Hashim Rexhepi në shkurt 2006;

² Zëvendësuar nga z. Gani Gërguri në janar 2006.

Skema organizative e BPK-së deri më 31 dhjetor 2005



1. Përmbledhje Ekzekutive

Synimet e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës janë që të sigurojë një sistem financiar të shëndoshë, efikas dhe konkurrues, një sistem efikas të pagesave, të kryejë analiza të rregullta ekonomike dhe monetare si dhe të informojë publikun mbi zhvillimet kryesore ekonomike. Për këtë qëllim, BPK-ja publikon për të gjashtin vit me radhë Raportin e saj Vjetor, në të cilin përshkruan tendencat në ekonominë botërore, rajonin, dhe duke i kushtuar një vëmendje të veçantë ekonomisë së Kosovës dhe zhvillimeve të brendshme brenda BPK-së.

Ekonomia botërore pësoi një rënie gjatë vitit 2005, krahasuar me vitin 2004, dhe çmimet më të larta të naftës me ndikim mbi inflacion kontribuan negativisht në rritjen ekonomike globale. Rritja ekonomike vijoi të ndikohet nga ecuria e lartë ekonomike e Kinës, shoqëruar nga rritja e ekonomisë së SHBA-së dhe BE-së, edhe pse rritja reale në BE pësoi një rënie në vitin 2005.

Vendet e Ballkanit Perëndimor arritën një zhvillim të favorshëm ekonomik, i karakterizuar nga rritja e lartë e PBB-së reale (mesatarisht 5.0%) dhe nga stabiliteti makroekonomik. Megjithatë, ndryshimet ndërmjet vendeve të rajonit lidhur me ecurinë e reformave dhe atë ekonomike janë ende të dukshme. Pavarësisht politikave të shëndosha fiskale, inekuilibrat e jashtëm mbeten shqetësuese. Në shumë vende, rritja e PBB-së u ndikua në një masë të madhe nga konsumi privat, mbështetur kryesisht nga kreditë dhënë nga sektori bankar. Për rrjedhojë, në disa vende ballkanike bilanci i jashtëm u përkeqësua.

Zhvillimet në ekonominë e Kosovës në vitin 2005 nuk ishin të favorshme. Kosova përjetoi një rritje negative të PBB-së reale prej -0.5%, kryesisht për shkak të zvogëlimit të pranisë ndërkombëtare (duke përfshirë UNMIK-un dhe komunitetin donator). Shifrat e larta e papunësisë dhe inekuilibrat e jashtëm mbeten probleme kyçe të ekonomisë. Sipas vlerësimeve të FMN-së, shifrat e papunësisë vlerësohen të jenë në masën 30% të popullsisë të aftë për punë. Deficiti në llogarinë korrente (përpara asistencës së huaj) u llogarit në masën 29.1% të PBB-së në vitin 2005. Deficiti tregtar, si një nga problemet më të mëdha të ekonomisë së Kosovës, në vitin 2005 arriti në 854 milionë euro, ose në 35% të PBB-së.

Për të dytin vit me radhë, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) u mbyll me deficit. Megjithatë, ky deficit në vitin 2005 u zvogëluar në 3.9% të PBB-së krahasuar me 5.3% në vitin 2004. Mjaft përpjekje

janë bërë për mirëmbajtjen e një buxheti të ekuilibruar dhe një politike të shëndoshë fiskale, si parakushtin kryesor për stabilitetin makroekonomik. Në këtë kontekst, UNMIK-u dhe IPVO-të, me asistencën e FMN-së dhe duke u mbështetur në një kontekst makroekonomik realist afat-mesëm, i janë drejtuar komunitetit ndërkombëtar donator me një Letër Mirëkuptimi, me qëllim dhënien e arsyeve për mbështetje donatore.

Përdorimi i monedhës euro ka krijuar kushtet për një inflacion të ulët dhe mjedis të qëndrueshëm makroekonomik. Instrumentet e politikës duhet të adresohen në drejtim të ndryshimeve strukturore që lidhen kryesisht me privatizimin, autoritetin e ligjit, etj. Viti 2005 mund të konsiderohet i suksesshëm në aspektin e zhvillimit të procesit të privatizimit të drejtuar nga Agjencia e Trustit të Kosovës (ATK), me synim kthimin në pronësi private të ndërmarrjeve me pronësi shoqërore. Gjithashtu, një nga synimet e ATK-së mbetet përmirësimi i qeverisjes së Ndërmarrjeve Publike të Kosovës.

Spektori financiar në Kosovë vazhdon të jetë i mbizotëruar nga bankat e nivelit të dytë. Gjatë vitit 2005, bankat vijuan zgjerimin e degëve të tyre në mbarë territorin kosovar, përmirësuan shërbimet e dhëna prej tyre dhe rritën rolin e tyre ndërmjetësues. Spektori bankar në Kosovë ruajti rritjen e përgjithshme financiare dhe për pjesën më të madhe të bankave kushtet në vitin 2005 kanë qenë të favorshme në drejtim të rentabilitetit, likuiditetit dhe kapitalizimit.

Bankat vazhdojnë të përmirësojnë rolin e tyre në dhënien e ndërmjetësimit për ekonominë vendore dhe rezultatet janë të konsiderueshme dhe të krahasueshme me vendet e rajonit. Në fund të vitit 2005, kreditë arritën në 513.8 milionë euro ose 21% të PBB-së, një rritje prej 37.5% krahasuar me fundin e vitit 2004. Duke ndjekur tendencat e periudhave të mëparshme, depozitat në spektorin bankar vazhdojnë të rriten, duke rritur në këtë mënyrë besimin në këtë sektor. Depozitat arritën në 836.6 milionë euro, një rritje prej 20.3% krahasuar me vitin 2004. Raporti i depozitave ndaj PBB-së në vitin 2005 arriti në 34.1%, nga 27.7% në vitin 2004.

Gjatë vitit 2005, BPK-ja vazhdoi të sigurojë një furnizim të duhur me kartëmonedha dhe monedha euro për kryerjen e transaksioneve *cash* në ekonominë e Kosovës. Gjithashtu, BPK-ja ka dhënë shërbime bankare në emër të ose për llogari të Autoriteteve, siç janë Thesari, IPVO-të, ATK-ja dhe kompanitë e mëdha të shërbimeve publike. Këto shërbime konsistojnë kryesisht në mirëmbajtjen e llogarisë dhe operacioneve të pagesave, duke përjashtuar shërbimet kredituese.

Manaxhimi i mjeteve të BPK-së në vitin 2005 vijoi të udhëhiqet nga dispozitat e Rregullores së BPK-së dhe Politika e Investimit, duke nënkuptuar që mjetet e BPK-së u manaxhuan duke marrë parasysh kufizimet e matura të rrezikut, duke i dhënë përparësi sigurisë së kapitalit dhe likuiditetit mbi të ardhurat.

Objekti i BPK-së në dhënien e shërbimeve për komunitetin financiar është që të inkurajojë një sistem efikas dhe të sigurtë të pagesave në vend. Ky synim kryhet përmes Sistemit Ndërbankar të Kleringut (SNK), ku vëllimi dhe vlera e transaksioneve kanalizuar përmes SNK-së janë rritur ndjeshëm gjatë vitit 2005. Përveç kësaj, në vitin 2005 BPK-ja lançoi projektin Kos-giro, me qëllim kryerjen e pagesave me vlerë të madhe dhe të vogël. Ky projekt do të kontribuojë pozitivisht në arritjen e objektivit kryesor të BPK-së në rritjen e efikasitetit të sistemit të pagesave në vend përmes zvogëlimit të parasë *cash* në qarkullim, rritjes së depozitave në bankat e nivelit të dytë dhe përmirësimit të likuiditetit të përgjithshëm.

Me qëllim përmirësimit të infrastrukturës së informacionit të veprimtarisë së institucioneve kredituese, në vitin 2005 BPK-ja vazhdoi zhvillimin e një regjistri modern të kredive, i njohur si Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK), lançuar në fillim të vitit 2006. RKK-ja iu siguron institucioneve kredituese informacione mbi huamarrësit e mundshëm, gjë e cila do të përmirësojë informacionin mbi aftësinë paguese të huamarrësit dhe do të rrisë aksesin e kredive.

Në vitin 2005, BPK-ja përmirësoi funksionin e saj në dhënien e informacioneve për publikun mbi zhvillimet në ekonominë e Kosovës, me theks të veçantë në zhvillimet e sektorit financiar. Kjo u arrit përmes përmirësimit të cilësisë së publikimeve ekzistuese dhe publikimet të reja, si p.sh. Buletini i BPK-së dhe Seritë e Materialeve të Diskutimit.

2. Zhvillimet Ekonomike Botërore³

2.1 Ekonomia Botërore

Ekonomia Botërore, bazuar në vlerësimet e FMN-së, pësoi një rënie gjatë vitit 2005, krahasuar me vitin 2004. Në veçanti, rritja e PBB-së reale gjatë vitit 2005 arriti në 4.3% nga 5.1% në vitin 2004. Rritja ekonomike kryesisht ka rezultuar nga ecuria e lartë e sektorit të shërbimeve, i cili ka kompensuar mjaft ngadalësimin e sektorit të prodhimit dhe atij tregtar. Nga njëra anë, kushtet e favorshme financiare dhe rritja e kërkesës së brendshme kontribuan pozitivisht në rritjen ekonomike, ndërkohë që nga ana tjetër, rritja e çmimeve të naftës dhe ndikimi i tyre mbi inflacion dhanë një kontribut negativ në ekonominë globale. Rritja ekonomike vijoi të ndikohet nga ecuria e lartë ekonomike e Kinës (rreth 9.0%), shoqëruar nga rritja e ekonomisë së SHBA-së (3.5%) dhe rigjallërimi i ekonomisë japoneze (2.5%), ndërkohë që rritja ekonomike në Bashkimin Evropian (25 vende anëtare) pësoi një rënie në vitin 2005 në 1.5%.

Çmimet globale të konsumit përjetuan një rritje të konsiderueshme, veçanërisht në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2005, ndikuar kryesisht nga çmimet shumë të larta të naftës. Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2005, çmimet e naftës patën një tendencë rritëse duke arritur në rreth 52.2 euro për fuçi, ndërkohë që të dhënat për pjesën tjetër të vitit tregojnë për një rënie të çmimeve në mesatarisht 44.6 euro për fuçi. Ndërsa çmimet më të larta të naftës ndikuan negativisht në inflacion, pjesa më e madhe e vendeve arritën të mbanin normën e inflacionit në nivele të qëndrueshme. Në veçanti, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2005, pasuar nga ngadalësimi në rritjen e çmimeve të naftës, inflacioni i IÇK-së disi pësoi rënie dhe mbeti në nivele mesatare. Megjithatë, presionet inflacioniste ishin veçanërisht të dukshme në vendet me ekonomi në tranzicion, të ndjeshme ndaj çmimeve të larta të energjisë.


Inekuilibrat globalë të llogarisë korrente jo vetëm që nuk kanë vazhduar, por dhe janë rritur gjatë vitit 2005, kryesisht si pasojë e deficitit në llogarinë korrente të SHBA-së. Megjithatë, inekuilibrat globalë të llogarië korrente u kundërshtuan disi nga tepricat e llogarisë korrente të Japonisë, Kinës dhe vendeve

³ Zhvillimet në mjedisin e jashtëm ekonomik bazohen në : BERZH 2005, Transition Report; FMN 2005, World Economic Outlook; Komisioni Evropian 2005, "Progress towards meeting the economic criteria for accession: 2005 Country assessment," Enlargement Paper No. 26; Business Monitor International 2006, Emerging Europe Monitor – South East Europe, various issues.

të Lindjes së Mesme (veçanërisht vendet eksportuese të naftës, të ndikuara pozitivisht nga çmimet shumë të larta të naftës).

Përsa i përket zhvillimeve të normës së këmbimit, gjatë vitit 2005 dollari amerikan u vlerësua lehtë ndaj euros, ndërkohë që euro u vlerësua ndjeshëm ndaj jenit japonez. Në fund të vitit 2005, euro qëndronte në 1.19 dollarë amerikanë, e cila tregon për një rënie prej 4.7% ndaj nivelit të vitit të mëparshëm. Nga ana tjetër, në fund të vitit 2005, euro arriti në 140.58 jenë japonezë ose 4.6% më shumë, krahasuar me nivelin e saj në vitin 2004. Euro u vlerësua kundrejt paundit britanik, dhe ishte në nivelin 0.68 GBP në fund të vitit 2005, duke pësuar një rritje prej 0.1% krahasuar me nivelin e vitit të mëparshëm.

Grafik 1. Norma e këmbimit të monedhës euros kundrejt paundit britanik, dollarit amerikan dhe jenit japonez, 2003 - 2005



Burimi: Eurostat (2006)


Ekonomia e **Shteteve të Bashkuara të Amerikës** gjatë vitit 2005 pati një rritje të lartë, edhe pse kjo rritje rezultoi më e ngadaltë sesa në vitin 2004. Në veçanti, rritja e PBB-së reale në Shtetet e Bashkuara ishte mesatarisht 3.5%, e cila është 0.7 pikë përqindje më ulët se në vitin e mëparshëm.

Kontributi më i lartë pozitiv në rritjen ekonomike është dhënë nga kërkesa e brendshme. Më specifikisht, konsumi privat kontribuoi me 2.5 pikë përqindje, shpenzimet e Qeverisë Federale me 0.3 pikë përqindje, ndërkohë që totali i investimeve kontribuoi në rritjen e PBB-së së SHBA-së me 1.1 pikë përqindje. Kontributi negativ në rritjen reale u shënuar nga eksportet neto, me një ngadalësim të konsiderueshëm në eksportet e mallrave dhe një rritje të lartë në import. Megjithatë, bilanci i jashtëm

në shërbime kontribuoi pozitivisht në rritjen e PBB-së së SHBA-së duke ulur disi deficitin e llogarisë korrente. Në përgjithësi, çmimet më të larta të naftës, dy deficitet – deficitin fiskal dhe ai i llogarisë korrente – shoqëruar me borxhin e lartë publik ishin faktorët kryesorë që ndikuan në uljen e rritjes së prodhimit të SHBA-së gjatë vitit 2005 (shiko figurën 2).

Norma vjetore e inflacionit u rrit me 3.4% në vitin 2005 ose 0.1 pikë përqindje më lart se në vitin 2004. Nga ana tjetër, inflacioni u luhet në rreth 3% në gjysmën e parë të vitit 2005, duke pasqyruar presionin në rritje të rritjes së çmimeve të naftës. Megjithatë, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2005, inflacioni mbeti relativisht i ulët, duke pasqyruar rënien e çmimeve të naftës. Inflacioni vjetor, duke përjashtuar çmimet e energjisë dhe të ushqimit, nuk pësoi ndryshime të ndjeshme krahasuar me vitin 2004 dhe mbeti në nivelin 2.2%.

Grafik 2. Rritja reale e PBB-së në SHBA dhe kontributi sipas përbërësve, 2002 - 2005




Burimi: Eurostat (2006)

Deficiti i llogarisë korrente së SHBA-së vlerësohet të jetë rreth 6.4% të PBB-së, ndikuar kryesisht nga rritja e ngadaltë e eksporteve të mallrave krahasuar me rritjen e importeve. Rritja e deficitit tregtar u kompensua pjesërisht nga një tepricë në shërbime dhe llogarinë e të ardhurave. Në vitin 2005, deficitin buxhetor i Qeverisë Federale të SHBA-së pësoi një rënie të lehtë si përqindje e PBB-së, duke u llogaritur në 2.7% (3.6% në 2004).

Ekonomia e Japonisë gjatë gjysmës së parë të vitit 2005 përjetoi një zgjerim të shpejtë, pasuar nga një rënie e lehtë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2005. Rritja e PBB-së u vlerësua në 2.6% në vitin 2005 me kontributin më të lartë pozitiv, që rezultonte nga konsumi privat (1.0 pikë përqindje) dhe totali i investimeve (1.0 pikë përqindje).

Megjithatë, eksportet neto u ulën gjatë vitit 2005, duke kontribuar pozitivisht me 0.2 pikë përqindje. Përsa u përket zhvillimeve në çmime, duhet theksuar se deflacioni në çmimet e konsumit është duke vazhduar. Duke pasuar deflacionin e ndjeshëm gjatë tremujorit të dytë, presionet rënese në inflacionin vjetor të IÇK-së kanë shfaqur një rënie të lehtë në gjysmën e dytë të vitit 2005, të cilat u kthyen sërish në tremujorin e fundit.

Grafik 3. Rritja reale e PBB-së në Japoni dhe kontributi sipas përbërësve, 2002 - 2005



Burimi: Eurostat (2006)


2.2 Bashkimi Evropian

Bashkimi Evropian është një nga partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës me një pjesëmarrje prej 42% në totalin e importeve. Ai gjithashtu ka punësuar pjesën më të madhe të diasporës kosovare (kryesisht në Gjermani, Mbretërinë e Bashkuar, etj).

Ekonomitë në **Euro zonë**⁴ u mbështetën nga përmirësimi i kërkesës së brendshme dhe eksportet neto. Në të vërtetë, rritja e PBB-së në fund të vitit 2005 pati një progres, krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2005. Megjithatë, vlerësimet tregojnë se rritja reale e PBB-së në euro zonë pati një rënie në 1.3%, krahasuar me 2.1% në vitin 2004. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2005, rritja u kufizua kryesisht për shkak të çmimeve më të larta të naftës, ngadalësimit në rritjen e ekonomisë botërore, si dhe nga ndikimi dobësues i vlerësimit të monedhës euro. Megjithatë, në gjysmën e dytë të vitit u regjistruan rezultate të mira, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së investimeve, konsumit më të madh privat dhe rritjes së eksporteve.

Lidhur me zhvillimet brenda euro zonës, dy ekonomitë më të mëdha, Gjermania dhe Franca, patën një rritje reale të PBB-së prej përkatësisht 0.9% dhe 1.5%, duke pasqyruar një rënie në kërkesën e brendshme krahasuar me vitin 2004. Italia pati një rritje reale të PBB-së prej 0.2%, ndërkohë që Portugalia dhe Holanda patën një rritje prej përkatësisht 0.4% dhe 0.5%. Spanja dhe Austria u rritën me 3.6% dhe 1.7%, ndikuar nga përmirësimi në kërkesën e brendshme, ndërkohë që në Belgjikë rritja reale e PBB-së ishte në nivelin 1.4%. Në Luksemburg, rritja reale e PBB-së mbeti e lartë në nivelin 4.2%, mbështetur kryesisht nga kërkesa e jashtme (2.6 pikë përqindje), ndërkohë që kërkesa e brendshme kontribuoi me 1.6 pikë përqindje.

Grafik 4. Rritja reale e PBB-së në euro zonë dhe kontributi sipas përbërësve, 2002 - 2005




Burimi: Eurostat (2006)

Indeksi i Harmonizuar i inflacionit të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) pati një rënie të lehtë në muajin nëntor, krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2005, kryesisht për shkak të ngadalësimit të rritjes së çmimeve të energjisë, ne veçanti të naftës bruto dhe gazit natyror.

Deri në muajin qershor 2005, inflacioni vjetor i IHÇK-së mbeti në nivele të qëndrueshme ndërmjet 1.9% dhe 2.1%, ndërkohë që në shtator arriti në 2.6, kryesisht si rrjedhojë e presionit në rritje të çmimeve të energjisë, të cilat u rritën nga 11.6% në muajin gusht në 15.2% në shtator. Presionet inflacioniste ishin më të theksuara në Luksemburg, Spanjë dhe Greqi, me një inflacion mesatar vjetor të IHÇK-së që luhatej nga 3.3% në 3.8%.

⁴ Belgjika, Gjermania, Greqia, Spanja, Franca, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Austria, Portugalia dhe Finlanda.

Grafik 5. Inflacioni (ndryshimi në IHÇK), Euro zonë, 2004 - 2005



Burimi: Eurostat (2006)

Kursi nominal efektiv i këmbimit të euros – llogaritur kundrejt 23 partnerëve të saj tregtarë – tregon për një zhvlerësim të euros krahasuar me mesataren e vitit 2004. Ky zhvlerësim, veçanësisht gjatë muajit tetor, rezultoi si pasojë e zhvlerësimit të euros ndaj dollarit amerikan dhe disa valutave aziatike, i cili u kompensua pjesërisht nga vlerësimi i euros ndaj paundit britanik dhe jenit japonez. Në mënyrë të ngjashme, kursi real efektiv i këmbimit ka shfaqur zhvlerësim krahasuar me mesataren e vitit 2004, duke dëshmuar për një përmirësim në konkurrencën e çmimeve të euro zonës.

Euro zona nuk arriti rezultate shumë pozitive lidhur me financat publike. Pesë shtete anëtare të euro zonës, (Gjermania, Greqia, Italia, Portugalia dhe Franca) vlerësohen të kenë tejkaluar deficitin vjetor prej 3% të PBB-së përcaktuar sipas kriterit të Mastroihti. Deficiti kryesor i buxhetit pësoi një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2004, duke arritur në 2.6% të PBB-së, ndërkohë që pagesat e interesit mbetën të pandryshuara krahasuar me PBB-në. Në bazë të vlerësimeve të Komisionit Evropian, deficiti buxhetor i euro zonës për vitin 2005 vlerësohet të jetë në nivelin 2.9% të PBB-së. Nga ana tjetër, totali i borxhit bruto të euro zonës pësoi një rritje të lehtë në vitin 2005 në 71.7% të PBB-së (70.8% në vitin 2004).

Përsa i përket bilancit të llogarisë korrente, euro zona pati një rënie të lehtë gjatë vitit 2005, pavarësisht nga kontributi pozitiv i bilancit tregtar. Në veçanti, teprica e kumuluar në bilancin tregtar ishte rreth një herë e gjysmë më e ulët sesa në vitin e mëparshëm. Nga ana tjetër, kontributi pozitiv i zvogëlimit në deficitin e llogarisë së të ardhurave ndaj bilancit të llogarisë korrente, u kompensua pjesërisht nga rritja e deficitit të transfertave korrente dhe nga një rënie e lehtë e shërbimeve neto.

Këto zhvillime rezultuan në uljen e tepriçës së llogarisë korrente në më pak se 0.1% të PBB-së. Eksportet e vendeve të euro zonës patën një përmirësim, kryesisht për shkak të rritjes ekonomike të vendeve importuese (veçanërisht Kina) dhe konkurrencës më të mirë në çmime në euro zonë. Megjithatë, rritja e importeve (në vlerë) ishte shumë më e madhe krahasuar me vitin 2004. Më specifikisht, rritja në vlerë e importeve pasqyroi pjesërisht çmimet më të larta të importeve shoqëruar me zhvlerësimin e euros, ndërkohë që çmimet më të larta të naftës mund të kenë kontribuar gjithashtu në rritjen e vlerës së importeve. Euro zona përjetoi një rritje në vëllimin e importeve, e cila dëshmon përmirësimin e kërkesës së brendshme në euro zonë. Gjatë vitit 2005, euro zona regjistroi një rrjedhje neto në investimet e kombinuara të huaja direkte dhe të portofolit.

Vendet e Tjera të Bashkimit Evropian⁵ - Në vitin 2005, rritja reale e PBB-së në **Mbretërinë e Bashkuar** pësoi një rënie në 1.6% nga 3.2% në vitin 2004. Kontributi kryesor në rritje në vitin 2005 erdhi si pasojë e konsumit privat (megjithëse më i dobët sesa në vitin 2004) dhe investimeve private, për shkak të pozicionit të mirë financiar dhe normave të ulëta të interesit. Megjithatë, kontributi negativ në rritje u shënuar nga eksportet neto, të cilat duke filluar nga gjysma e parë e vitit pësuan një rënie të ndjeshme. Përsa u përket zhvillimeve në çmimet, inflacioni vjetor i IHÇK-së në Mbretërinë e Bashkuar, pas një periudhe rritjeje të konsiderueshme, u ul në 2.0% nga kulmi i tij prej 2.5% në muajin shtator. Presionet inflacioniste erdhën si pasojë e rritjes së çmimeve të naftës, ndërkohë që këto presione mbetën brenda nivelit prej 1.4%. Deficiti i përgjithshëm qeveritar u vlerësua në 3.1% (3.0% e PBB-së në vitin 2004), ndërkohë që deficiti i llogarisë korrente u vlerësua të jetë rritur në nivelin 2.3% (2.2% të PBB-së në vitin 2004).

Ndër ekonomitë më të mëdha jashtë euro zonës, **Suedia** regjistroi rritjen më të lartë të PBB-së me 2.5%, megjithëse kjo rritje është më e ulët krahasuar me 3.7% në vitin 2004. Rritja e prodhimit në Suedi u kontribua nga rritja e kërkesës së brendshme prej 2.3% (0.7% në vitin 2004), ndërkohë që kontributi i kërkesës së jashtme ishte në nivele të papërfillshme me 0.2 pikë përqindje krahasuar me 3.0 pikë përqindje në vitin 2004. PBB-ja reale në **Danimarkë** u rrit me 2.5% (2.1% në vitin 2004), ndikuar kryesisht nga konsumi privat dhe investimet, të cilat pjesërisht kompensuan kërkesën e pafavorshme të jashtme.

Treguesit për tre **shtetet më të mëdha anëtare të reja të BE-së⁶** kanë treguar se rritja e prodhimit ishte e konsiderueshme në vitin 2005. Në veçanti, rritja më e lartë e prodhimit u shënuar nga **Republika Çeke**, ku PBB-ja reale u rrit me 4.8%. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga përmirësimet e

⁵ Shtete anëtare të BE-së të cilat nuk bëjnë pjesë në Euro Zonën.

ndjeshme në konsumin privat dhe nga pozicioni i favorshëm i jashtëm. Në, **Hungari**, PBB-ja reale u rrit me 3.7% nga 4.6% në vitin e mëparshëm, kryesisht ndikuar nga kërkesa e brendshme dhe nga kërkesa e favorshme e jashtme. Ndërkohë që rritja në **Poloni** duket të ketë pësuar rënie nga 5.3% në vitin 2004 në 3.4% në vitin 2005. Faktorët kryesorë, të cilët kontribuan në këtë ngadalësim, janë konsumi më i ulët privat dhe pozicioni i pafavorshëm i jashtëm, ndërkohë që investimet patën një rritje gjatë vitit 2005.

2.3 Ballkani Perëndimor⁷

Pjesa më e madhe e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës. Në vitin 2005, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë mori pjesë në importet e Kosovës në masën 22%, Serbia dhe Mali i Zi me 17%, Turqia me 9%, dhe Bullgaria me 4%.


Vendet e Ballkanit Perëndimor arritën një zhvillim të favorshëm ekonomik me një rritje të lartë dhe stabilitet makroekonomik. Megjithatë, ndryshimet ndërmjet vendeve të rajonit mbeten ende të mëdha. Nxitur nga një kontribut i lartë i konsumit privat, dhe mbështetur nga rritja e shpejtë e kredisë – duke pasqyruar zhvillime të mëtejshme të sistemit bankar në disa vende – bëri që PBB-ja reale të rritej në mesatarisht 5.0%. Ky nivel është disi më i ulët krahasuar me rritjen reale të PBB-së prej 5.4% në vitin 2004, por më i lartë krahasuar me 3.9% në vitin 2003. Përsa i përket rritjes së prodhimit të vendeve të veçanta brenda Ballkanit Perëndimor, rritja më e shpejtë u regjistrua nga Shqipëria (6.4%), Bullgaria (5.5%) dhe Rumania (5.3%).

Inflacioni vjetor i IÇK-së në vendet e Ballkanit Perëndimor pati një rritje të lehtë gjatë vitit 2005, kryesisht si rezultat i normave të përsheptuara të inflacionit në Serbi dhe Mali i Zi (vetëm Serbia) duke arritur në 17.5% në vitin 2005 (13.8% në vitin 2004). Rritja e konsiderueshme e inflacionit në Serbi dhe Mali i Zi erdhi kryesisht për shkak të rritjes së pagave dhe të çmimeve të administruara, duke përfshirë ndikimin e çmimeve të larta të naftës gjatë vitit 2005. Presionet inflacioniste ishin gjithashtu të theksuara në Rumani dhe Bullgari, duke arritur në përkatësisht 8.0% dhe 6.8%. Nivele të ulëta të normave vjetore të inflacionit u regjistruan nga IRJM (0.5%) dhe Bosnje Hercegovina (1.6%).

⁶ Republika Çeke, Estonia, Qipro, Letonia, Lituania, Hungaria, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia.


⁷ Treguesit për Ballkanin Perëndimor përfshijnë: Shqipërinë, Bosnje Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, IRJM, Rumaninë dhe Serbinë dhe Malin e Zi (duke përfshirë Kosovën).

Grafik 6. Prodhimi i Brendshëm Bruto (vjetore), Ballkani Perëndimor, 2003 - 2005



Burimi: Business Monitor International (2006); BERZH (2005)


Grafik 7. Inflacioni (ndryshimi në IÇK-në vjetore) në Ballkanin Perëndimor, 2003 - 2005



Burimi: Business Monitor International (2006); BERZH (2005)

Përsa u përket kurseve të këmbimit (grafik 8) të valutave të vendeve të Ballkanit Perëndimor kundrejt monedhës euro, lei rumun (ROL) dhe leku shqiptar (ALL) patën një vlerësim, ndërkohë që dinari serb (CSD) u zhverësua ndaj euros. Megjithatë, vendet e tjera ishin të suksesshme në mbajtjen e kursit të këmbimit në nivele të qëndrueshme.


Grafik 8. Kursi i këmbimit të euros kundrejt HRK, ALL, CSD, MKD, ROL, 2003 - 2005



Burimi: Eurostat (2006)

Vendet e Ballkanit Perëndimor patën një ecure të mirë në vitin 2005 përsa i përket disiplinës fiskale, duke zvogëluar deficitet fiskale, megjithëse ndërmjet këtyre vendeve ekzistojnë mjaft ndryshime. Në veçanti, deficitet më të mëdha buxhetore qeveritare u përjetuan nga Shqipëria dhe Kroacia, ndërkohë që Rumania, Serbia dhe Mali i Zi, dhe Bullgaria rezultuan me tepicë në bilancin e tyre të përgjithshëm të konsoliduar të qeverisë. Për shkak të rritjes së shpejtë të kreditimit, bilanci i llogarisë korrente në vendet e Ballkanit Perëndimor vijon të përkeqësohet. Deficiti i llogarisë korrente është llogaritur të ketë rënë lehtë në vitin 2005 krahasuar me vitin 2004, ndërkohë që deficiti më i madh i llogarisë korrente u regjistrua në Bosnje Hercegovinë, Serbi dhe Mali i Zi, dhe Rumani. Nga ana tjetër, rritje e deficitit u shënuar dhe në Shqipëri, Rumani dhe Kroaci, ndërkohë që vlerësohet të ketë mbetur në nivele të pandryshuara në Bullgari (shiko grafikun 9).

Të hyrat e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) duken të jenë duke pasqyruar pritshmëritë për anëtarësimin në BE dhe progresin e privatizimit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Veçanërisht, të hyra të mëdha neto të IHD-ve janë arritur nga Bullgaria, Rumania dhe Kroacia, të cilat mbulojnë mbi gjysmën e deficitit të tyre të llogarisë korrente. Serbia dhe Mali i Zi kanë patur të hyra neto të IHD-ve, megjithatë ato ende mbështeten mbi grantet dhe huatë nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe nga të hyrat e larta të të ardhurave nga emigrantët.

Grafik 9. Bilanci fiskal dhe i llogarisë korrente si % ndaj PBB-së, Ballkani Perëndimor, 2003 - 2005

Burimi: Business Monitor International (2006); BERZH (2005)

Rritja reale e PBB-së në **Shqipëri** vlerësohet të jetë 6.4% (5.9% në vitin 2004), ku sektori privat përfaqëson 75% të PBB-së. Norma vjetore e inflacionit në fund të vitit 2004 mbeti në nivelin 2.9%, dhe në fund të vitit 2005 ajo u ul në 2.1%. Në vitin 2004, leku shqiptar u vlerësua me 4.9% ndaj euros dhe gjatë vitit 2005 ai vazhdoi të forcohet më tej me mesatarisht 2.8%. Deficiti i llogarisë korrente u ul në 5.9% në vitin 2005 nga 8.2% në vitin 2003, duke pasqyruar zhvillime pozitive në bilancin tregtar me një deficit tregtar rreth 84.3 milionë euro më i ulët sesa në vitin 2004. Bilanci tregtar mbulohet kryesisht nga të ardhurat e emigrantëve (të llogaritura në 14% të PBB-së në vitin 2004) dhe nga transfertat private dhe zyrtare, të cilat kontribuan ndjeshëm në rritjen e kërkesës së brendshme. Përsa iu përket zhvillimeve fiskale, deficiti buxhetor mbeti i qëndrueshëm gjatë tre viteve të fundit dhe në vitin 2005, ai arriti në 4.7% të PBB-së (4.8% dhe 4.4% në vitin 2004 dhe 2003).

Përsa i përket sektorit bankar në Shqipëri, gjenden 16 banka me pronësi kryesisht private. Sektori bankar ka rritur veprimtarinë e tij me privatizimin e Bankës së Kursimeve, depozitat e së cilës llogariten në 57%. Asetet e sektorit bankar llogariten në rreth 58.8% të PBB-së. Megjithatë, pavarësisht nga depozitat në banka, të cilat përfaqësojnë rreth 51.9% të PBB-së, kreditimi i ekonomisë vendore mbetet i ulët, i cili në fund të vitit 2005 u llogarit në rreth 14.7% të PBB-së.

Rritja reale e PBB-së në **Bosnje Hercegovinë (BH)** në vitin 2005 arriti në 5.8%, krahasuar me 5.0% në vitin 2004, dhe 3.5% në vitin 2003, ndërkohë që sektori privat u llogarit në 55% të PBB-së. Marrëveshja e bordit të valutës mundësoi BH-në të ruajë në mënyrë të suksesshme stabilitetin e çmimeve, me inflacionin në nivelin 1.6% në vitin 2005. Megjithatë, inekuilibrat e llogarisë korrente

mbeten të mëdha, të shoqëruara gjithashtu nga asistenca e huaj në rënie. Deficiti i llogarisë korrente në vitin 2005 ra në nivelin 21.2% të PBB-së (23.3% në vitin 2004), ku IHD-të mbulojnë rreth 30% të deficitit të llogarisë korrente. Inekuilibrat e jashtëm kanë ardhur kryesisht së pari, si rezultat i deficitit të lartë tregtar (mbuluar kryesisht nga transfertat private), duke pasqyruar kapacitet të ulët në eksport, dhe së dyti, si rezultat i zgjerimit të kreditimit nga sektori bankar, i cili mund të ketë kontribuar në rritjen e importeve.

Përsa i përket sektorit fiskal, deficiti qeveritar përfaqëson 1.3% të PBB-së, ku shpenzimet përqendrohen kryesisht më shumë mbi shpenzimet korrente sesa mbi ato kapitale. Sektori bankar në BH dominohet nga bankat me pronësi të huaj, të cilat përbëjnë 84% të kapitalit të sektorit bankar, ndërkohë që pesë banka llogarisin 62% të totalit të asetëve. Kreditimi i sektorit privat është zgjeruar me ritme të shpejta, duke u llogaritur në 17.4% të PBB-së, ndërkohë që depozitat llogariten në 34.1% të PBB-së. Në përgjigje të zgjerimit të kreditimit, banka qendrore e BH-së në vitin 2004 rriti rezervën e detyrueshme nga 5% në 10%.

Bullgaria arriti në vitin 2005 një rritje reale të PBB-së prej 5.5%, ndikuar kryesisht nga sektori privat, i cili përbën rreth 75% të PBB-së. Bullgaria ka qenë gjithashtu e suksesshme në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, mbështetur nga marrëveshjet e bordit të valutës dhe politika e duhur fiskale. Inflacioni vjetor i çmimeve të konsumit u rrit nga 4.0% në vitin 2004 në 6.8% në fund të vitit 2005. Pavarësisht nga rritja e lartë dhe stabiliteti makroekonomik, inekuilibrat e jashtëm mbeten ende të larta. Në veçanti, deficiti i llogarisë korrente në vitin 2004 ishte në nivelin 7.5% të PBB-së, i cili në vitin 2005 u rrit më tej në 13.8%. Thellimi i deficitit të llogarisë korrente u ndikua pjesërisht nga rritja e lartë e importeve të mallrave të konsumit dhe të investimeve, si dhe nga rritja e çmimeve të naftës. Përsa i përket sektorit fiskal, bilanci i përgjithshëm li qeverisë u mbyll në vitin 2005 me një tepriçë prej 2.0% të PBB-së, duke kontribuar në rënien e borxhit të jashtëm në 63.6% nga 69.1% të PBB-së në vitin 2004.

Sektori bankar i Bullgarisë ka një rol të konsiderueshëm në ekonominë e vendit, ku totali i asetëve llogaritet në 77.5% të PBB-së. Gjatë vitit 2004, sektori bankar në Bullgari thelloi më tej rolin e tij në ndërmjetësimin financiar. Për rrjedhojë, për shkak të rritjes së shpejtë të kreditimit gjatë vitit 2004, kreditimi arriti në rreth 35% të PBB-së, duke kontribuar në këtë mënyrë në rritjen e kërkesës së brendshme dhe importeve. Në linjë me rritjen e kreditimit, depozitat arritën në rreth 50% të PBB-së. Në vitin 2005, Banka Kombëtare e Bullgarisë vendosi kufi kreditimi duke rritur rezervën minimale të detyrueshme, duke u mbështetur në rritjen mesatare të kredive. Për rrjedhojë, kjo pakësoi zgjerimin e kreditimit në 27.6% të PBB-së, ndërkohë që depozitat arritën në 56.6% të PBB-së.

Ekonomia **kroate** vijoi të ngadalësohet me një rritje reale të PBB-së prej 3.7% në vitin 2005 (përkatësisht 3.8% dhe 4.3% në vitet 2004 dhe 2003), ndërkohë që pjesëmarrja e sektorit privat në PBB arriti në 60%. Norma vjetore e inflacionit në fund të vitit 2005 u rrit me 3.7% (2.7% në vitin 2004), kryesisht për shkak të presionit rritës të çmimeve të naftës dhe ushqimit. Inflacioni i ulët, shoqëruar nga kursi i qëndrueshëm i këmbimit të kunës kroate ndaj euros ndihmoi Kroacinë në arritjen e stabilitetit makroekonomik, edhe pse inekuilibrat e jashtëm dhe fiskalë ende ekzistojnë. Pas një rënije të ndjeshme në vitin 2004 (në 4.8% nga 7.2% në vitin 2003), deficiti i llogarisë korrente pati një rritje të lehtë në vitin 2005 duke arritur në 5.2% të PBB-së. Ndërkohë që, deficiti buxhetor i qeverisë u ul në 4.2% në vitin 2005 (4.9% në 2004).

Duke marrë parasysh rolin e tij në ekonominë kroate, sektori bankar është i mirë-zhvilluar, me asete që përfaqësojnë 109.9% të PBB-së. Kredia private në raport me PBB-në u rrit me 62.9%, rritje e cila u shoqërua me rritje të depozitave në 72.7% të PBB-së. Për shkak të një fluksi hyrës të madh të kapitalit, i cili ushtroi një presion të madh në vlerësimin e kunës kroate, Banka Kombëtare Kroate (BKK) vendosi nivel minimal të rezervës së detyrueshme në detyrimet e huaja të bankave.

Rritja reale e PBB-së në **Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM)** në vitin 2005 vlerësohet të jetë 4.0%, krahasuar me 2.9% dhe 2.8% në vitin 2004 dhe 2003. Sektori privat gjatë vitit 2005 rriti pjesëmarrjen e tij në PBB në nivelin 65%. Në vitin 2004, IRJM pësoi një deflacion vjetor të çmimeve të konsumit prej 0.1%, ndërkohë që në vitin 2005, ai mbeti i pandryshuar në zero. Si rezultat i politikës së ndjekur nga banka qendrore në mbajtjen e kursit të këmbimit të denarit ndaj euros në nivele të qëndrueshme, kursi i këmbimit gjatë vitit 2005 mbeti i qëndrueshëm në 61.4 - 61.2 MKD ndaj 1 euro. Bilanci i llogarisë korrente të IRJM-së vazhdimisht përjeton deficite, i cili në vitin 2004 u rrit në 8.2%, ndërkohë që në vitin 2005 u pasua nga një rënie e lehtë në 6.5% të PBB-së. Inekuilibrat e lartë të jashtëm u ndikuan kryesisht nga deficiti i lartë tregtar, megjithëse në vitin 2005 ai ra me 28.7%, krahasuar me vitin 2004. Deficiti i llogarisë korrente kryesisht është financuar nga të ardhurat e emigrantëve, të cilat llogariten në 12% të PBB-së, ndërkohë që flukset hyrëse neto të IHD-ve vazhdojnë të mbeten në nivele të ulëta. Qeveria e përgjithshme gjatë vitit pësoi një deficit prej 0.5% të PBB-së, me borxhin publik i cili mbeti në nivele relativisht të ulëta, në rreth 50% të PBB-së.

Sektori financiar në IRJM mbizotërohet nga sektori bankar. Në vitin 2005, sektori bankar në IRJM përbëhej nga 20 banka, tre prej të cilave përbënin 65% të totalit të aseteve të sektorit bankar (dy prej të cilave me kapital të huaj), 75% të kredive dhe 65% të totalit të depozitave. Megjithëse numri është i madh, roli ndërmjetësues i bankave është relativisht i ulët, me kreditimin privat që llogaritet në 20%

të PBB-së, ndërkohë që asetet përfaqësojnë 61.6% të PBB-së. Pjesëmarrja e totalit të depozitave si përqindje e PBB-së është gjithashtu e ulët, me 33.0% të PBB-së në fund të vitit 2005.

Rumania përjetoi një rritje të lartë të PBB-së në vitin 2004 në 8.3%, e cila në vitin 2005 u ul në 4.6%, ndikuar kryesisht nga kërkesa e brendshme. Në fund të vitit 2005, inflacioni vjetor i çmimeve të konsumit ra në 8.0% nga 9.3% në vitin 2004, duke pasuar vlerësimin e fortë të leit rumun ndaj euros. Deficiti i llogarisë korrente arriti në 7.6% në vitin 2005, krahasuar me përkatësisht 7.4% dhe 6.4% në vitin 2004 dhe 2003. Faktori kryesor që ndikoi në thellimin e deficitit të llogarisë korrente ishte deficiti tregtar rritës, i cili u dobësua kryesisht për shkak të kërkesës së lartë të brendshme dhe vlerësimit të monedhës. Rumania pati një fluks të lartë hyrës të IHD-ve, i cili erdhi si rrjedhojë e privatizimit të disa ndërmarjeve nga investitorët e huaj. Buxheti i konsoliduar i qeverisë pati një tepricë prej 1.0% të PBB-së, pjesërisht për shkak të rritjes së lartë dhe përmirësimit të mbledhjes së taksave.

Rritja reale e PBB-së në **Serbi dhe Mali i Zi** (Serbia vetëm) u ul disi në vitin 2005 në 5.8% nga 8.6% në vitin 2004. Inflacioni vjetor arriti në 17.5% në fund të vitit 2005 nga 13.8% në vitin 2004, ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të administruara dhe rritja e lartë e pagave, shoqëruar nga kërkesa e lartë ekzistuese e brendshme. Dinari u zhvlerësua ndaj euros me 14.9% në vitin 2004 dhe mesatarisht me 15.5%, gjatë vitit 2005. Duke pasqyruar rritje më të ngadaltë të PBB-së, kërkesa e brendshme u ul, duke kontribuar në këtë mënyrë në ngushtimin e deficitit tregtar. Për rrjedhojë, deficiti i llogarisë korrente u ngushtua gjithashtu, dhe në vitin 2005, ai llogaritej në 8.5% të PBB-së nga 14.5% në vitin 2004. Të ardhurat nga emigrantët përfaqësuan rreth 14% të PBB-së, ndërkohë që flukset hyrëse neto të IHD-ve u dyfishuan në vitin 2005 (rreth 4% të PBB-së në vitin 2004), kryesisht si rrjedhojë e privatizimit të bankave shtetërore. Buxheti i përgjithshëm qeveritar gradualisht u ngadalësua nga 3.1% në vitin 2003 në 0.2% në vitin 2004, ndërkohë që në vitin 2005 rezultoi me një tepricë prej 1.4% të PBB-së. Sektori bankar në Serbi përbëhej nga 40 banka, 14 prej të cilave me kapital të huaj. Pavarësisht nga numri i madh i bankave, kreditimi arriti në 32.2% të PBB-së, ndërkohë që depozitat u llogaritën në 39.0% të PBB-së. Totali i asetëve të sektorit bankar në Serbi në fund të vitit 2005 u llogarit në 61.4% të PBB-së. Përsa i përket Malit të Zi, ekziston një tablo e ndryshme në aspektin e PBB-së dhe stabilitetit të çmimeve. Kështu, rritja reale e PBB-së për vitin 2005 vlerësohet të ketë arritur në 3.5%, e cila është 0.5 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin 2004. Çmimet (mesatare vjetore) u rritën me 1.8 pikë përqindje gjatë vitit 2004, duke qëndruar në vitin 2005 në nivelin 3.6%.

Rritja reale e PBB-së në **Turqi** në vitin 2005 u llogarit në 5%, e ngjashme me rritjen e PBB-së në vitin 2004. Inflacioni shfaq përmirësime duke regjistruar një rënie në 6.9% në vitin 2005 nga 8.4% në vitin 2004. Që prej vitit 2001, kur llogaria korrente regjistroi një bilanc pozitiv prej 2.4%, ka patur një rënie

të vazhdueshme, duke pasqyruar një deficit në llogarinë korrente. Krahasuar me vitin e mëparshëm, deficitin e llogarisë korrente në vitin 2005, u zbut disi me 0.3 pikë përqindje, ndonëse llogaritet ende në 5.3% të PBB-së.

3. Zhvillimet Ekonomike në Vend⁸

Pas një rritjeje pozitive të PBB-së prej 3.7% në vitin 2004, Kosova përjetoi një rritje negative të PBB-së reale prej 0.5% në vitin 2005. Duke përbërë 107.1% të PBB-së në vitin 2005, konsumi i përgjithshëm u ul me 0.4%. Nga ana tjetër, investimet (24.2% e PBB-së në vitin 2005) përjetuan një rritje vjetore prej 0.6% në vitin 2005. Rritja e kërkesës private (konsumi privat dhe investimet) me 3.9% dhe kontraktimi i kërkesës së qeverisë dhe kërkesës donatore me përkatësisht -9.3% dhe -5.6%, mbeten faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen negative të PBB-së gjatë vitit 2005. Zvogëlimi i pranisë ndërkombëtare në Kosovë ka shfaqur ndikimin e tij në rënien e konsiderueshme të pjesëmarrjes së tyre në PBB gjithashtu, e cila në vitin 2005 përbënte 22.1%, ndërkohë që në vitin 2000 përfaqësonte 56.9% të PBB-së. Nga ana tjetër, të ardhurat nga emigrantët në vitin 2005 vlerësohen në 347 milionë euro (rreth 14% të PBB-së).

Zvogëlimi i pranisë ndërkombëtare mund të konsiderohet gjithashtu si një arsye e pjeshme që ka ndikuar në rënien e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në Kosovë. Në veçanti, pavarësisht presionit në rritje të çmimeve të naftës, inflacioni mesatar vjetor në vitin 2005 u ul me -0.8%. Çmimet e mallrave të tregtueshme pësuan një rënie, kontribuar kryesisht nga rënia e çmimeve të ushqimit me -2.3% dhe çmimeve të pijeve joalkolike me -4.3%. E njëjta tendencë u vu re në çmimet e mallrave të patregtueshëm, të cilat në vitin 2005 u ulën kryesisht si pasojë e kontraktimit të çmimeve të qerasë në -1.7% në vitin 2005 nga -7.4% në vitin 2004.

Papunësia e përgjithshme në Kosovë mbetet në nivele shumë të larta. Sipas vlerësimeve të FMN-së, papunësia ishte e pranishme në rreth 30% të popullsisë të aftë për punë. Në bazë të statistikave mbi punësimin, mesatarisht çdo vit regjistrohen rreth 22.000 punëkërkues të rinj. Numri kumulativ i punëkërkuesve të regjistruar në fund të vitit 2005 arriti nivelin më të lartë në rreth 320.000.

Për të dytin vit me radhë, buxheti i Kosovës u përball me një deficit. Megjithatë, në vitin 2005 ky deficit u ul në 3.9% të PBB-së, krahasuar me 5.3% në vitin 2004. Faktori kryesor që ndikoi në uljen e deficitit buxhetor është zvogëlimi i shpenzimeve qeveritare (kryesisht i mallrave dhe shërbimeve). Në

⁸ Kosova nuk ka ende statistika të përgjithshme mbi llogaritë kombëtare. Për qëllime analitike, krahas burimeve të të dhënave të brendshme, përdoren dhe vlerësimet dhe parashikimet e stafit të FMN-së bërë në korrik 2005. Për këtë arsye, mund të ketë mospërputhje me të dhënat më të fundit në dispozicion.

fund të vitit 2005, të ardhurat ishin në masën 609.0 milionë euro, ndërsa shpenzimet u llogaritën në 712.3 milionë euro. Gjatë vitit 2005, të ardhurat qeveritare nuk pësuan ndryshime të mëdha në strukturë, ndërkohë që ato u rritën me 0.1%, krahasuar me rritjen prej 4.3% në vitin 2004, duke arritur kulmin në 24.8% të PBB-së nominale. Brenda strukturës së të ardhurave qeveritare, taksat jo të drejtpërdrejta (kryesisht TVSH-ja) kanë pjesëmarrjen më të madhe në totalin e të ardhurave tatimore, duke u llogaritur në 87.7% të të ardhurave gjithsej. Shpenzimet qeveritare për herë të parë që prej vitit 2000, shënuan një rënie prej 4.8%, pas rritjes prej 37.9% në vitin 2004, duke u llogaritur në 29.0% të PBB-së nominale.

Tabela 1. Treguesit kryesorë makroekonomikë, 2001 - 2005

	2001	2002	2003	2004	2005
PBB, sipas çmimeve të 2002, në miliona EUR	2,520	2,447	2,413	2,501	2,488
rritja vjetore	16.6	-2.9	-1.4	3.7	-0.5
Sektori privat	2,135	2,090	2,109	2,173	2,257
prej të cilës: Investimet	424	408	399	355	377
Sektori qeveritar	202	268	351	507	460
prej të cilës: Investimet	6	15	36	167	149
Sektori i donatorëve	1,097	869	689	582	550
prej të cilës: Investimet	254	180	131	65	76
Eksporti neto	-914	-780	-735	-761	-778
Indeksi i çmimeve të konsumit (t-12), në % 1/	11.7	3.6	1.1	0.0	-0.8
Buxheti i qeverisë qendrore, në miliona EUR					
Të hyrat	362.4	509.2	589.7	615.0	615.5
Shpensimet	239.5	401.6	542.6	748.5	712.3
Bilanci i përgjithshëm	123.0	107.7	47.1	-133.4	-96.9
Bilanci i përgjithshëm (si % e PBB-s)	5.0	4.4	1.9	-5.3	-3.9
Korporatat depozituese, në miliona EUR					
Mjetet e huaja neto të korporatave depozituese	583.3	649.5	695.2	647.9	695.0
prej të cilës: mjetet e huaja neto të ban. kom.	289.7	304.1	241.5	303.4	300.7
Kërkesat neto ndaj qeverisë qendrore	-43.9	-172.1	-110.0	161.3	293.2
kërkesat neto ndaj qeverisë qendrore	-69.8	-258.6	-342.7	-212.4	-220.7
kërkesat ndaj sektorit real (korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare)	25.9	86.5	232.8	373.7	513.9
Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në miliona EUR					
Bilanci para ndihmës së jashtme	-1,104	-880	-752	-755	-713
si % e PBB-s	-45.2	-36.0	-31.1	-30.1	-29.1
Bilanci pas ndihmës së jashtme	56	7	-64	-187	-193
si % e PBB-s	2.3	0.3	-2.6	-7.5	-7.9
Bilanci tregtar	-956	-838	-812	-848	-854
prej të cilës: Importi	1,225	1,055	1,009	1,047	1,053
Dërgesat e parave nga jashtë (remitancat)					
në miliona EUR	317.0	341.4	341.4	341.4	345.1
si % e PBB-s	13.0	14.0	14.1	13.6	14.1

Burimi: BPK, MEF, ESK, Vlerësimet dhe parashikimet e stafit të FMN-së në korrik 2005;

1/ IÇK-ja deri në vitin 2003 bazohet në vlerësimet e FMN-së.

Mjetet e huaja neto (MHN) të sektorit financiar në fund të vitit 2005 u llogaritën në 682.3 milionë euro, një rritje prej 6.7% nga viti 2004. Mbështetur nga depozitat, pretendimet ndaj jorezidentëve u rritën me 8.3%, duke u llogaritur në 748.7 milionë euro, duke mbetur kështu kontribuesi më i madh në rritjen e korporatave të përgjithshme financiare. Edhe pse në rritje, detyrimet ndaj jorezidentëve llogariten në një masë jo të konsiderueshme prej 8.9% të pretendimeve ndaj jorezidentëve.

Pretendimet e brendshme në vitin 2005 u llogaritën në 351.5 milionë euro, shifër që korrespondon me një rritje prej 70.9%, kryesisht për shkak të rritjes së pretendimeve ndaj sektorit real (kreditë). Duke pasuar këtë rritje të ndjeshme, pretendimet e brendshme përbënin 46.9% të pretendimeve ndaj jorezidentëve, krahasuar me 29.7% në vitin e mëparshëm. Zhvillimet në MHN-të e BPK-së u ndikuan në një masë të madhe nga rënia e vazhdueshme e llogarive të qeverisë në regjistrat e BPK-së, duke pasqyruar deficitin buxhetor të regjistruar në vitet 2004 dhe 2005. Në aspektin sektoral, MHN-të e BPK-së u ndikuan pozitivisht nga rritja e depozitave të ATK-së.

Paraja e gjerë në Kosovë në fund të vitit 2005 ishte në nivelin 1.166 milionë euro, një rritje e ngadalësuar prej 3.7%, kundrejt 9.2% në vitin 2004. Rritja e parasë së gjerë ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave, ndërkohë që kjo rritje ka kompensuar rënien e vazhdueshme të valutës jashtë korporatave depozituese. Valuta e vlerësuar jashtë korporatave depozituese arriti në rreth 300 milionë euro, 34.2% e depozitave të përfshira në paranë e gjerë në fund të vitit 2005.

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të Kosovës janë karakterizuar nga një deficit në llogarinë korrente (përpara asistencës së huaj), e llogaritur në 29.1% të PBB-së në vitin 2005. Impakti i rënies së veprimtarisë donatore në Kosovë mund të vihet re në llogaritë e jashtme të Kosovës. Deficiti tregtar, si një nga problemet më të mëdha për ekonominë e Kosovës, në vitin 2005 arriti në shumën 854 milionë euro (34.8% e PBB-së). Importet tregtare mbështetën rritjen e importeve me 2.4%, ndërkohë që importet donatore u rritën me 63 milionë euro nga 59 milionë euro në vitin 2004. Eksportet në Kosovë përjetuan një rritje në 68 milionë euro nga 57 milionë euro në vitin 2004. Llogaria financiare dhe ajo kapitale e Kosovës në vitin 2005 regjistroi shumën 60 milionë euro, krahasuar me 105 milionë euro në vitin 2004. Kjo rënie u mbështet kryesisht nga rritja e MHN-ve të sistemit bankar. Kështu, MHN-të e BPK-së u rritën me 50 milionë euro (kundrejt rënies me 109 milionë euro në vitin 2004), ndërkohë që MHN-të e bankave të nivelit të dytë mbetën në nivele të qëndrueshme, duke u ulur nga viti 2004 me 3 milionë euro në vitin 2005.


3.1 Sektori Real

3.1.1 Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)

Pas rritjes prej 3.7% në vitin 2004, PBB-ja reale e Kosovës në vitin 2005 u ul me 0.5%, duke arritur në rreth 2.5 miliardë euro. Kërkesa e brendshme (konsumi dhe investimet) kontribuan pozitivisht në rritjen reale në vitin 2005 me 0.2 pikë përqindje, ndërkohë që për vitin 2004 ky kontribut ishte 4.6 pikë përqindje. Kontributi i eksporteve neto në rritjen e PBB-së reale gjatë vitit 2005 ishte -0.7 pikë përqindje (-1.0 pikë përqindje në vitin 2004).

Pjesëmarrja e konsumit në PBB qëndroi në nivelin 107.1%, duke qëndruar në nivele mjaft të qëndrueshme që prej vitit 2002. Në vitin 2005, konsumi dha një kontribut negativ prej -0.4 pikë përqindje në rritjen e PBB-së reale, ndërkohë që në vitin 2004 ai kontribuoi me 3.7 pikë përqindje. Nga ana tjetër, investimet shënuan një rritje të lehtë në PBB prej 0.7 pikë përqindje, duke u llogaritur në 24.2% të PBB-së së vitit 2005. Në mënyrë të ngjashme, investimet kontribuan me 0.6 pikë përqindje në rritjen e PBB-së reale, ndërkohë që ky kontribut në vitin 2004 ishte 0.9 pikë përqindje.

Grafik 10. Rritja e PBB-së, në çmimet konstante të vitit 2002, 2001 - 2005




Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së, korrik 2005

Përsa i përket klasifikimit sektoral, sektori privat kontribuoi në rritjen e PBB-së me 3.4%. Në të kundërt, qeveria e përgjithshme dhe sektori donator, të cilat së bashku përbëjnë sektorin publik, ndoqën një trend të kundërt nga sektori privat. Sektori qeveritar dhe ai donator kontribuan me

përkatësisht -1.9 dhe -1.3 pikë përqindje, ndërkohë që rritja në vitin 2004, u ndikua kryesisht nga qeveria e cila kontribuoi në rritjen e PBB-së me 6.5%.

Kërkesa private në fund të vitit 2005 rezultoi në 2.3 miliardë euro, ndërkohë që raporti i kërkesës private ndaj PBB-së arriti nivelin më të lartë në 90.7%. Rritja vjetore e kërkesës private me 3.9% shpjegohet nga zhvillimet në konsumin privat (duke kontribuar me 2.9 pikë përqindje) dhe investimet private (me 1.0 pikë përqindje). Siç ilustron në grafikun 11, brenda strukturës së kërkesës private, konsumi privat mbetet përbërësi më i madh, me 83.3%. Si raport ndaj PBB-së, konsumi privat u rrit në 75.5% në vitin 2005, nga 72.7% të PBB-së në vitin 2004.


Grafik 11. Kërkesa private, 2000 - 2005



Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së, korrik 2005

Kërkesa e qeverisë pati një rritje prej 44.7% në vitin 2004, duke arritur në 20.3% të PBB-së, pasuar nga një kontraktim i konsiderueshëm në vitin 2005 (ulur me -9.3% ose në 18.5% të PBB-së), duke shënuar 460 milionë euro. Zgjerimi i ndjeshëm i kërkesës së qeverisë në vitin 2004, rezultoi kryesisht si pasojë e rritjes së investimeve qeveritare (investime kapitale), të cilat kontribuan me 37.5 pikë përqindje në rritjen e kërkesës së qeverisë, ndërkohë që në vitin 2005, investimet qeveritare dhanë një kontribut negativ me -3.6 pikë përqindje. Megjithatë, konsumi qeveritar mbetet përbërësi më i madh i kërkesës së qeverisë, edhe pse pjesëmarrja e tij në kërkesën e qeverisë pësoi një rënie nga 96.9% në vitin 2002, në 67.6% në vitin 2005.


Grafik 12. Kërkesa e qeverisë, 2000 - 2005



Burimi: Ministria e Ekonomisë dhe Financave (2005); Vlerësimet e stafit të FMN-së, korrik 2005

Që prej vitit 2000, ritmi i PBB-së së përgjithshme është ndikuar mjaft nga veprimtaritë donatore. Sektori donator në vitin 2005 arriti në shumën 550 milionë euro nga 582 milionë euro në vitin 2004. Veçanërisht, pjesëmarrja e sektorit donator në PBB në vitin 2000 u llogarit në rreth 60%, pjesëmarrje e cila ra në 28.6% në vitin 2003, dhe qëndroi në nivelin 22.1% në vitin 2005 (shiko grafikun 13). Kërkesa donatore në vitin 2005 u ul me -5.6%, kryesisht për shkak të rënies së konsumit donator. Në vitin 2005, konsumi donator u ul me -8.4%, në krahasim me -7.4% në vitin 2004, duke përfaqësuar një rënie vjetore mesatare prej 12% në periudhat 2000-2005.

Grafik 13. Kërkesa donatore, 2000 - 2005




Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së, korrik 2005

Përsa u përket të Ardhurave Kombëtare Bruto të Disponueshme (AKBD), në fund të vitit 2005, ato u llogaritën në 102.25% të PBB-së. Në veçanti, në vitin 2003 AKBD-ja llogaritej në 99.7% të PBB-së, duke u rritur më tej në vitin 2004 në 100.6%. Lidhur me të ardhurat nga emigrantët, si burimi kryesor financues, ato vlerësohen të jenë 347 milionë euro në vitin 2005, duke përfaqësuar një rritje prej 2.6%, krahasuar me vitin 2004. Si pjesëmarrje në PBB, të ardhurat nga emigrantët arritën në rreth 14% ose 3.3 pikë përqindje më pak se kulmi i tyre në vitin 2000 (17.2% të PBB-së). Rënie më e ndjeshme e të ardhurave nga emigrantët u regjistrua pas periudhës së rindërtimit në vitet 2000-2001, kur ato u ulën me 11.8%.

Rënia në veprimtaritë donatore në Kosovë shoqërohet me rënien e pagave të emigrantëve, si zëri që ngushton hendekun ndërmjet PBB-së dhe AKBD-ve. Në vitin 2005, pagat e emigrantëve regjistruan 292 milionë euro, shifër e cila korrespondon me një rënie prej 9.3%. Faktori kryesor që ka ndikuar që AKBD-të të jenë më të ulëta në krahasim me PBB-në deri në vitin 2003 ishte shuma më e lartë e pagave të emigrantëve, të cilat kanë kompensuar flukset hyrëse nga të ardhurat nga emigrantët. Megjithatë, duke filluar nga viti 2003 e më tej, veprimtaria donatore ka rënë në mënyrë të ndjeshme, duke kontribuar kështu në rënien e pagave të emigrantëve dhe, për pasojë, duke ngushtuar hendekun ndërmjet AKBD-ve dhe PBB-së.

Grafik 14. Të Ardhurat Kombëtare Bruto të Disponueshme (AKBD), 2000 - 2005




Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së, korrik 2005

3.1.2 Çmimet

Bazuar në Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në vitin 2005, inflacioni mesatar vjetor në Kosovë arriti në -0.8%. Siç tregohet në grafikun 15, në vitin 2001, inflacioni ishte dyshifror (11.2%), duke përfaqësuar një rënie të vazhdueshme në IÇK.⁹ Në veçanti, IÇK-ja është ndikuar kryesisht nga zhvillimet në çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike.

Grafik 15. Çmimet (IÇK), mesatare vjetore, 2001 - 2005



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës, vlerësimet e stafit të FMN-së dhe të BPK-së

Përsa i përket IÇK-së së mallrave të tregtueshëm, çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike – grupi me peshën më të madhe në IÇK-në e përgjithshme – pësoi një rënie të konsiderueshme në vitin 2004, ndërkohë që në vitin 2005 këto çmime u ulën me një ritëm relativisht më të shpejtë. Në baza mesatare vjetore, në vitin 2005 indeksi (ushqime dhe pije joalkoolike) u ul në -2.5% nga -1.1% në vitin 2004, ku rënia u ndikua nga të dyja nëngrupet, ushqimi (-2.3% në 2005 krahasuar me -0.9% në vitin 2004) dhe pijet joalkoolike (-4.3% në vitin 2005 krahasuar me -3.1% në vitin 2004). Grupi i dytë, pijet alkoolike dhe duhani, ndoqi një trend tërësisht të ndryshëm. Kështu, rritja me 8.4% në vitin 2004 është tejkaluar nga rritja prej 13.2% në vitin 2005, ku më e konsiderueshmja është rritja prej 15.1% në çmimet e duhanit, e cila është 5.5 pikë përqindje më e lartë krahasuar me atë të vitit 2004. Çmimet e veshjeve dhe këpucëve patën një rënie në -7.1%, krahasuar me -6.3% në vitin 2004.

Strehimi, uji, energjia dhe të ngjashme me to, si zërat kryesorë brenda indeksit të mallrave të patregtueshëm, ndoqën një trend të kundërt në krahasim me trendin e ndjekur në vitin 2004. Në veçanti, gjatë vitit 2005 indeksi mesatar vjetor i mallrave të patregtueshme ranë në mënyrë të ndjeshme në -3.4%, krahasuar me 0.2% në vitin 2004. Përveç nëngrupit të furnizimit me ujë dhe të ndryshme, i cili në vitin 2005 u rrit në 7.5% (kundrejt 11.2% në vitin 2004), grupet e tjera përfaqësuan një trend zbritës. Duke pasuar zvogëlimin e pranisë së komunitetit ndërkombëtar në Kosovë, çmimet e qerasë për strehim u ulën në -1.7% në vitin 2005. I njëjti ritëm u ndoq dhe nga nëngrupi i mirëmbajtjes dhe riparimit të vendbanimit (-3.4%) dhe energjisë, gazit dhe karburanteve të tjerë (-4.1%).


3.1.3 Punësimi

Sipas vlerësimeve të stafit të FMN-së, përqindja e papunësisë në Kosovë është rreth 30%.¹⁰ Numri i të papunëve të regjistruar në fund të vitit 2005 ishte rreth 320 mijë, ose 26.1% e popullsisë së aftë për punë. Vetëm në vitin 2005 u regjistruan rreth 17.700 punëkërkuar të rinj (grafiku 16). Punëkërkuar të rinj përbëhen së pari nga të papunët e regjistruar të moshës ndërmjet 25 dhe 39 (44.0% e totalit të punëkërkuarëve), që është në shifrat 7.483 punëkërkuar të rinj; dhe së dyti nga të papunët e moshës ndërmjet 40 dhe 54, të cilët përfaqësuan 7.270 punëkërkuar të rinj gjatë vitit 2005.


Punëkërkuarët e moshës 16-24 përfaqësojnë 90.191 njerëz (82.921 në vitin 2004), duke përfaqësuar kategorinë e dytë më të madhe (grafiku 17). Përfaqësimi i tyre në totalin e të papunëve në vitin 2004 ishte 27.4%, duke u rritur në 28.2% në vitin 2005. Nga ana tjetër, punëkërkuarët e moshës 40-54 dhe 55 e lart u rritën në numër me përkatësisht 2.032 dhe 954, por përse i përket përfaqësimit të tyre në totalin e punëkërkuarëve, grupmosha e parë u ul nga 21.1% në vitin 2004 në 20.6% në vitin 2005, ndërkohë që grupmosha e dytë u ul nga 7.3% në 7.2%.

⁹ IÇK-ja bazë përjashton çmimet e ushqimit dhe të naftës, ndërsa IÇK-ja totale përfshin çmimet e ushqimit dhe të naftës.

¹⁰ FMN 2005, "Kosovo - Gearing Policies Toward Growth and Development."

Grafik 16. Numri i punëkërkuessve të regjistruar, 2001 - 2005

Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (2006)

Grafik 17. Numri i punëkërkuessve të regjistruar sipas grupmoshave, deri në 2005


Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (2006)

Përsa i përket klasifikimit rajonal, numri më i madh i të papunëve vjen nga rajoni i Prishtinës (29.277), ndjekur nga rajoni i Mitrovicës dhe Pejës, ku numri i të papunëve në vitin 2005 arriti në përkatësisht 25.914 dhe 14.839. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjatë vitit 2005 numri i punëkërkuessve të punësuar arriti në 5.094, ku sektori i shërbimeve thithi 37.0% (2.000 punonjës). Sektori i tregtisë është kategoria e dytë më e madhe me 17.2% ose 878 punëkërkuess të punësuar, ndjekur nga bujqësia, e cila punësoi 17.03% ose 868 punonjës. Gjatë vitit 2005, sektori i industrisë punësoi 11.7% ose 596 punëkërkuess.

3.1.4 Privatizimi

Në terma të përgjithshme, viti 2005 mund të konsiderohet i suksesshëm për sa i përket procesit të privatizimit. Në fund të vitit 2005, u lançuan 12 privatizime, prej të cilave tetë vetëm në vitin 2005. Rezultatet e tenderit u dhanë për gjashtë nga tetë të lançuara në vitin 2005. Për ta përmbledhur, deri në fund të vitit 2005, u privatizuan në mënyrë të suksesshme rreth 156 kompani, – 8 prej të cilave përmes zhvendosjes së veçantë të veprimtarisë (shpërndarja e aksioneve të një kompanie bijë ndërmjet aksionarëve të kompanisë mëmë). Totali i të ardhurave pritet të arrijë shumën 166.2 milionë euro, prej të cilave rreth 148.6 milionë për vitin 2005 (rreth 6.0% e PBB-së), ose mesatarisht 18.5 milionë euro për valë privatizimesh (grafiku 18).

Grafik 18. Të ardhurat kumulative nga procesi i privatizimit



Burimi: Agjencia e Trustit të Kosovës (2006)

Me një rëndësi të madhe janë kompanitë e privatizuara përmes procedurës së zhvendosjes së veçantë të veprimtarisë, për shkak të detyrimeve të lidhura, si p.sh. angazhimi i investimit dhe garancia e punësimit. Totali i të ardhurave nga tetë kompanitë e privatizuara përmes zhvendosjes së veçantë të veprimtarisë priten të arrijnë në 48.4 milionë euro, ku Ferronikeli ka pjesën më të madhe të të ardhurave me vlerë në rreth euro 33.0 milionë euro.

Totali i angazhimit të investimit të kompanive të privatizuara përmes zhvendosjes së veçantë të veprimtarisë arrin shumën e rreth 73.0 milionë euro. Numri i punonjësve përpara privatizimit në këto tetë kompani ishte rreth 2500. Procedurat e zhvendosjes së veçantë të veprimtarisë garantojnë një numër prej 3000 punonjësish për t'u punësuar në këto kompani, brenda një viti nga privatizimi


përfundimtar. Sërish, në këtë kontekst, Ferronikeli është kompania më e konsiderueshme me garanci punësimi prej deri në 1000 punonjës.

Por, tre nga tetë kompani në fund të vitit 2005 ishin ende në procesin e privatizimit (duke përfshirë Ferronikelin). Ky fakt dhe ritmet e fundit të procesit të privatizimit janë tregues të fortë që viti 2006 do të lulëzojë përsa i përket rezultateve të pritura të procesit të privatizimit.

3.2 Sektori Fiskal¹¹

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) e mbylli vitin me të ardhura që arritën në shumën 609.0 milionë euro dhe shpenzime që arritën në 712.3 milionë euro; për rrjedhojë deficiti për vitin 2005 ishte 96.9 milionë euro, i cili është 36.5 milionë më i ulët sesa deficiti i vitit 2004. Për pasojë, deficiti buxhetor në vitin 2005 u llogarit në 3.9% të PBB-së, krahasuar me 5.3% në vitin 2004. Ulja e deficitit qeveritar, siç tregohet dhe në grafikun 9, shpjegohet nga zvogëlimi i shpenzimeve qeveritare dhe nga një rënie modeste e të ardhurave të qeverisë. Brenda strukturës së shpenzimeve, rënia më e madhe u shënuar në shpenzimet për mallra dhe shërbime, dhe shpenzimet kapitale, ndërkohë që pagat, subvencionet dhe transfertat u rritën.

Grafik 19. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK), 2000 - 2005




Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së, korrik 2005

¹¹ Të dhënat më të fundit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave tregojnë se deficiti buxhetor në fund të vitit 2005 ishte rreth 60 milionë euro.

3.2.1 Të Ardhurat Buxhetore

Duke u llogaritur në 609.0 milionë euro në vitin 2005, të ardhurat qeveritare përfaqësuan një rritje minimale prej 0.1%, krahasuar me rritjen prej 4.3% në vitin 2004. Ndërkohë, përsa i përket pjesëmarrjes së tyre në PBB-në minimale, të ardhurat qeveritare përfaqësuan 24.8% të PBB-së, e cila është 0.5 pikë përqindje më e lartë sesa në vitin 2004.

Grafik 20. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës – Struktura e të ardhurave, 2004 dhe 2005



Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së, korrik 2005

Gjatë vitit 2005, struktura e të ardhurave qeveritare nuk pësoi ndryshime të mëdha. Siç përshkruhet në grafikun 10, në fund të vitit 2005, tatimet jo të drejtpërdrejta (të llogaritura në rreth 460 milionë euro) u llogaritën në rreth 76% të totalit të të ardhurave. Të ardhurat nga tatimet e drejtpërdrejta në fund të vitit 2005 u llogaritën në 69.5 milionë euro, krahasuar me 62 milionë euro në fund të vitit 2004. Taksat vendore, të cilat rezultuan më të ulëta sesa taksat e mbledhura në kufi, në vitin 2005 u rritën me 7.8%, duke rritur përfaqësimin e tyre në totalin e të ardhurave tatimore në rreth 22%. Përfaqësimi i të ardhurave, të mbledhura në nivelin e qeverisë lokale, është modest duke u llogaritur në rreth 3% të totalit të të ardhurave në vitin 2005.


3.2.2 Shpenzimet Buxhetore

Siç u theksua dhe më lart, rënia e deficitit qeveritar erdhi si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve qeveritare, të cilat në fund të vitit 2005 u llogaritën në 712.3 milionë euro, krahasuar me 748.5 milionë

euro në vitin 2004. Për herë të parë që prej vitit 2000, shpenzimet regjistruan një rënie vjetore me 4.8%, krahasuar me rritjen prej 37.9% në vitin 2004. Përsa i përket pjesëmarrjes së shpenzimeve në PBB-në nominale, në vitin 2005 ato u llogaritën në 29.0%, e cila është 0.9 pikë përqindje më pak krahasuar me pjesëmarrjen në vitin 2004. Struktura e shpenzimeve qeveritare ka pësuar ndryshime të lehta gjatë vitit 2005, e cila u karakterizua nga një rënie në vëllimin e shpenzimeve kapitale dhe atyre të mallrave dhe shërbimeve.

Pagat, si një nga përbërësit kryesorë të shpenzimeve qeveritare, u rritën në 190.7 milionë euro nga 184.2 milionë euro në vitin 2004. Pas rritjes prej 7.9% në vitin 2004 krahasuar me vitin 2003, shpenzimet në mallra dhe shpenzime shënuan një rënie të thellë prej 21.4%, duke ndikuar uljen e përfaqësimit në totalin e shpenzimeve qeveritare, të cilat në vitin 2005 qëndruan në nivelin 20.7%, nga 25.1% në vitin 2004.

Grafik 21. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës – Struktura e shpenzimeve, 2004 dhe 2005



Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së, korrik 2005


Llogaritur në 219.8 milionë euro, në vitin subvencionet dhe transferrat u rritën me 7.9% (10.4% në vitin 2004). Brenda strukturës së subvencioneve dhe transfertave, transferrat shoqërore janë nënpërbërësi kryesor, duke u llogaritur në rreth 50%. Në mënyrë të ngjashme, kategoria e subvencioneve dhe transfertave regjistruan një rritje të konsiderueshme me pjesëmarrje në totalin e shpenzimeve qeveritare që arriti në 30.0%. Shpenzimet kapitale (148.4 milionë euro në vitin 2005) u ulën me -12.2% krahasuar me vitin 2004, duke pasqyruar një rënie të konsiderueshme. Për rrjedhojë, shoqëruar nga shpenzimet në mallra dhe shërbime, shpenzimet kapitale janë kontribuesi kryesor i rënies së shpenzimeve të përgjithshme qeveritare. Kjo rënie mund të vihet re në grafikun 21, e cila

tregon se shpenzimet kapitale në vitin 2005 u ulën në 21.0% ndaj totalit të shpenzimeve, krahasuar me 23.4% në vitin 2004.

3.2.3 Skema Pensionale

Në vitin 2002, në Kosovë u paraqit një skemë e detyrueshme pensionale, bazuar në kontributet nga punëdhënësit dhe punonjësit (5% secili). Paratë e mbledhura përmes kësaj skeme administrohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

Grafik 22. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, shuma kumulative, 2002 – 2005, në miliona EUR



Burimi: BPK (2006)


Siç tregohet nga grafiku 22, totali i shumës së mbledhur nga skema në fund të vitit 2005 u llogarit në 143 milionë euro. Numri i kontribuesve në vitin 2005 arriti në rreth 188 mijë, krahasuar me përkatësisht 184 mijë dhe 125 mijë në vitin 2004 dhe 2003. Pothuajse të gjitha fondet e mbledhura investohen në tregjet e huaja financiare.

3.3 Sektori Financiar

3.3.1 Karakteristika të Përgjithshme

Pretendimet e brendshme përbëjnë një element shumë të rëndësishëm në tablonë e përgjithshme të kërkesës monetare në Kosovë. Pretendimet e brendshme përbëhen nga pretendimet neto të qeverisë qendrore dhe pretendimet e sektorit real. Kryesisht për shkak të rritjes së pretendimeve të sektorit real (kreditë), pretendimet e brendshme në vitin 2005 u rritën me 70.9%, duke u llogaritur në 351.5 milionë euro. Pretendimet e brendshme në vitin 2004 u llogaritën në 29.7% të pretendimeve të jorezidentëve, ndërkohë që në vitin 2005, ato u rritën në 46.9%.

Grafik 23. Struktura e pretendimeve të brendshme (në mijë euro), 2004 dhe 2005




Burimi: BPK (2006)

Duke qenë se korporatat financiare nuk kanë pretendime ndaj qeverisë, pretendimet neto janë të barabarta me detyrimet e qeverisë. Depozitat janë zëri kryesor që lidh sektorin fiskal me atë financiar. Depozitat e qeverisë qendrore në BPK në fund të vitit 2005 u llogaritën në 220.7 milionë euro. Megjithatë, duke e krahasuar me fundin e vitit 2004, kjo tregon për një rritje prej 3.9%. Brenda strukturës së bilancit të qeverisë në BPK, shumat e mbledhura përmes privatizimit në fund të vitit 2005 përfaqësuan 51.2% të bilancit të qeverisë (113.1 milionë euro). Ky raport është më i lartë krahasuar me vitin 2004 (16.8%).

Rritja në raportin e pretendimeve të brendshme ndaj mjeteve të huaja neto të korporatave financiare shpjegojnë faktin që korporatat financiare gjatë vitit 2005 u përqendruan më tepër në financimin e ekonomisë së Kosovës sesa në investimin e parasë jashtë. Kjo ishte kryesisht për shkak të rritjes së kredive të bankave të nivelit të dytë për ekonominë. Në fund të vitit 2005, pretendimet ndaj sektorit real (kreditë dhe pretendimet e tjera) qëndruan në nivelin 572.2 milionë euro, krahasuar me 418.0 milionë euro në vitin 2004 (ritje vjetore prej 36.9%).

Mjetet e Huaja Neto (MHN) të korporatave financiare, në fund të vitit 2005 qëndruan në nivelin 682.3 milionë euro, një rritje prej 6.7% krahasuar me vitin 2004. Në Kosovë, MHN-të përbëhen kryesisht nga investimet në letra me vlerë dhe depozitat. Llogaritur në 748.7 milionë euro në vitin 2005 (691.2 milionë euro në vitin 2004), pretendimet ndaj jorezidentëve ishin kontribuesi kryesor në rritjen e MHN-ve të përgjithshme të korporatave financiare. Rritja në pretendimet ndaj jorezidentëve ka ardhur kryesisht nga mjetet e huaja të BPK-së, të cilat u rritën me 14.5%, në të njëjtën kohë kur mjetet e KTD-ve (bankat e nivelit të dytë) u ulën me 0.9%. Edhe pse përfaqësojnë një rritje të dukshme prej 67.7% në baza vjetore, detyrimet ndaj jorezidentëve ende llogariten në jo më shumë se 8.9% të pretendimeve të jorezidentëve (66.3 milionë euro).

Grafik 24. Pretendimet e korporatave financiare ndaj jorezidentëve, 2004 dhe 2005




Burimi: BPK (2006)

Pretendimet ndaj jorezidentëve në fund të vitit 2005 u llogaritën në 748.7 milionë euro. Rritja vjetore prej 8.3% e pretendimeve ndaj jorezidentëve kryesisht iu atribuohet depozitave, të cilat kontribuan me 5.6 pikë përqindje. Pjesëmarrja e BPK-së ndaj totalit të depozitave (si pretendime ndaj jorezidentëve) në vitin 2005 ra në 50.5% (397.4 milionë euro) nga 55.5% në vitin 2004. Duke qenë se pretendimet e

Korporatave të Tjera Financiare (KTF) ndaj jorezidentëve janë të papërfillshme, pjesa tjetër e pretendimeve iu përket KTD-ve. Letrat me vlerë krahas aksioneve kontribuan me 0.9 pikë përqindje në rritjen e pretendimeve ndaj jorezidentëve, duke rritur madje vëllimin e tyre me 2.6%, krahasuar me vitin 2004. Në terma pjesëmarrjeje në totalin e pretendimeve ndaj jorezidentëve, letrat me vlerë krahas aksioneve pësuan rënie. Kështu, në vitin 2005, ato u ulën në 32.3% nga 34.2%. Pjesëmarrja e BPK-së dhe KTD-ve në totalin e letrave me vlerë krahas aksioneve u llogarit në 65.7% dhe 34.3% në vitin 2005, nga përkatësisht 52.6% dhe 47.4% në vitin 2004.

Detyrimet e korporatave financiare ndaj jorezidentëve gjatë vitit 2005 shënuan një rritje të dukshme. Këto detyrime në fund të vitit 2005, u rritën në 66.4 milionë euro nga 52.0 milionë euro në vitin 2004 (27.7%). Çfarë vihet re është fakti se detyrimet ndaj jorezidentëve u rritën në raport me pretendimet ndaj jorezidentëve. Në fakt, në fund të vitit ato u rritën me 1.3 pikë përqindje ndaj 8.9% të pretendimeve ndaj jorezidentëve. Kreditë, si përbërësi kryesor brenda strukturës së detyrimeve ndaj jorezidentëve, në fund të vitit 2005 u llogaritën në 67.7% (45.0 milionë euro) të totalit të detyrimeve ndaj jorezidentëve nga 65.6% në vitin 2004.

Grafik 25. Paraja e gjerë, 2000 - 2005



Burimi: BPK (2006)

Paraja e gjerë¹² në Kosovë, në fund të vitit 2005 u llogarit në 1.167 milionë euro, një rritje e ngadalësuar prej 3.7% kundrejt 9.2% në vitin 2004 krahasuar me vitin 2003. Siç tregohet nga grafiku 14 më lart, që prej vitit 2003, ka patur një rritje të depozitave (depozita të transferueshme dhe depozita me maturitet deri në dy vite), ndërkohë që në anën tjetër ka patur një rënie të valutës jashtë

¹² Përkufizimi i parësë së gjerë bazohet në EQB-në.

korporatave depozituese. Rënia më e shpejtë e valutës jashtë korporatave depozituese (e cila është një përbërës i M1) sesa rritja e depozitave të transferueshme, ka shkaktuar rënien në M1, gjithashtu. Në vitin 2005, krahasuar me vitin 2004, M1 pësoi një rënie me -9.0% kundrejt -14.7%.

Boks 1. Statusi ligjor i euros në Kosovë

Duke filluar nga janari 2002, euro u bë monedha *de facto* në Kosovë, dhe që prej asaj kohe është monedha ligjore në territorin e Kosovës. Pas luftës në vitin 1999, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/4, datë 2 shtator 1999, "Mbi monedhën e lejuar për t'u përdorur në Kosovë", paragrafi 1 përcakton se "Palët në një kontratë ose në çdo transaksion vullnetar mund të denominojnë transaksionet në monedhën e rënë dakord nga palët. Një marrëveshje e tillë do të gjykohet ekzistuese për çdo valutë të pranuar gjerësisht në territorin e Kosovës, me përjashtim të rasteve kur gjykohet ndryshe". Me fjalë të tjera, në rast se të gjitha palët e përfshira në transaksion bien dakord, atëherë teoritisht çdo valutë mund të përdoret në Kosovë. Megjithatë, vetëm valuta (ose valutat) e përcaktuara nga Rregullorja mund të përdoret për të mbajtur llogari ose për të kryer pagesa të detyrueshme.

Për rrjedhojë, Direktiva Administrative nr. 1999/2, datë 4 tetor 1999, "Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/4 i datës 2 shtator 1999 Mbi monedhën e lejuar për t'u përdorur në Kosovë" përcaktoi markën gjermane (DEM) si monedhën e vetme për mbajtjen e llogarive dhe kryerjen e pagesave të detyrueshme.

Për shkak të ndryshimit të markës gjermane në euro, Direktiva Administrative nr. 2001/24, datë 21 dhjetor 2001, "Amendimi i Direktivës Administrative nr. 1999/2 Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/4 Mbi monedhën e lejuar për t'u përdorur në Kosovë", zëvendësoi markën gjermane me euro. Për rrjedhojë, në praktikë, duke qenë se euro është monedha ligjore dhe llogaritë mbahen në këtë monedhë, pothuajse të gjitha transaksionet e kryera në Kosovë denominohen dhe paguhen në euro. Shpërndarja e kartëmonedhave dhe monedhave euro u krye nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK) me ndihmën e shteteve anëtare të BE-së.

Boks 2. Asetet dhe sfidat e Euroizimit në Kosovë

Euro ka sjellë në Kosovë stabilitetin e nevojshëm monetar duke ulur inflacionin, eliminuar riskun e kursit të këmbimit, i cili, për rrjedhojë, ndihmoi në zvogëlimin e kostove të transaksioneve dhe

nxitjen e tregtisë dhe investimeve. Duke qenë se euro pritet të inkurajojë më shumë investitorë të huaj për të investuar në Kosovë, industrinë e eksporteve priten të përforcohen në të ardhmen dhe në këtë mënyrë, të sjellin uljen e deficitit të llogarisë korrente.

Për shkak të mungesës së instrumenteve monetare tradicionale dhe ato të kursit të këmbimit, regjimi i valutës që është adoptuar në Kosovë deri në njëfarë mase mund të jetë sfidues. Kjo politikë kërkon nevojën e mekanizmeve të tillë si p.sh. lëvizshmëria e forcave të punës, apo fleksibiliteti i pagave dhe çmimeve. Gjithashtu, mungesa e huadhënësit të fundit në radhë në duart e BPK-së, e bën edhe më të rëndësishëm zhvillimin e një mbikëqyrjeje dhe rregullimi bankar efikas për të siguruar stabilitet financiar në Kosovë.

Pavarësisht nga kjo, duke patur parasysh përmasën dhe strukturën e ekonomisë së Kosovës, e cila është pjesë e një zone tashmë e euroizuar plotësisht ose pjesërisht, përfitimet nga një euroizim i plotë i tejkalon kufizimet e tij,

3.3.2 Zhvillimet në Sektorin Bankar

Asetet e bankave të nivelit të dytë në fund të vitit 2005 u llogaritën në 984.3 milionë euro, duke u rritur me 21.1%, krahasuar me vitin e kaluar. Më shumë se gjysma e aseteve të sektorit bankar përdoren për kreditimin e ekonomisë në vend (513.8 milionë euro), kryesisht për korporatat private jofinanciare. Nga ana tjetër, depozitat vazhduan të rriten duke u llogaritur në 836.6 milionë euro, duke rritur në këtë mënyrë besimin e popullsisë në sektorin bankar.

Struktura e sektorit bankar – Në fund të vitit 2005, në Kosovë¹³ operonin shtatë banka, dhe krahasuar me vitin e mëparshëm, nuk janë regjistruar ndryshime që lidhen me strukturën e tyre pronësore. Kështu, gjatë kësaj periudhe, dy banka ishin me kapital tërësisht të huaj, ndërsa pesë të tjerat me kapital pothuajse vendas.

¹³ Më 13 mars, 2006, BPK-ja i revokoi licencën një banke të nivelit të dytë.

Gjatë vitit 2005, bankat e nivelit të dytë në Kosovë e shtrinë rrjetin e tyre të punës, ku numri i njësive bankare u rrit në 224, krahasuar me 207 në vitin 2004. Zgjerimi i rrjetit të bankave të nivelit të dytë u shoqërua me rritjen e numrit të terminaleve të bankomateve (ATM) dhe Pikave të Shitjes (PSH), të instaluar në mbarë Kosovën. Në veçanti, në fund të vitit 2005, në total kanë qenë 102 ATM. Numri i transaksioneve gjatë vitit 2005 të kryera përmes ATM-ve arriti në rreth 2,200,000. Numri i terminaleve të PSH-ve u rrit gjithashtu gjatë vitit 2005 duke arritur në 1,406. Krahas ATM-ve dhe produkteve të tjera si kartat e kreditit dhe të debitit, (Visa, Master Card, dhe Maestro Card), bankat e nivelit të dytë gjithashtu lançuan *e-banking* (shërbime bankare në formë elektronike).

Në linjë me zgjerimin e rrjetit të tyre të punës, bankat e nivelit të dytë shënuan një rritje në numrin e të punësuarëve. Kështu, gjatë vitit 2005, punësimi në bankat e nivelit të dytë u rrit me 275 punonjës me kohë të plotë, duke arritur në total në 2,341 punonjës. Përsa u përket treguesve të produktivitetit të punës, shuma e aseteve të manaxhuara nga një punonjës arriti në 420,481 euro në vitin 2005, një rritje me 6.9%, krahasuar me 13.4% në vitin 2004. Në mënyrë të ngjashme, totali i kredive të manaxhuara nga një punonjës në fund të vitit u rrit me 21.4% duke u llogaritur në 219,503 euro, ndërkohë që totali i vëllimit të depozitave të manaxhuara nga një punonjës u rrit me 6.3%, duke u llogaritur në 357,393 euro.


Përsa i përket treguesit të 'bankarizimit', i cili mat numrin e qytetarëve¹⁴ të shërbyer nga një njësi bankare, ai pësoi një ulje me 6.0%, krahasuar me vitin 2004, me 8,922 qytetarë për njësi bankare. Një trend i ngjashëm u përjetua nga numri i qytetarëve të shërbyer për punonjës, i cili në fund të vitit 2005 ishte 854, shifër kjo që korrespondon me një rënie me 10.2%, krahasuar me vitin 2004. Përsa i përket numrit të llogarive në bankat e nivelit të dytë, në fund të vitit 2005, u regjistruan 635,394 llogari. Raporti i numrit të llogarive me numrin e qytetarëve arriti në 0.3, që tregon se 30% e popullsisë së Kosovës ka një llogari në bankat e nivelit të dytë në Kosovë.

Indeksi i Herfindahl-Hirschman (IHH), treguesi i cili mat përqendrimin në sektorin bankar, jep disa evidenca të rritjes së përqendrimit të sektorit bankar gjatë vitit 2005. Rritja në IHH u regjistrua për asetet, depozitat dhe veprimtarinë kredituese në sektorin bankar. Në veçanti, vlera e IHH-së për përqendrimin e aseteve u rrit me 45 pikë në 2,632. Në mënyrë të ngjashme, vlera e IHH-së për përqendrimin në veprimtarinë e kredidhënies u rrit në 2,462 pikë nga 2,191 pikë në vitin 2004. Megjithatë, rritja më e madhe në vlerën e indeksit u regjistrua nga indeksi i përqendrimit në tregun e pranimit të depozitave, i cili në fund të vitit 2005 arriti në 3,081 pikë (414 pikë më shumë krahasuar

¹⁴ Vlerësimet e stafit të FMN-së (korrik 2005).

me vitin 2004). Zhvillimet në indeksin e përqendrimit tregojnë se tregu i pranimit të depozitave është më i përqendruar krahasuar me tregun e kredihënies.

Grafik 26. Bankat e nivelit të dytë, Indeksi i Herfindahl- Hirschman, 2001 - 2005



Burimi: BPK (2006)

Shkalla e konkurrencës në sektorin bankar llogaritet gjithashtu nga pjesëmarrja e kombinuar e tre bankave në totalin e aseteve, depozitave dhe kredive të sektorit bankar (C3). Zhvillimet lidhur me këtë tregues kanë qenë të ngjashme me ato të IHH-së. Kështu, pjesëmarrja e aseteve të tregut të tre bankave më të mëdha u rrit me 5.5%, duke arritur në 79.4% të totalit të aseteve të sektorit bankar në vitin 2005. Depozitat e tre bankave më të mëdha përbënin 79.8% të totalit të depozitave të sektorit bankar, shifër e cila korrespondon me një rritje me 5.4% krahasuar me vitin 2004. Tre bankat më të mëdha manaxhuan 78.9% të totalit të kredive të dhëna nga bankat e nivelit të dytë, shifër e cila është 7.8% më e lartë krahasuar me vitin 2004. Pjesëmarrja e depozitave të dy bankave me kapital të huaj në totalin e depozitave të sektorit bankar u rrit nga 63.0% në 68.0% në vitin 2005.

Struktura e pronësisë së sektorit bankar deri më 31 dhjetor 2005, e llogaritur sipas kapitalit fillestar, ishte 55% kapital fillestar i huaj dhe 45% kapital fillestar vendas. Në Kosovë nuk ka banka me pronësi shtetërore, dhe një përqindje shumë e vogël e kapitalit fillestar në sistemin bankar mbahet nga ndërmarrjet me pronësi shtetërore.


Në fund të vitit 2005, totali i aseteve të sektorit bankar u llogarit në 984.3 milionë euro, një rritje me 21.1% krahasuar me 39.8% në vitin 2004. Siç tregohet në figurën 27, kredite e dhëna për ekonominë e brendshme vazhdojnë të jenë asetet bazë të bilancit të bankave. Në veçanti, kredite llogariten në

afërsisht gjysma e totalit të aseteve dhe në fund të vitit 2005, ato u llogaritën në 513.8 milionë euro. Kontributi i tyre arriti në 52.2% të totalit të aseteve, shifër e cila korrespondon me një rritje prej 6.2%, krahasuar me vitin 2004.

Në të kundërt, bankat e nivelit të dytë i ulën investimet e tyre në letra me vlerë me 25.8%. Kështu, në fund të vitit 2005, investimet e bankave në letra me vlerë ishin në 82.9 milionë euro, duke u llogaritur në 8.4% të totalit të aseteve. Bilancet me bankat e tjera u rritën me 19.4%, duke arritur në vitin 2005 në 221.9 milionë euro. 96.4% janë me bankat jorezidente, ndërkohë si total ato llogariten në 22.5% të bilancit të bankave, pak më e ulët krahasuar me vitin 2004 (23.3%).

Duke përbërë një pjesë të konsiderueshme në totalin e aseteve të sektorit bankar, asetet likuide (paratë *cash* dhe bilancet në BPK), nuk patën ndryshime të mëdha gjatë vitit 2005. Në fakt, ato përfaqësuan 13.4% të totalit të aseteve; *cash*-i dhe bilanci në BPK në fund të vitit 2005 u rrit në 131.7 milionë euro, krahasuar me 116.3 milionë euro në vitin 2004.

Grafik 27. Struktura e aseteve të bankave të nivelit të dytë në Kosovë, 2001 – 2005, në milionë euro




Burimi: BPK (2006)

Veprimtaria kredidhënëse e bankave të nivelit të dytë – Bankat e nivelit të dytë vazhdojnë të përmirësojnë rolin e tyre në sigurimin e ndërmjetësimit për ekonominë e brendshme. Në fund të vitit 2005, kreditë u llogaritën në 513.8 milionë euro, në krahasim me 373.7 milionë euro në vitin 2004, një rritje me 37.5%. Kontributi i kredive në totalin e aseteve u rrit me 6.2% krahasuar me vitin 2004, duke

përbërë 52.2% të totalit të aseteve. Totali i kredive si përqindje e PBB-së u rrit gjithashtu, duke përfaqësuar 20.9% të PBB-së në vitin 2005, krahasuar me 14.9% në vitin 2004.

Përsa i përket *klasifikimit sektoral të kredive*, shumica më e madhe u dha për korporatat jofinanciare, përbërë kryesisht nga Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) që operojnë në sektorin real. Megjithatë, pjesëmarrja e kredive për korporatat jofinanciare në totalin e kredive ka rënë gjatë viteve të fundit, për shkak se bankat janë duke e drejtuar gradualisht veprimtarinë e tyre kredihënëse drejt ekonomive familjare. Megjithatë ato u rritën në raport me totalin e kredive, kreditë për ekonomitë familjare ende përbëjnë pjesën më të vogël të totalit të kredive (24.5% në vitin 2005, nga 16.8% në vitin 2003). Shuma kumulative e kredive për ekonomitë familjare arriti në 125.9 milionë euro, e cila është 50.5% më e lartë krahasuar me vitin 2004.


Grafik 28. Struktura e kredive sipas sektorit, 2002 - 2005



Burimi: BPK (2006)

Struktura industriale e kredive nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2005, me një shumë të konsiderueshme të kredive e cila u kanalizua në veprimtaritë tregtare dhe e cila korrespondon me karakteristikat e ekonomisë së Kosovës. Duke ndjekur të njëjtin trend si në periudhat e mëparshme, në fund të vitit 2005, 64.4% e totalit të kredive për industrinë iu dha tregtisë. Kreditë e kanalizuar në sektorin e tregtisë u llogaritën në 249.6 milionë euro, duke përfaqësuar një rritje vjetore me 26.6%, krahasuar me vitin 2004 (shiko grafikun 29).

Grafik 29. Struktura e kredive sipas industrisë, 2004 dhe 2005




Burimi: BPK (2006)

Kreditë për sektorin e industrisë u llogaritën në 48.1 milionë euro, shifër e cila korrespondon me një rritje vjetore prej 35.4%. Në mënyrë të ngjashme, një rritje e konsiderueshme u shënuar për kreditë në veprimtaritë e ndërtimit, të cilat në fund të vitit 2005 arritën në 6.6% të totalit të kredive (sipas industrisë), krahasuar me 4.2% në vitin 2004. Në fund të vitit 2005, kreditë për ndërtim u llogaritën në 25.6 milionë euro. Me 3.2% të totalit të kredive, kreditë për sektorin e bujqësisë u llogaritën në 12.5 milionë euro, e cila është 57.7% më e lartë krahasuar me vitin 2004.

Përsa i përket *strukturës së maturitetit të kredive*, siç ilustron në grafikun 30, ka patur një zhvendosje graduale drejt kredive me maturitet më afatgjatë. Aktualisht, katër banka kanë marrëveshje huamarrjeje afatgjate (3-5 vite) me Kreditanstalt für Wiederaufbau's (KfW), e cila siguron një burim fondesh për kreditë afatgjata. Gjithashtu, një institucion mikro-financiar ka një marrëveshje të ngjashme huamarrjeje me Agjencinë Evropiane për Rindërtim (AER).

Ky zhvillim pozitiv pasqyron një ofertë më të gjerë të shërbimeve financiare nga ana e bankave të nivelit të dytë dhe aftësi më të mirë të kredimarrësit për të zhvilluar plane biznesi. Kjo është gjithashtu një shenjë besimi në ekonominë e Kosovës. Në veçanti, në fund të vitit 2005, kreditë me maturitet me mbi dy vite arritën në 44.8% të totalit të kredive, e cila është 12.7 pikë përqindje më shumë, krahasuar me kontributin e tyre në vitin 2004. Kështu, kreditë me maturitet me mbi dy vite u llogaritën në 230.1 milionë euro, duke përfaqësuar një rritje prej 92.1%, krahasuar me vitin 2004.

Grafik 30. Struktura e maturitetit të kredive, 2002 - 2005



Burimi: BPK (2006).


Kreditë me maturitet me mbi një vit dhe deri në dy vite u llogaritën në 146.3 milionë euro, e cila korrespondon me një rritje të moderuar me 15.6%, në krahasim me 49.3% në vitin 2004. Duke ndjekur këtë ngadalësim, në fund të vitit 2005 pjesëmarrja e tyre në totalin e kredive u ul në 28.5%, nga 33.9% në vitin 2004. Kreditë me maturitet deri në një vit përfaqësuan 26.8% të totalit të kredive (7.3 pikë përqindje më e ulët se në vitin 2004) dhe në fund të vitit 2005 ato u llogaritën në 137.5 milionë euro.

Boks 3. Përmasa dhe roli ndërmjetësues i sistemit bankar në Ballkanin Perëndimor

Në krahasim me sistemin bankar të vendeve të rajonit, sistemi bankar i Kosovës renditet në mesin e tyre përsa i përket përmasës së treguesve të sistemit bankar. Në veçanti, raporti i aseteve ndaj PBB-së për vendet e rajonit qëndron në rreth 61.4%, ndërkohë që në këtë drejtim, bankat e nivelit të dytë në Kosovë krahasohen në mënyrë të favorshme me disa prej këtyre vendeve. Në mënyrë specifike, asetet e sistemit bankar në Kosovë përbëjnë rreth 39.2% të PBB-së. Raporti më i lartë në rajon është regjistruar nga Kroacia në rreth 109% të PBB-së, ndërkohë që raporti më i ulët i aseteve është regjistruar nga IRJM-ja me 23.8% të PBB-së.

Përsa i përket rolit ndërmjetësues të bankave, Kosova renditet në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në mënyrë më specifike, raporti i kredive me PBB-në për Kosovën në vitin 2005 arriti në 20.9%. Për vendet e rajonit kjo varion nga 14.7% në Shqipëri në raportin më të lartë prej 62.9% në Kroaci, dhe me mesataren për rajonin në 26.4%.

Grafik 31. Totali i asetëve dhe kredive të sektorit bankar si % ndaj PBB-së, vende të zgjedhura të Ballkanit Perëndimor




Burimi: Business Monitor International (2006); BERZH (2005)

Bullgaria dhe Kroacia qëndrojnë mbi mesataren për dy treguesit e sistemit bankar, ndërkohë që e kundërta vlen për vendet e tjera, që janë Shqipëria, Bosnje Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi, dhe IRJM.

Struktura e detyrimeve të bankave të nivelit të dytë në Kosovë – Brenda strukturës së detyrimeve, depozitat shfaqen përbërësi më i konsiderueshëm i totalit të bilancit të bankave të nivelit të dytë. Burimet e bankave të nivelit të dytë vazhdojnë të rriten, megjithëse me një ritëm më të ngadaltë. Në fund të vitit 2005, depozitat në bankat e nivelit të dytë u llogaritën në 836.6 milionë euro, shifër e cila korrespondon me një rritje me 19.8% krahasuar me vitin 2004. Megjithëse kontributi i tyre pësoi një rënie të lehtë gjatë vitit 2005, depozitat e pranuar në bankat e nivelit të dytë në Kosovë u llogaritën në 85.0% të totalit të bilancit të bankave.

Pavarësisht nga fakti se ato ende mbeten në një nivel modest, bilancet nga bankat e tjera u rritën me 61.4% dhe në fund të vitit 2005 ato u llogaritën në 23.0 milionë euro. Duke ndjekur këtë rritje, bilancet me bankat e tjera në raport me totalin e bilancit të bankave u rritën gjithashtu, duke arritur në 2.3% në vitin 2005, ndërkohë që në vitin 2004 ato përbënin 1.8%.

Grafik 32. Struktura e detyrimeve të bankave të nivelit të dytë, 2001 – 2005, në milionë euro

Burimi: BPK (2006)


Huamarrjet e tjera në totalin e bilancit u llogaritën në vetëm 0.6% dhe në fund të vitit 2005 ato arritën në 6.4 milionë euro. Burimet e bankave të nivelit të dytë u llogaritën në 73.6 milionë euro, e cila korrespondon me një rritje prej 7.9%. Burimet e bankave u llogaritën në 7.5% të totalit të bilancit. Duke qenë se BPK-ja nuk është një bankë emetuese, bankat e nivelit të dytë nuk kanë detyrime ndaj BPK-së. Lidhja e vetme ndërmjet BPK-së dhe bankave të nivelit të dytë janë rezervat e mbajtura në BPK.

Struktura e depozitave në bankat e nivelit të dytë – Duke vazhduar trendet e periudhave të mëparshme, depozitat në sektorin bankar po vijojnë të rriten, por me një ritëm më të ngadaltë. Megjithatë, raporti i depozitave ndaj PBB-së është vazhdimisht duke u rritur dhe në vitin 2005, ai arriti në 34.1% të PBB-së, krahasuar me 27.7% në vitin 2004.

Brenda *strukturës së maturitetit* të depozitave, depozitat me maturitete më afatgjata janë duke e rritur pjesëmarrjen e tyre në mënyrë graduale. Veçanërisht, depozitat e transferueshme u rritën vetëm me 5.6% në vitin 2005, duke arritur në 35.5% të totalit të depozitave, krahasuar me 40.2% në vitin 2004. Për shkak të rritjes më të shpejtë gjatë këtij viti, depozitat e transferueshme u llogaritën në 296.6 milionë euro ose 17.9 milionë euro më shumë krahasuar me nivelet e vitit 2004. Depozitat e tjera (depozitat me afat dhe kursimet), të cilat janë përbërësi më i madh i totalit të depozitave janë duke e rritur pjesëmarrjen e tyre në totalin e depozitave në mënyrë graduale. Kështu në fund të vitit 2005,

ato u llogaritën në 64.5%, krahasuar me 59.8% në vitin 2004. Një pjesë e madhe e këtyre llojeve të depozitave vjen nga korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare.

Grafik 33. Struktura e depozitave sipas maturitetit, 2001 – 2005, në milionë euro



Burimi: BPK (2006)


Brenda strukturës së tyre, depozitat me maturitet deri në një vit përfaqësuan pjesëmarrjen më të madhe prej 85.5%, ndonëse pjesëmarrja e tyre ra në mënyrë të ndjeshme krahasuar me vitet e mëparshme (9.9% më e ulët krahasuar me vitin 2004). Megjithatë, depozitat me maturitet deri në një vit mbeten përbërësi kryesor i depozitave të tjera. Korrespondentja e uljes së depozitave me maturitet më afatshkurtër ishte rritja e depozitave me maturitet mbi një vit dhe ato mbi dy vite. Pjesëmarrja korresponduese e këtyre dy përbërësve të depozitave të tjera arriti në 10.7% dhe 3.8%, e cila krahasohet me përkatësisht 3.6% dhe 1.0% në vitin 2004.

Përsa i përket *llojit të depozituesve*, në fund të vitit 2005 depozitat e tjera të sektorit të brendshëm¹⁵ (brenda së cilit ekonomitë familjare përbëjnë 97.4%) përbënin pjesëmarrjen më të madhe të totalit të depozitave në bankat e nivelit të dytë. Kontributi i tyre në totalin e depozitave arriti në 55.8%, krahasuar me 54.4% në vitin 2004, ndërkohë që rritja e tyre pësoi një rënie nga 41.1% në vitin 2004 në 23.3% në vitin 2005. Për rrjedhojë, ato u llogaritën në 88.7 milionë euro më shumë krahasuar me vitin 2004, duke arritur në total në 466.7 milionë euro.

¹⁵ Kjo kategori përfshin ekonomitë familjare dhe Organizatat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare (OJSHEF).

Një pjesëmarrje tjetër e madhe është regjistruar nga depozitat e korporatave jofinanciare, të cilat në vitin 2005 u llogaritën në 38.5% (1.8% më e ulët krahasuar me vitin 2004). Për rrjedhojë, gjatë vitit 2005, ato u rritën me 42.1 milionë euro, duke u arritur në total në 321.8 milionë euro. Brenda strukturës së korporatave jofinanciare, korporatat publike jofinanciare rritën kontributin e tyre nga viti 2004 (62.2%) në 65.7% në vitin 2005, duke u rritur me 37.3 milionë euro dhe në total në 211.3 milionë euro. Rritja e depozitave të korporatave publike u pasua nga një rritje e lehtë e depozitave të korporatave të tjera jofinanciare (private dhe shtetërore), të cilat në vitin 2005 u llogaritën në 34.3% ose 4.8 milionë euro më shumë krahasuar me vitin 2004.

Grafik 34. Struktura e depozitave sipas sektorëve, 2004 dhe 2005



Burimi: BPK (2006)


Depozitat e korporatave financiare në vitin 2005 u rritën me 18.7%, ndërkohë që rritja në depozitat e qeverisë ishte 118.7%, ndonëse ato ende mbeten në nivele modeste. Në terma kontributi në totalin e depozitave, të dyja llojet e depozitave përfaqësojnë një kontribut të vogël prej përkatësisht 3.3% dhe 0.3%. Depozitat e jorezidentëve gjatë vitit u rritën ndjeshëm me 41.1%, kundrejt një rritjeje negative prej 36.7% në vitin 2004, duke përfaqësuar vetëm 2.1% të totalit të depozitave.

Spread-i i normës së interesit në Kosovë mbetet ende i lartë, megjithatë krahasuar me fundin e vitit 2004, të dhënat mbi huadhënien efektive dhe normat e depozitave tregojnë një tendencë rënese të *spread*-it. Ndërkohë që në fund të vitit 2004, *spread*-i i normave të interesit qëndroi në nivelin 12.15% (me normë depozite prej rreth 2.52% dhe normë huadhënieje 14.67%), në fund të vitit 2005 *spread*-i u ngushtua me 1.14 pikë përqindje për shkak të ndryshimeve të lehta në normat e interesit (norma e depozitës – 3.14%, norma e huadhënies – 14.15%). Normat e paraqitura këtu janë normat e interesit të depozitave (përrjashtuar depozitat e transferueshme) dhe të huadhënies, të peshuara sipas aktivitetit të të gjitha produkteve të ndryshme (shiko grafikun 26 tek Shtojca).

Boks 4. Depozitat e sistemit bankar si % ndaj PBB-së në vendet e Ballkanit Perëndimor

Përsa i përket kontributit të depozitave në PBB, sistemi bankar i Kosovës mbetet nën mesataren e nivelit të rajonit. Totali i depozitave të sektorit bankar në Kosovë në vitin 2005 arriti në 34.1% të PBB-së, ndërkohë mesatarja për rajonin ishte 42.4%. Përsa iu përket vendeve individuale të rajonit, kontributi më i ulët i totalit të depozitave të sektorit bankar ndaj PBB-së u regjistrua nga Mali i Zi (17.6%) dhe IRJM (33.0%), ndjekur nga Bosnje Hercegovina (34.1%). Nga ana tjetër, kontributi më i madh u regjistrua nga Kroacia, me 72.7%.

Grafik 35. Depozitat e sektorit bankar si % ndaj PBB-së për vitin 2005 (për disa vende të Ballkanit Perëndimor)



Burimi: Business Monitor International (2006); BERZH (2005).


Totali i depozitave të sektorit bankar përbën përkatësisht 56.6% dhe 51.9% të PBB-së në Bullgari dhe Shqipëri, ndërkohë që Serbia mbetet nën nivelin mesatar të rajonit me 39.0%.

Ecuria Financiare e Bankave të Nivelit të Dytë – Në përgjithësi, bankat e nivelit të dytë në Kosovë kanë rezultuar fitimprurëse gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare. Rritja e fitimit pas taksës ka qenë e fortë por gjatë vitit 2005 ajo ka pësuar një rënie të lehtë. Kështu, gjatë vitit 2005, sektori bankar i nivelit të dytë shënoi një fitim pas takse prej 13.2 milionë euro, që përfaqëson një rritje prej 2.1%, krahasuar me vitin 2004.

Të ardhurat neto mbi interesin, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të rezultateve operuese, u rritën me 29.1% në vitin 2005 kundrejt 73.2% në vitin 2004. Kjo rritje erdhi si rezultat i një rritjeje modeste në të ardhurat mbi interesin (me 33.7%, duke arritur në 72.2 milionë euro në vitin 2005) shoqëruar nga një rritje më e shpejtë në shpenzimet mbi interesin (54.0% duke arritur në 15.4 milionë euro në vitin 2005).

Ndryshimi në përbërjen e strukturës së bilancit pasqyrohet gjithashtu në përbërjen e të ardhurave mbi interesin. Kështu, pjesa më e madhe e rritjes së të ardhurave mbi interesin lidhet me rritjen e të ardhurave mbi interesin nga kreditë, të cilat llogariten në 90.8% të të ardhurave mbi interesin. Nga ana tjetër, të ardhurat mbi interesin nga bilanci i bankave të nivelit të dytë në vitin 2005 u rrit me 61.8%, por duke përbërë vetëm 5.5% të të ardhurave mbi interesin, kundrejt 4.5% në vitin 2004. Të ardhurat mbi interesin nga investimet në letrat me vlerë pësuan një rënie prej 22.0%, duke përfaqësuar vetëm 3.7% të totalit të të ardhurave mbi interesin, duke u llogaritur në 2.7 milionë euro.

Grafik 36. Struktura e të ardhurave, 2001 – 2005, në milionë euro




Burimi: BPK (2006).

Shpenzimet e interesit mbi depozitat, si përbërësi më i madh i shpenzimeve të interesit (90.3%), ishin gjithashtu kontribuesit më të mëdhenj në rritjen e këtyre shpenzimeve duke u rritur me 50.2% në vitin 2005, megjithëse me një rritje më të ulët krahasuar me vitin 2004 (93.2%). Nga ana tjetër, shpenzimet mbi huamarrjet u rritën ndjeshëm me 101.8% (nga baza e ulët), edhe pse ato ende mbeten në një nivel modest.

Brenda përbërjes së të ardhurave të jo-interesit, të ardhurat nga tarifat dhe komisionet dhanë kontributin më të madh në vitin 2005, duke regjistruar rritjen më të lartë prej 12.8%, krahasuar me 4.6% në vitin 2004. Nga ana e shpenzimeve të jo-interesit, provigjionet për humbjet nga kreditë kontribuan pozitivisht në rritjen e këtij lloji shpenzimi, duke u rritur në vitin 2005 me 30.4% dhe duke përfaqësuar 73.6% të totalit të shpenzimeve të jo-interesit (nga 74.1% në vitin 2004).

Grafik 37. Struktura e shpenzimeve, 2001 - 2005




Burimi: BPK (2006).

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të llogaritura në 43.8 milionë euro u rritën gjatë vitit 2005 me 29.2% kundrejt 33.8% në vitin 2004. Me këtë rritje të lehtë, kontributi i tyre u ul në 55.6% krahasuar me 57.7% në vitin 2004.

Rentabiliteti, Likuiditeti dhe Aftësia Paguese – Duke ndjekur trendet pozitive që prej vitit 2002, raportet e rentabilitetit janë stabilizuar me një rënie të lehtë, por duke mbetur ende në nivele të larta gjatë vitit 2005. Me asete mesatare që rriten me një normë modeste, rritja më e ngadaltë në fitimin pas taksës rezultoi në një rënie të ulët në kthimin në asete mesatare (ROAA) në 1.5% në vitin 2005 nga 1.9% në vitin 2004. Kthimi në kapital mesatar (ROAE), pas rritjes në vitin 2003 dhe 2004 në përkatësisht 24.5% dhe 26.2%, në vitin 2005 qëndroi në nivele të qëndrueshme në rreth 24.4%.

Grafik 38. Treguesit e kthimit, 2000 - 2005



Burimi: BPK (2006)


Treguesit e eficiencës së ndërmjetësimit dhe të ineficiencës së kostos¹⁶ për të gjitha bankat e nivelit të dytë në Kosovë nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha gjatë vitit 2005, krahasuar me periudhat e mëparshme. Marzhi i interesit neto (MIN) të bankave të nivelit të dytë shënoi një rritje të lehtë nga 5.5% në vitin 2004 në 5.8% në vitin 2005.

Treguesi i ineficiencës së kostos shënoi një rritje të lehtë, kryesisht për shkak të rritjes më të shpejtë të shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative. Për rrjedhojë, gjatë vitit 2005, ky tregues shënoi një rritje me 0.2 pikë përqindje, duke arritur në 4.5%.

Gjendja e likuiditetit të bankave të nivelit të dytë në Kosovë mbeti i lartë gjatë vitit 2005. Megjithatë, ka patur një rënie të lehtë në kontributin e aseteve likuide ndaj totalit të aseteve, të cilat në fund të vitit 2005 u llogaritën në 44.5% të totalit të aseteve (51.9% në vitin 2004). Nga ana tjetër, raporti i kredive ndaj depozitave u rrit më tej në vitin 2005 në 61.4%, duke pasqyruar kështu një rritje më të fortë të kredive, të cilat tejkaluan rritjen e depozitave në bankat e nivelit të dytë gjatë vitit 2005.


¹⁶ Ky tregues matet si raporti ndërmjet shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative dhe totalit të aseteve.

Grafik 39. Treguesit e ineficiencës, 2001 - 2005



Burimi: BPK (2006)

Grafik 40. Zhvillimi i treguesve të likuiditetit të bankave të nivelit të dytë, 2000 - 2005




Burimi: BPK (2006)

Gjatë vitit 2005, bankat e nivelit të dytë në Kosovë pësuan ndryshime të lehta përsa i përket klasifikimit të maturitetit të kredive në raport me depozitat. Në veçanti, kreditë me maturitet me mbi 2 vite u llogaritën në fund të vitit 2005 në 230.1 milionë euro (44.8% e totalit të kredive), ndërkohë që depozitat me të njëjtin maturitet qëndruan në 20.6 milionë euro, duke rritur kontributin e tyre ndaj kredive me maturitet me mbi 2 vite në 9.0% nga 3.4% në vitin 2004.

Kreditë me maturitet me mbi një vit dhe deri në dy vite ishin rreth tre herë më të larta sesa depozitat me të njëjtin maturitet, ndërkohë që kontributi korrespondues për kreditë me maturitet deri në një vit ishte 29.8%.


Grafik 41. Klasifikimi i maturitetit të kredive dhe depozitave të bankave të nivelit të dytë, fundi i vitit 2005



Burimi: BPK (2006)

Në përgjithësi, sistemi bankar është i mirë-kapitalizuar. BPK-ja i rriti kërkesat për kapitalin minimal për bankat në vitin 2002, 2003, dhe sërish në vitin 2005, me qëllim përafrimin e standardeve lidhur me kapitalin në linjë me direktivat e BE-së. Në vitin 2005, kërkesa për kapitalin minimal u rrit në 5.0 milionë euro.

Grafik 42. Zhvillimi i Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (RMK) në Kosovë, 2002 - 2005




Burimi: BPK (2006).

Veprimtaria rritëse e huadhënies dhe ndryshimet në strukturën e investimeve nga bankat e nivelit të dytë të Kosovë ka kontribuar në rënien e lehtë të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të bankave të nivelit të dytë në Kosovë është zvogëluar gradualisht gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare. Megjithatë, mjaftueshmëria e kapitalit të bankave të nivelit të dytë është ende mbi nivelin minimal të nevojshëm prej 12%. Raporti u ul proporcionalisht me rritjen e aseteve të ponderuara me rrezik (RWA), duke pasqyruar në këtë mënyrë rritjen e kreditimit të ekonomisë së brendshme gjatë kësaj periudhe. Kështu, në vitin 2005 RMK-ja e totalit të bankave të nivelit të dytë u llogarit në 14.7%, nga 16.7% në vitin 2004 dhe 17.1% në vitin 2003.

Boks 5. Rentabiliteti, likuiditeti dhe aftësia paguese e sektorit bankar në disa vende të Ballkanit Perëndimor

Sistemi bankar në Kosovë ka patur një ecuri pozitive krahasuar me rajonin, përsa iu përket treguesve të rentabilitetit, për shkak të rezultateve të tyre operuese të favorshme. Në mënyrë më specifike, kthimi në asete (ROA) për sektorin bankar në Kosovë u arrit në masën 1.5%, shifër e cila krahasohet me 1.1% e mesatares në rajon. ROA më e madhe u arrit nga sektori bankar në Bullgari (1.8%), ndjekur nga Kroacia (1.6%) dhe Shqipëria (1.4%). Në ndryshim, Mali i Zi (-0.3% në vitin 2004), Bosnja (0.6%) dhe Serbia (0.9%) shënuan vlerat më të ulëta të këtij treguesi.

Grafik 43. Treguesit e rentabilitetit të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor për vitin 2005




Burimi: Business Monitor International (2006); BERZH (2005)

Përsa i përket kthimit në kapital (ROE), sektori bankar në Kosovë shënoi vlerën më të lartë (24.4%), ndërsa ROE mesatare për rajonin qëndroi në nivelin 10.0%. Brenda vendeve të rajonit, Shqipëria shënoi nivelin më të lartë të ROE (17.9%), ndjekur nga Kroacia (14.5%) dhe Bullgaria (11.0%). IRJM dhe Serbia qëndruan nën mesataren me përkatësisht 8.7% dhe 5.1%.


Mesatarja e përbërësit të efikasitetit të ndërmjetësimit (NIM) për rajonin u llogarit në 4.0%, e cila është nën nivelin e arritur nga bankat e nivelit të dytë në Kosovë. Në veçanti, përsa i përket këtij treguesi, sektori bankar në Kosovë mbetet nën nivelin e arritur nga bankat në Malin e Zi, ndërkohë që qëndron mbi nivelin e vendeve të tjera të rajonit. NIM-i më i ulët u arrit nga bankat në Shqipëri (2.7%), duke pasqyruar kështu shkallën e ulët të ndërmjetësimit, ndjekur nga Kroacia (3.0%), IRJM-ja (3.1%) dhe Bosnja (3.5%).

Në mënyrë të ngjashme, sektori bankar në Kosovë shënoi nivele nën mesataren e treguesit të ineficiencës së kostos. Raporti ndërmjet kostove të përgjithshme dhe totalit të aseteve ishte 2.0%, ndërkohë që mesatarja për rajonin u llogarit në 3.7%. Bankat më pak eficiente kanë rezultuar ato në Bosnje (5.8%) dhe në Malin e Zi (5.1%), ndërkohë që bankat me më shumë eficiencë kanë qenë ato në Shqipëri (1.8%) dhe në Kroaci (2.3%).

Grafik 44. Treguesit e eficiencës të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor në vitin 2005

Burimi: Business Monitor International (2006); BERZH (2005)

Përsa i përket pozicionit të likuiditetit të sektorit bankar në rajon, mund të theksohet se ndërmjet tyre ka ndryshime. Raporti mesatar ndërmjet kredive dhe depozitave për rajonin u llogarit në 73.3%, ndërkohë që për sektorin bankar në Kosovë, ku raport arriti në 61.5%. Kjo tregon se pozicioni i likuiditetit të bankave të nivelit të dytë në Kosovë është i favorshëm. Raporti për Bosnje dhe Hercegovinën ishte më i larti në rajon, duke arritur në përkatësisht 108.5% dhe 103%. Nga ana tjetër, për shkak të ndërmjetësimit të ulët, Shqipëria regjistroi raportin më të ulët prej 28.5%.

Grafik 45. Raporti i kredive ndaj depozitave në disa vende të Ballkanit Perëndimor në vitin 2005

Burimi: Business Monitor International (2006); BERZH (2005)

Sistemi bankar në vendet e rajonit është i mirë-kapitalizuar. Raporti mesatar i mjaftueshmërisë së kapitalit për rajonin ishte 16.3%, ndërkohë që për Kosovën ky raport ishte 14.7%. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte veçanërisht i lartë në Malin e Zi (31.0%) dhe Serbi (27.9%), ndërsa raporti nën mesataren e rajonit u shënuar nga Kroacia (15.1%) dhe Kosova (14.7%).

3.3.3 Zhvillimet në Kompanitë e Sigurimeve

Në fund të vitit 2005, në Kosovë ushtronin veprimtarinë e tyre 8 kompani sigurimi, katër prej të cilave janë degë të kompanive të huaja (tre nga Shqipëria dhe një nga Kroacia) dhe katër të tjerat janë kompani me kapital vendor. Krahasuar me vitin 2004, numri i kompanive të sigurimeve që operojnë në Kosovë nuk pësoi ndryshime, ndërkohë që gjatë këtij pesëvjeçari janë vërejtur ndryshime lidhur me strukturën e tyre të pronësisë. Kështu, në vitin 2003 aksionet e një kompanie vendore u blenë nga një degë e huaj, duke e rritur numrin e degëve të huaja në katër.

Kompanitë e sigurimeve patën një ecuri të mirë gjatë vitit 2005. Totali i aseteve të kompanive të sigurimeve në Kosovë arriti në shumën 46.2 milionë euro, me një rritje prej 5.3% krahasuar me vitin 2004. Lidhur me pozicionin e tyre kundrejt sektorit të jashtëm, kompanitë e sigurimeve i ulën mjetet e tyre neto me 3.8%, të cilat në fund të vitit 2005 u llogaritën në 3.4 milionë euro.

Tabelë 2. Veprimtaria e kompanive të sigurimeve, 2001 - 2005

Përshkrimi	2001	2002	2003	2004	2005
Shuma e premieumeve të pranuar					
TPL	31,161	27,231	29,163	28,739	33,341
Polisat kufitare	.	3,686	6,557	8,604	7,061
Të tjera	.	66	1,340	1,747	6,811
Gjithsej	31,161	30,983	37,060	39,090	47,213
Numri e polisave të shitura					
TPL	179,864	175,008	199,223	241,901	233,770
Polisat kufitare	.	72,358	62,073	120,609	134,596
Të tjera	.	67	3,827	8,423	14,520
Gjithsej	179,864	247,433	265,123	370,933	382,886
Shuma e kërkesave të paguara					
TPL	2,655	3,540	5,576	6,163	7,665
Polisat kufitare	.	395	272	580	332
Gjithsej	2,655	3,935	5,848	6,743	7,997

Burimi: BPK (2006)

Depozitat e kompanive të sigurimeve në bankat e nivelit të dytë dhe në BPK, në fund të vitit 2005 arritën në 35.7 milionë euro, ndërkohë që në fund të vitit 2004 ato llogariteshin në 35.8 milionë euro. (51.2% e totalit të depozitave janë në bankat e nivelit të dytë, ndërkohë që pjesa tjetër gjendet e depozituar në BPK).

Shuma e premieeve të pranuar u llogaritën në 47.2 milionë euro, një rritje me 16.0% krahasuar me fundin e vitit 2004. Rritja në shumën e premieeve të pranuar lidhet me rritjen e numrit të policave të shitura. Veçanërisht, në fund të vitit 2005, numri i policave të shitura arriti në 372,886, një rritje me 1,953 polica krahasuar me vitin 2004 ose 107,763 polica krahasuar me vitin 2003. Përsa i përket strukturës së tyre, në fund të vitit 2005, 'Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë' (TPL) përfaqësoi 70.6% të totalit të shumës së premieeve të pranuar nga kompanitë e sigurimeve, ndërkohë që ato përbënin 60.0% të totalit të numrit të premieeve të shitura.

Shuma e pretendimeve të paguara në fund të vitit 2005 arriti në 8.0 milionë euro, shifër e cila korrespondon me një rritje me 18.6%, krahasuar me fundin e vitit 2004, ose 36.6% krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2003. Megjithatë, ky zë përfaqëson 16.9% të totalit të shumës së premieeve të pranuar. Ashtu si dhe me premiumet e pranuar, TPL përfaqëson pjesëmarrjen më të madhe prej 95.8% të totalit të shumës së pretendimeve të paguara. Në fund të vitit 2005, totali i shumës së parapagimit të premieeve dhe rezervave arriti në 22.1 milionë euro, një rritje prej 23.8%, krahasuar me vitin 2004.

Në përputhje me Rregullën 3 të BPK-së mbi Sigurimet, është krijuar një **Fond Garancie**. Kompanitë e Sigurimeve të cilat sigurojnë sigurimin TPL e krijuan këtë Fond përmes kontributeve të paguara. Fondi i Garancisë drejtohet nga Këshilli Drejtues, i përbërë nga një përfaqësues nga secila kompani e sigurimeve. Për të emëruarit në Këshill nevojitet miratimi paraprak nga BPK-ja. Fitimet bruto të Fondit të Garancisë për vitin 2005 tejkalojnë shumën 1,500,000 euro.

3.3.4 Zhvillimet në Fondet Pensionale

Skemat e pensionit në Kosovë klasifikohen si më poshtë:

Pensioni bazë paguhet nga Administrata e Pensionit, financuar totalisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës;

Pensioni i kursimeve individuale është një skemë e detyrueshme e administruar nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), financuar nga kontributet minimale të detyrueshme të punëdhënësve dhe punonjësve (5% secili); dhe,

Skemat suplementare, të cilat përbëhen nga: a. *Pensioni i Kursimeve Individuale* (është kontribut vullnetar shtesë i paguar nga punëdhënësi ose punonjësi, ose nga të dy, dhe i cili administrohet nga TKPK); b. *Pensionet Suplementare të Punëdhënësve* (paguar nga punëdhënësi për punonjësit); c. *Pensionet Suplementare Individuale*, dhënë për personat fizikë nga siguruesit e licencuar të pensioneve.


Në fund të vitit 2005, në Kosovë kryenin veprimtarinë e tyre 6 fonde pensionale. Gjatë periudhës së analizuar, shumat kumulative të mbledhura u llogaritën në 8.7 milionë euro (4.156 pjesëmarrës), shifër kjo e cila shoqërohet me një rritje prej 51.6%, krahasuar me vitin 2004. Përsa u përket skemave të detyrueshme, gjatë vitit 2005 shumat e mbledhura nga TKPK u llogaritën në 143 milionë euro, një rritje prej rreth 31.8%, krahasuar me fundin e vitit 2004.

3.3.5 Zhvillimet në Ndërmjetësuesit e Tjerë Financiarë

Ndërmjetësit e tjerë financiarë¹⁷ (NTF), si një burim tjetër i financimit të sektorit real, përfaqëson një kontribut prej rreth 4.0% të totalit të aseteve të sektorit financiar. Siç tregohet në grafikun 46, në fund të vitit 2005, totali i kredive kumulative të dhëna nga NTF-të përfaqësuan 9.1% të totalit të kredive të sektorit financiar, e cila korrespondon me një ulje prej 0.5% krahasuar me kontributin e arritur në fund të vitit 2004. Megjithatë, ky kontribut ka rënë vazhdimisht që prej vitit 2001, duke pasqyruar rritjen më të shpejtë në veprimtarinë e kredidhënies nga bankat e nivelit të dytë mbi tendencën rritëse në NTF-të. Në terma vëllimi, në fund të vitit 2005, kreditë e dhëna nga NTF-të arritën në 51.7 milionë euro, e cila korrespondon me një rritje prej 20.7%, krahasuar me vitin 2004.

Rritja në shumën e kredive të dhëna nga NTF-të u shoqërua nga rritja në numrin e kredive. Në fund të vitit 2005, numri i kredive të dhëna nga NTF-të arriti në 27,123 kredi, shifër e cila krahasohet me përkatësisht 22,286 dhe 19,061 në vitin 2004 dhe 2003. Gjithashtu, numri mesatar mujor i kredive të dhëna gjatë vitit 2005 arriti në 435. Në mënyrë të ngjashme, gjatë vitit 2005, shuma mesatare e dhënë për kredi arriti në 1,971 euro, e cila është 209.6 euro më e lartë krahasuar me mesataren për vitin 2004.

Grafik 46. Zhvillimi i veprimtarisë së kredidhënies së ndërmjetësve të tjerë financiarë, 2000 - 2005



Burimi: BPK (2006)

3.4 Sektori i Jashtëm

Llogaria korrente – Deficiti i llogarisë korrente (pas asistencës së huaj), për vitin 2005 qëndroi në 193 milionë euro (7.9% e PBB-së), ndërkohë që para asistencës së huaj u llogarit në 713 milionë euro (29.1% e PBB-së). Faktorët kryesorë në rritjen e deficitit të llogarisë korrente në vitin 2005 ishin trendet në importe dhe eksporte. Të ardhurat nga emigrantët, si zëri kryesor financues, në fund të vitit 2005 u llogaritën në 341 milionë euro, 14.1% e PBB-së nominale. Kufizimi në rritjen e importeve rezultoi kryesisht nga rritja më e lehtë në kërkesën e brendshme. Megjithatë, raporti i eksporteve dhe importeve për vitin 2005 llogaritet në rreth 7% (shiko tabelën 3).

Bilanci tregtar – Deficiti tregtar arriti në 854 milionë euro në fund të vitit (35% e PBB-së), një nivel mjaft i qëndrueshëm krahasuar me vitin 2004. Totali i eksporteve, duke përfshirë konsumin vendor të emigrantëve, për vitin 2005 u llogarit në rreth 68 milionë euro, shifër e cila korrespondon me një rënie prej 19.3%, krahasuar me vitin 2004. Përsa i përket strukturës së eksporteve, ajo nuk ka pësuar ndryshime të mëdha. Metalet bazë përbëjnë rreth gjysmën e të gjitha eksporteve të Kosovës, ndjekur nga lëkura, gëzofët e të ngjashme me to me 12.6%, dhe produktet vegjetale (5.6%). Përsa iu përket eksporteve, partneri kryesor tregtar mbetet Bashkimi Evropian (40.3%, kryesisht Italia dhe Greqia) dhe vendet e rajonit (45.9%, rreth 20 milionë euro), me IRJM (22.1%), Serbi dhe Mali i Zi (12.2%) dhe Shqipëri (11.6%).

¹⁷ Përbërë kryesisht nga institucionet mikrofinanciare.

Tabela 3. Bilanci i Pagesave, 2001 - 2005

(në milionë euro, nëse nuk ceket ndryshe)


	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Bilanci i mallrave dhe shërbimeve	-1,180	-901	-780	-753	-800	-806
<i>(në % të PBB-s)</i>	<i>-68.8</i>	<i>-36.9</i>	<i>-31.9</i>	<i>-31.1</i>	<i>-31.9</i>	<i>-32.9</i>
Bilanci tregtar	-1,174	-956	-838	-812	-848	-854
Eksporti	253	269	217	196	199	199
prej të cilës: eksporti i rregulltë	3	23	27	50	57	68
Importi	1,428	1,225	1,055	1,009	1,047	1,053
prej të cilës: importi komercial (fob)	979	986	920	920	979	1,004
Shërbimet	-6	55	58	59	48	48
Të ardhurat	-450	-519	-442	-340	-296	-252
Transferat	322	317	341	341	341	345
Remitancat	322	317	341	341	341	345
Llogaria rrjedhëse (para ndihmës së jashtme)	-1,308	-1,104	-880	-752	-755	-713
<i>(në % të PBB-s)</i>	<i>-76.3</i>	<i>-45.2</i>	<i>-36.0</i>	<i>-31.1</i>	<i>-30.1</i>	<i>-29.1</i>
Ndihma e jashtme	1,231	1,159	887	688	568	519
<i>(në % të PBB-s)</i>	<i>71.8</i>	<i>47.5</i>	<i>36.3</i>	<i>28.4</i>	<i>22.7</i>	<i>21.2</i>
Llogaria rrjedhëse (pas ndihmës së jashtme)	-77	56	7	-64	-187	-193
<i>(në % të PBB-s)</i>	<i>-4.5</i>	<i>2.3</i>	<i>0.3</i>	<i>-2.6</i>	<i>-7.5</i>	<i>-7.9</i>
Llogaria kapitale dhe financiare	-224	-228	-219	-22	105	60
Gabimet dhe lëshimet	301	173	212	85	82	134

Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së deri në korrik 2005

Përsa iu përket importeve, rritja vjetore e importeve të Kosovës në vitin 2005 ishte 0.6%. Përbërësit kryesorë të importeve të Kosovës janë produktet minerale (18.0%), ushqimet e përgatitura dhe duhani (14.5%), dhe pajisjet mekanike (11.2%). Sipas grupmallrave, rritja e importeve ka ardhur kryesisht për shkak të rritjes në importet e "mjeteve të transportit dhe të tjera" me 60 milionë euro dhe importet e "produkteve minerale" me 39 milionë euro.


Lidhur me importet e mallrave sipas vendeve, importet nga Serbia dhe Mali i Zi regjistruan rritjen më të madhe (1.2 herë më shumë) krahasuar me vitin e mëparshëm. Importet nga IRJM-ja dhe Bosnje dhe Hercegovina u rritën me përkatësisht 46.6% dhe 44.6%, ndërkohë që importet nga Shqipëria u ulën me 11.2% në vitin 2005. Aktualisht, raporti i importeve nga vendet e BE-së me totalin e importeve të Kosovës në fund të vitit 2005 u llogarit në rreth 35%.

Grafik 47. Struktura e eksporteve sipas vendeve dhe grupmallrave, në %, fund i vitit 2005



Burimi: BPK (2006)

Grafik 48. Struktura e importeve sipas vendeve dhe grupmallrave, në %, fundi i vitit 2005



Burimi: BPK (2006)

Totali i shumës së shërbimeve neto në fund të vitit 2005 u llogarit në 48 milionë euro. Shërbimet jofaktorë u llogaritën në 12 milionë euro, ndërsa shërbimet e tjera¹⁸ ishin 36 milionë euro (42 milionë euro në vitin 2004). Deficiti në llogarinë e të ardhurave u zvogëlua me 14.8%, kryesisht për shkak të uljes së pagave të emigrantëve. Zvogëlimi i pranisë ndërkombëtare rezultoi në uljen e pagave për emigrantët. Pagat u ulën nga 450 milionë euro në vitin 2000 në 253 milionë euro në fund të vitit 2005. Transfertat korrente (të ardhurat nga emigrantët kosovarë jashtë) vlerësohen në 345 milionë euro, një

¹⁸ Eksportet e shërbimeve faktorë përfshijnë shërbimet e dhëna nga punonjësit vendorë të KFOR-it.

shumë mjaft e qëndrueshme që prej vitit 2002. Asistenca e huaj pësoi një rënie prej 8.5% në vitin 2005, krahasuar me vitin 2004, kryesisht për shkak të rënies së veprimtarive të UNMIK-ut në Kosovë.

Llogaria Kapitale dhe Financiare – Llogaria kapitale dhe financiare e Kosovës u llogarit në 60 milionë euro në vitin 2005, në krahasim me 105 milionë euro në vitin 2004. Në mënyrë specifike, rritja e llogarisë kapitale dhe financiare ishte kryesisht për shkak të rritjes së MHN-ve të sistemit bankar me 47 milionë euro. Kjo rritje shpjegohet pjesërisht nga rritja e MHN-ve në BPK me 50 milionë euro, krahasuar me rënien prej 109 milionë euro në vitin 2004. Ndryshe nga flukset e BPK-së, mjetet e huaja neto të bankave të nivelit të dytë, në fund të vitit 2005 patën një rënie me 3 milionë euro. Krahas rritjes së MHN-ve të sistemit bankar, një tjetër rritje u regjistrua në mjetet e huaja të TKPK-së, të cilat në vitin 2005 u rritën me 45 milionë euro, duke qenë në pothuajse të njëjtat nivele me vitin 2004.

4. Mbikëqyrja Financiare

BPK-ja ka autoritet rregullator dhe zbatues për të gjitha institucionet financiare në Kosovë; ajo merr pjesë në zhvillimin dhe modernizimin e sektorit financiar, i cili aktualisht mbulon industrinë bankare, industrinë e sigurimeve, fondet pensionale dhe institucionet e tjera financiare (institucionet mikrofinanciare).

Synimi i BPK-së është që të ketë një mbikëqyrje financiare dhe një proces rregullator efikas, fleksibël dhe i cili promovon një sektor financiar konkurrues duke zbatuar parimet më të mira të standardeve ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit financiar.

Përqasja mbikëqyrëse e adoptuar nga BPK-ja bazohet në një sistem të bazuar në rrezik. Kjo përjasje ka për qëllim mundësimin e BPK-së që të përdorë burimet e saj mbikëqyrëse në ato fusha me rrezik më të lartë, brenda institucioneve individuale financiare dhe sektorit financiar në përgjithësi. Mbikëqyrja në bazë të rrezikut përqendrohet në aftësinë e manaxhimit për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rrezikun.

Në përputhje me legjislacionin i cili drejton funksionet e saj statutore (Rregulloret e UNMIK-ut 1999/21 dhe 2001/24), BPK-ja ka vendosur standarde dhe kërkesa mbikëqyrëse të hollësishme, në mënyrë që të arrijë një **sektor financiar** të mirë-rregulluar. Gjithashtu, këto Rregullore i japin Bordit Drejtues të BPK-së autoritetin për të adoptuar rregulla mbikëqyrëse të natyrës prudente, të cilat përcaktojnë limitet, direktivat operuese, procedurat dhe kërkesat raportuese për bankat dhe institucionet financiare jobankare, si dhe masat zbatuese në rast mospajtueshmërie me kërkesat ligjore ose për shkak të praktikave të pasigurta dhe joligjore.

Në përputhje me legjislacionin që drejton funksionin e saj statutor (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25), BPK-ja ka vendosur standarde dhe kërkesa mbikëqyrëse, në mënyrë që të arrijë një **sektor sigurimi** të mirë-rregulluar.

Rregulloret e institucionit financiar dhe rregullat prudente rishikohen dhe përditësohen vazhdimisht, për të siguruar që ato vijojnë të jenë në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare. Ato gjithashtu

rishikohen për të siguruar që ato vendosin ekuilibrin e duhur në krijimin e një mjedisi të mirë-rregulluar, pa vendosur barra të panevojshme për përdoruesit e shërbimeve financiare.

Gjatë vitit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Pensioneve u shkri me Departamentin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Ky departament është përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen rregullative të kompanive të sigurimit, ndërmjetësuesve dhe fondeve suplementare të pensioneve. Këto funksione zbatohen gjithashtu për siguresit e shërbimit të entiteteve pensionale, duke përfshirë Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), manaxherët e mjeteve dhe kujdestarët e aseteve të pensioneve.

4.1 Veprimtaria Rregullative e Sektorit Financiar

Si rregullator, BPK-ja merr pjesë në zbatimin e Rregulloreve përkatëse të UNMIK-ut. Kuadri ligjor për drejtimin e këtyre veprimtarive në përputhje me standardet e BE-së është përshtatur në nivelin aktual të zhvillimit të institucioneve financiare në Kosovë dhe gjithashtu është plotësuar me rregullat dhe vendimet e BPK-së.

Me qëllim përforcimin e kuadrit rregullativ dhe përmirësimin e **funksioneve të mbikëqyrjes bankare**, gjatë vitit 2005 Bordi Drejtues amendoi ose vendosi Rregullat e mëposhtme:

- Rregulla XI e amenduar mbi Raportimin e Bankave dhe Degëve Kosovare të Bankave të Huaja. Rregulla u amendua për qëllime statistikore, me synim përmirësimin e cilësisë dhe mbulimin e statistikave të sektorit financiar në përputhje me standardet e FMN-së.
- Rregulla XXI e amenduar mbi Rritjen e Kapitalit Minimal të Bankave. Rregulla u amendua me qëllim rritjen e kapitalit minimal të bankave, në shumën jo më pak se 5 milionë euro.

Me qëllim përforcimin e kuadrit rregullativ për **kompanitë e sigurimeve**, gjatë vitit 2005 Bordi Drejtues amendoi Rregullat e mëposhtme:

- Rregulla 4 e amenduar mbi Licencimin e Kompanive të Sigurimit të Përgjithshme dhe të Jetës. Rregulla u amendua me qëllim rritjen e kapitalit minimal për kompanitë e sigurimeve në 3 milionë euro.
- Rregullat 5, 5a, 5b, 5c të amenduara. Këto Rregulla u amenduan me qëllim ndryshimin e tarifave për licencimin e ndërmjetësuesve dhe kompanive të sigurimeve.
- Rregulla 3 e amenduar mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Automjeteve (TPL). Përmes këtij amendimi, do të rregullohet me ligj çështja mbi përdorimin e detyrueshëm të sistemit *on-line* dhe pagesën e premiumit të TPL-së së detyrueshme përmes bankës. Me ndryshimin e paragrafit 3.3 të kësaj Rregulle, do të rregullohet funksionimi i sigurimit të kufirit në përputhje me marrëveshjen e përbashkët nga kompanitë e sigurimeve të licencuara nga BPK-ja. Ndryshimi i kësaj rregulle shmang mundësinë e shitjes individuale të sigurimit të kufirit nga kompanitë e sigurimeve.

Gjatë vitit 2005, një ekspert ndërkombëtar hartoi amendimet e disa rregullave të sigurimit jo të jetës. Këto amendime përqendrohen mbi aftësinë paguese, kërkesat teknike, raportimin përmes analizës, risigurimin, investimet, dhe procedurat e arbitrazhit. Amendimet e hartuara janë tashmë nën rishikimin e BPK-së.

4.2 Veprimtaria Mbikëqyrëse dhe Zbatuese

4.2.1 Licencimi dhe Struktura

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/21, BPK-ja ka autoritetin për të vendosur kriteret për licencimin e një banke dhe për të refuzuar kërkesat për krijimin e bankave të reja, të cilat nuk i përmbushin këto standarde.

Strategjia e BPK-së në fushën e **licencimit bankar** përqendrohet në tërheqjen e investitorëve, të cilët duke patur gjendje të mira financiare me aksionerë dhe menaxhim të duhur, janë të aftë në zhvillimin e një përfaqëse të matur bankare për të mbrojtur interesat e klientëve, duke ndihmuar në këtë mënyrë në forcimin e sistemit bankar dhe rritjen e besueshmërisë ndaj tij.

Bankat e Nivelit të Dytë. Veprimtaria licencuese e BPK-së gjatë vitit 2005 lidhej kryesisht me hapjen e degëve të reja dhe me ndryshimet në strukturat e pronësisë së bankave.

Që nga nxjerrja e Rregullores së UNMIK-ut 1999/20 (amenduar me Rregulloren 2001/24) mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës në nëntor 1999, BPK-ja ka refuzuar 11 aplikime bankare për licencimin e degëve.

Në fund të vitit 2005, detyrimi ligjor i BPK-së për kapitalin minimal për një licencë bankare u rrit në 5 milionë euro. Deri më 31 dhjetor 2006, të gjitha bankat duhet të përmbushin këtë kapital minimal të detyrueshëm.

Numri i bankave operuese të nivelit të dytë gjatë vitit 2005 mbeti 7, numër i njëjtë që prej vitit 2003. Rrjeti bankar i punës me degë dhe nëndegë është rritur me 21 degë dhe nëndegë, duke përfshirë zyrat në pikat doganore, pikat e regjistrimit të mjeteve motorrike dhe qendrat e kontrollit teknik të mjeteve motorrike. Në fund të vitit 2005, 7 bankat operonin me 238 degë dhe nëndegë në gjithë Kosovën.¹⁹

Zyrat e Këmbimit dhe Agjencitë e Dërgimit të Parave. Në fund të vitit 2005 në Kosovë operonin gjashtë zyra këmbimi dhe dy agjenci të dërgimit të parave.

Institucionet Mikrofinanciare. Gjatë vitit 2005, nga BPK-ja u regjistrua një institucion mikrofinanciar i ri dhe u miratuan shtatë shoqëri krediti, të cilat i përkasin një institucioni mikrofinanciar. Në fund të vitit 2005, në Kosovë operonin 15 institucione mikrofinanciare dhe 4 institucione të tjera financiare jobankare

Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/25, BPK-ja ka autoritet licencues për **kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale dhe ndëmjetësuesit e sigurimeve**. Veprimtaria licencuese për katër vitet e fundit tregohet në tabelat si më poshtë:

¹⁹ 2006 Shënim – Në mbështetje të Rregullores së Misionit të Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK) Nr. 1999/21, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK), në kompetencat e tij të autoritetit të mbikëqyrjes bankare, përmes urdhërit datë 13 mars, 2006, i revokoi licencën Bankës Kreditore të Prishtinës. BPK emëroi Z. Michael Rouswell si Likuidatorin për Bankën Kreditore të Prishtinës dhe ai mori në kontroll operacionet drejtuese dhe manaxhuese të Bankës Kreditore të Prishtinë në orën 8:00 më 13 mars, 2006.

Tabelë 4. Veprimtaria e Licencimit të Kompanive të Sigurimeve, 2002 - 2005

Përshkrimi	2002	2003	2004	2005
Të licencuara paraprakisht	0	8	8	8
Të licencuara	8	1	2	1
Të anuluar	0	-1	-2	-1
Gjithsej	8	8	8	8

Burimi: BPK (2006).

Tabela 5. Veprimtaria e Fondeve Pensionale, 2002 - 2005

Përshkrimi	2002	2003	2004	2005
Të licencuara paraprakisht	0	5	6	6
Të licencuara	5	1	0	0
Të anuluar	0	0	0	1
Gjithsej	5	6	6	5

Burimi: BPK (2006)

Tabela 6. Veprimtaria e Licencimit të Ndërmjetësuesve të Sigurimeve, 2002 - 2005

Përshkrimi	2002	2003	2004	2005
Agjentë	231	307	446	658
Brokerët e kategorive shtesë	0	1	3	3
Brokerët	0	0	0	2
Rregulluesit e dëmeve	1	0	1	2
Rregulluesit e pavarur të ankesave	0	0	2	3

Burimi: BPK (2006)

Gjatë vitit 2005, BPK-ja licenoi një **kompani sigurimi** të re dhe revokoi licencën e degës së një kompanie tjetër sigurimi në Kosovë.

Fondet Pensionale Suplementare të Punëdhënësit. Në vitin 2005 nuk u licencua asnjë fond i ri. Një fond mbylli vullnetarisht veprimtarinë e tij, duke zvogëluar totalin e numrit të fondeve nga gjashtë në pesë. Kështu, numri i planeve pensionale të licencuara mbetet në pesë.

4.2.2 Veprimtaritë e Mbikëqyrjes Financiare

Një nga funksionet kryesore të BPK-së është që të kryejë mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, me qëllim krijimin e një sistemi financiar të shëndoshë, të hapur, konkurrues dhe të besueshëm dhe i cili ofron një fushë të gjerë shërbimesh bankare. Në kryerjen e këtij misioni, Drejtorati i Mbikëqyrjes Bankare është përgjegjës për licencimin, rregullimin dhe inspektimin e bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve jobankare që operojnë në Kosovë.

Objektivat kryesorë e mbikëqyrjes bankare janë ruajtja e fondeve të depozituesve dhe mbajtja e një sistemi financiar të qëndrueshëm duke krijuar një mjedis financiar efikas dhe konkurrues.

Direktorati i Mbikëqyrjes Bankare në BPK është përgjegjës për mirëmbajtjen ose promovimin e një:

SISTEMI FINANCIAR BANKAR DHE JOBANKAR TË QËNDRUESHËM

Promovimi i një sistemi financiar të sigurtë, të shëndoshë dhe të qëndrueshëm është një nga arsyet themelore të mbikëqyrjes dhe rregullimit të institucioneve financiare. Një sistem financiar i qëndrueshëm iu jep depozituesve një vend të sigurtë për të mbajtur paratë e tyre dhe bizneseve dhe individëve një sistem të besueshëm për kryerjen e transaksioneve monetare.

SISTEMI FINANCIAR BANKAR DHE JOBANKAR KONKURRUES

Një qëllim tjetër kryesor i mbikëqyrjes dhe rregullimit të institucioneve financiare është krijimi i një sistemi financiar konkurrues. Një sistem financiar konkurrues iu jep klientëve çmime më të ulëta dhe mallra dhe shërbime më të mira financiare.

SISTEMI FINANCIAR BANKAR DHE JOBANKAR TË NDRERSHËM

Një synim tjetër i rëndësishëm i rregullimit është mbrojtja e konsumatorit. Rregullat kërkojnë që institucionet financiare t'iu japin konsumatorëve informacione të cilat mund t'i ndihmojnë ata në vlerësimin e alternativave të produktit përpara tyre, si p.sh. mbi koston e kredisë, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dhe normën e vërtetë të kthimit në depozitat e tyre.

Rregullat e BPK-së dhe rregulloret e UNMIK-ut drejtojnë shumë aspekte të institucioneve financiare bankare dhe jobankare. Çështje të tilla si: kush zotëron, kontrollon dhe administron institucionet financiare; çfarë sasive kreditimi mund t'i japin institucionet financiare një klienti të vetëm ose grupe

klientësh; sa kapital duhet të kenë institucionet financiare; ku mund t'i vendosin institucionet financiare zyrat e tyre; dhe çfarë shërbimesh mund të ofrojnë ato, janë të gjitha çështje të rregulluara nga rregullat dhe rregulloret bankare dhe jobankare.

Objektivi kryesor i procesit të mbikëqyrjes është vlerësimi i sigurisë dhe efikasitetit të institucioneve financiare. Ky vlerësim përfshin vlerësimin e sistemeve të administrimit të rrezikut të institucionit, vlerësimin mbi gjendjen financiare, portofolin e kredisë dhe pajtueshmërinë me rregullat dhe rregulloret e zbatueshme bankare dhe jobankare.

Procesi mbikëqyrës përfshin inspektimin në vend dhe inspektimin dhe monitorimin përmes analizës. Në përgjithësi, stafi i BPK-së kryen inspektimin në vend të institucioneve financiare bankare dhe jobankare të paktën një herë në vit. Kjo rutinë mund të plotësohet me inspektime më të shpeshta "të targetuara", me qëllim ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme.

BPK-ja inspekton **veprimtarinë e institucioneve financiare** përmes:

- **Inspektimit përmes analizës** – mbledhja e informacioneve (raporteve, informacioneve dhe të dhënave, të cilat dorëzohen në BPK nga institucionet financiare bankare dhe jobankare) dhe **vlerësimi** i treguesve të operacioneve të tyre dhe krahasimi i tyre me limitet e përcaktuara, të dhënat e mëparshme dhe standardet e pranuar ndërkombëtare.
- **Inspektimit në vend** – Kryerja e vlerëimit cilësor të veprimtarive të institucioneve financiare bankare dhe jobankare përmes kontrollit të të dhënave të tyre të brendshme duke përdorur metodën e të bazuarit në rrezik.

Në inspektimin e institucioneve financiare përmes analizës, BPK-ja përdor analiza të vazhdueshme të cilat ndihmojnë në zbulimin e trendeve të padëshirueshme që zhvillohen në institucionet financiare dhe në industrinë financiare. Ky informacion mundëson që BPK-ja t'i drejtojë më mirë burimet e saj inspektuese në ato institucione që kanë nevojë për vëmendje mbikëqyrëse.

Inspektimi në vend është faza e mbikëqyrjes së gjetjes së faktit. Faktet analizohen për të përcaktuar gjendjen e institucionit financiar. Këto fakte përmbledhen në Raportin e Inspektimit dhe, bazuar në

gjetjet përcaktohet profili i rrezikut të institucionit financiar, i cili përcakton mënyrën sesi do të trajtohet institucioni nga mbikëqyrësit gjatë ciklit të ardhshëm mbikëqyrës.

Mbikëqyrja e përqendruar në rrezik – Duke qenë se institucionet financiare bankare dhe jobankare po rriten si në përmasa ashtu dhe në kompleksitet, BPK-ja ka lëvizur drejt një përqsasje mbikëqyrëse të përqendruar në rrezik, i cili është një proces më i vazhdueshëm sesa inspektimi i momentit. Synimi li procesit të mbikëqyrjes së përqendruar në rrezik është identifikimi i rreziqeve më të mëdha të një institucioni financiar dhe vlerësimi i aftësisë së manaxhmentit të institucionit për të identifikuar, monitoruar dhe kontrolluar këto rreziqe. Për këtë, BPK-ja përdor vlerësimin CAMEL.

Secilës bankë dhe institucioni i madh financiar jobankar i jepet një vlerësim që bazohet në vlerësimin e standardeve të rëndësishme financiare dhe operacionale në përputhje me kriteret dhe parimet e standardizuara. Ky sistem mbikëqyrës quhet ndryshe CAMEL, i cili është një akronim për pesë përbërësit e sistemit të vlerësimit: Mjaftueshmëria e kapitalit, Cilësia e aseteve, Manaxhimi dhe administrimi, Fitimet dhe Likuiditeti. Faktorët që merren parasysh gjatë vlerësimit të këtyre përbërësve përfshijnë:

- **Mjaftueshmëria e kapitalit** – Mjaftueshmëria e bazës së kapitalit, vlera dhe rezervat neto për mbështetjen e operacioneve aktuale, rreziku dhe rritja e mëtejshme e institucionit financiar.
- **Cilësia e aseteve** – Cilësia e kredive, investimeve dhe aseteve të tjera.
- **Cilësia e manaxhimit** – Aftësia e manaxhmentit për të administruar si duhet të gjitha aspektet e biznesit, dhe për të planifikuar në raste nevojash të mëtejshme dhe rrethanash të papritura.
- **Fitimet** – Aftësia për të gjeneruar fitime për mbulimin e shpenzimeve të tij, duke përfshirë marrjen e masave të duhura për humbjet e mundshme të kredive, pagesën e interesit mbi depozitat dhe sigurimi i duhur për paratë e depozituesve.
- **Likuiditeti** – Aftësia për të mbajtur asete likuide të mjaftueshme për mbulimin e nevojave aktuale, veçanërisht për tërheqjet e depozituesve.

Rezultatet e inspektimit në vend raportohen tek bordi i drejtorëve dhe manaxhmenti i institucionit financiar në një raport inspektimi bazuar në sistemin mbikëqyrës të vlerësimit CAMEL. Sistemi mbikëqyrës i vlerësimit CAMEL është një instrument mbikëqyrës i përdorur nga pjesa më e madhe e mbikëqyrësve bankarë në vendet e zhvilluara.

Secili përbërës i CAMEL-it vlerësohet nga **1** në **5**, ku **1** shpreh vlerësimin më të mirë dhe **5** më të ulët. Gjithashtu, institucionit financiar i jepet një vlerësim i përgjithshëm nga 1 në 5, vlerësim i cili vjen nga vlerësimet individuale përbërëse.

Direktorati i Mbikëqyrjes Bankare përqendrohet në zbatimin e kërkesave prudente (Rregullat dhe Udhëzimet) nga ana e institucioneve financiare me qëllim kufizimin e operacioneve riskuese nga ana e tyre. Këto përfshijnë si më poshtë:

Aftësinë pague – Nënkupton aftësinë e institucionit financiar për të mbuluar detyrimet me asete të vlefshme. Krahas kapitalit minimal të detyrueshëm, të gjitha bankat do të mbajnë një total kapitali ndaj raportit të aseteve të peshuara me rrezik prej 12% dhe kapital të nivelit të parë (bazë) ndaj raportit të aseteve të peshuara me rrezik prej 8%. Një synim kyç i kësaj Rregulle është që të sigurojë që institucionet financiare mbajnë kapital të mjaftueshëm për absorbimin në mënyrë të arsyeshme të humbjeve të mundshme.

Likuiditeti – Nënkupton aftësinë për të mbuluar detyrimet korrente me asete likuide. BPK-ja rregullon riskun e likuiditetit duke iu kërkuar bankave që të kenë një rezervë likuiditeti minimale, e cila është 10% e bazës së depozitës së bankës. Gjithashtu, bankat duhet të mbajnë të paktën 5% nga kjo 10% rezervë e detyrueshme likuiditeti si depozitë në BPK.

Inspektimi në vend – Grupi i BPK-së i inspektimit në vend kryen një vlerësim të hollësishëm të politikave, procedurave dhe praktikave të formalizuara të përdorura nga institucioni financiar për manaxhimin dhe kontrollin e portofolit të tij të kredive. Qëllimi i këtij inspektimi specifik të kredive është identifikimi i problemeve në fushën e kredive, duke qenë se kreditë zakonisht përfaqësojnë burimin më të madh të rrezikut në institucionet financiare. Ky rrezik kufizohet gjithashtu nga Rregulla e BPK-së, e cila përcakton se bankat nuk duhet të japin kredi për ndonjë huamarrës, ose grup huamarrësish, në shumën që tejkalon 20% të kapitalit të nivelit të parë (bazë) të bankës. Gjithashtu, BPK-ja ka vendosur një raport të totalit të kredive ndaj totalit të depozitave, i cili përgjithësisht nuk është më i madh se 70%.

Tabela 7. Sektori financiar: Inspektimet në vend të kryera gjatë vitit 2005

Lloji i kontrollit	Numri i kontrollimeve
Industria bankare	
1. Bankat - kontroll i plotë	6
2. Bankat - i fokusuar	5
3. Filialat e bankave - para hapjes dhe ri-alokuese	32
4. Inst. Mikrofinanciare - kontroll i plotë	9
5. Agjencionet për transferin e mjeteve - kontroll i plotë	2
6. Këmbimoret - kontroll i plotë	2
Industria e kompanive të sigurimeve	
1. Kompanitë e sigurimeve - kontroll i plotë	7
2. Kompanitë e sigurimeve - kontroll i fokusuar	6
3. Kompanitë e sigurimeve - agjentët	178
4. Brokerët e kategorive shtesë	3

Burimi: BPK (2006).

Objektivi i mbikëqyrjes së sigurimeve është mbrojtja e policëmbajtësve dhe përfituesve të policave. Për arritjen e këtij objekti, autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë metoda mbikëqyrëse, të cilat përfshijnë inspektimet në vend.

Inspektimet në vend janë një pjesë mjaft e rëndësishme e procesit të mbikëqyrjes, i lidhur ngushtë me procesin e inspektimit përmes analizës dhe monitorimit të vazhdueshëm. Ato mundësojnë mbikëqyrësin marrjen e informacioneve dhe detektimin e problemeve, të cilat nuk mund të merren apo të detektohen përmes monitorimit përmes analizës. Duke filluar nga muaji tetor 2004, Direktorati i Sigurimeve dhe Fondit Pensional është duke përdorur një sistem pikësh gjatë inspektimeve në vend për vlerësimin e secilës fushë të operacioneve dhe gjendjen e përgjithshme të secilës kompani të sigurimeve. Inspektimet në vend janë mjaft të nevojshme për përcaktimin e gjendjes financiare aktuale dhe në perspektivë e kompanisë.

Gjatë vitit 2005, Departamenti i Mbikëqyrjes së Pensioneve kreu katër inspektime në vend të fondeve vullnetare të pensioneve, ndërkohë që monitorimi përmes analizës kryhet çdo muaj. Inspektimet në vend u përqendruan në drejtimin e fondeve pensionale, saktësinë e kontributeve, mbajtjen e të dhënave, investimet në pensionet, dhe kontrollet e brendshme.

Inspektimet në vend plotësohen me informacionet nga tregu dhe statistikën e marra nga inspektimet përmes analizës të llogarisë dhe kthimit vjetor.

4.2.3 Autoritetet Formale të Mbikëqyrësve (Masat Zbatuese)

Bankat e nivelit të dytë. Pavarësisht nga përpjekjet e mbikëqyrësve, ka patur raste kur bankat nuk kanë plotësuar kërkesat mbikëqyrëse me natyrë prudente ose kur kanë përdorur praktika bankare të pasigurta dhe jo të shëndosha. Si rezultat i shkeljeve rregullative ose praktikave bankare të pasigurta dhe jo të shëndosha, gjatë vitit 2005, BPK-ja inicioi 18 masa zbatuese kundrejt bankave.

Sipas Rregullores 1999/21 masat zbatuese variojnë nga paralajmërimet me shkrim deri tek revokimi i licencës. Gjatë vitit 2005 u ndërmorën një sërë masash zbatuese, të bazuara në peshën e shkeljeve, ekspozimit ndaj rrezikut, shkeljeve të përsëritura, etj. Llojet e masave zbatuese përfshinin komunikimin me gojë dhe me shkrim, kufizimin e veprimtarive të caktuara, marrëveshjet formale ndërmjet BPK-së dhe bankave, kërkesat për rritjen e kapitalit fillestar, si dhe gjobat monetare.

Masat zbatuese të ndërmarra ndaj bankave kanë sjellë forcimin e gjendjes financiare të institucioneve financiare dhe zvogëlimin e rrezikut.

Kompanitë e Sigurimeve. Inspektimet e kompanive të sigurimeve gjatë vitit 2005 zbuluan shkelje të rregullave të sigurimeve, të cilat rezultuan në paralajmërimet me shkrim dhe gjoba monetare. Gjatë vitit 2005, BPK-ja ndërmori masa disiplinore kundër dymbëdhjetë kompanive të sigurimeve dhe të ndërmjetësimit.

4.3 Bashkëpunimi Rajonal Ndërkombëtar

BPK-ja vlerëson se bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar është me rëndësi të madhe për integrimin e saj në Ballkan, si dhe në komunitetin financiar ndërkombëtar. Për këtë arsye, BPK-ja ka kryer në mënyrë aktive veprimtari që synojnë përmirësimin e marrëdhënieve ekzistuese apo krijimin e marrëdhënieve të reja me bankat e tjera qendrore, autoritetet mbikëqyrëse, institucionet financiare ndërkombëtare si dhe organizatat financiare ndërkombëtare. Në këtë kontekst, synimi kryesor i BPK-së është adoptimi i praktikave dhe metodologjive më të mira ndërkombëtare, marrja e përvojës nga komuniteti financiar ndërkombëtar, si dhe shkëmbimi i pikëpamjeve dhe informacioneve me bankat e tjera qendrore dhe institucionet financiare.

Mbikëqyrja bankare ndërkufitare. Në përputhje me Parimet Bazë të Bazelit për Mbikëqyrjen efektive bankare, synimi i BPK-së është zbatimi i një mbikëqyrjeje efektive bankare. Një përbërës kyç i mbikëqyrjes së konsoliduar është vendosja e kontakteve dhe shkëmbimi i informacionit me autoritetet e tjera mbikëqyrëse. Kështu, me Bankën e Shqipërisë dhe Bankën e Sllovenisë janë nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi (MM) mbi mbikëqyrjen bankare ndërkufitare dhe shkëmbimin e informacionit. Në fund të vitit 2005, filluan diskutimet mbi nënshkrimin e MM-së me Agjencinë e Mbikëqyrjes dhe Rregullimit Bankar të Turqisë dhe me Bankën Kombëtare Bullgare.

MM Ndërkombëtare të Sigurimeve dhe Mbikëqyrja e Sigurimeve Ndërkufitare. Me qëllim përmirësimin e mbikëqyrjes së industrisë së sigurimeve dhe mbajtjes së tregjeve efikase, të ndershme, të sigurta dhe të qëndrueshme të sigurimeve për përfitimin dhe mbrojtjen e policëmbajtësve, BPK-ja është angazhuar në zgjerimin e bashkëpunimit të saj me Autoritetet e tjera Mbikëqyrëse të Sigurimeve. Kështu, me Shqipërisë, Kroacinë dhe IRJM janë nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi (MM) mbi bashkëpunimin në fushën e sigurimeve, shkëmbimit të informacionit dhe njohjes së përbashkët të Përgjegjësisë ndaj Palës së Tretë (TPL). Në vitin 2005, janë bërë mjaft përpjekje për nënshkrimin e MM-ve në fushën e Mbikëqyrjes së Sigurimeve me autoritetet respektive, si Kroacia, Turqia dhe Bullgaria, të cilat priten të finalizohen në vitin 2006.

Anëtarësimet në Mbikëqyrësit Financiarë Ndërkombëtarë. Me qëllim përmirësimin e vendosjes së politikave, standardeve dhe praktikave, shkëmbimit të informacionit, marrjen e përvojës dhe promovimin e praktikave të mira në fushën e mbikëqyrjes financiare, BPK-ja është anëtarësuar në rrjetin formal të rregullatorëve dhe mbikëqyrësve. Në vitin 2005, BPK-ja është pranuar si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) dhe në Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve. Gjithashtu, BPK-ja është renditur nga Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit të Bazelit në listen e kontakteve të mbikëqyrësve bankarë. Përveç kësaj, BPK-ja ka vendosur kontakte me Institucionet Ndërkombëtare Mbikëqyrëse dhe është ftuar të marrë pjesë në Komitetin e Mbikëqyrësve Bankarë të Evropës Lindore (BSCEE), në mars 2006.

Pjesëmarrja dhe kontributi në Konferenca dhe Forume në nivele Vendore dhe Ndërkombëtare. Gjatë vitit 2005, BPK-ja ka marrë pjesë në konferenca dhe forume të organizuara në nivel vendor dhe ndërkombëtar, me qëllim promovimin e zhvillimit të sektorit financiar, shkëmbimit të informacionit në përfitim të subjekteve të interesuara dhe publikut të gjerë, si dhe kontributin në stabilitetin e përgjithshëm financiar. Vlen të përmendet pjesëmarrja e BPK-së në Konferencën e Pestë Vjetore të Bankës së Shqipërisë dhe në Takimin e Gjashtë të Koordinatorëve Kombëtarë të Vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Moldavisë – Karta e BE-së për Ndërmarrjet e Vogla. Gjithashtu, BPK-ja ka

mbajtur një prezantim, organizuar nga BERZH-i mbi Përvojën e saj në Financimin e Biznesit të Vogël. Në bashkëpunim me Shërbimin Policor të Kosovës dhe Policinë e UNMIK-ut, BPK-ja ka organizuar një seminar mbi Zbulimin e Kartëmonedhave të Falsifikuara Euro dhe Luftën kundër Mashtrimit. BPK-ja gjithashtu ka marrë pjesë në Panairin e parë Financiar në Kosovë, organizuar në bashkëpunim me Shoqatën Bankare të Kosovës, Shoqatën e Institucioneve Mikrofinanciare dhe me Aleancën Kosovare të Biznesit.


Duke qenë të ndërgjegjshëm për situatën e veçantë përjetuar nga Kosova me përdorimin e saj të monedhës euro pa qenë anëtare e Euro sistemit, BPK-ja ka publikuar një Material Diskutimi mbi “Euroizimin jashtë Euro zonës: Asetet dhe Sfidat, përvoja e Kosovës”. Përmbajtja e këtij studimi u prezantua në një seminar mbajtur në Malin e Zi me pjesëmarrjen e bankave qendrore dhe institucioneve të ndryshme financiare.

5. Shërbimet dhënë Autoriteteve, komunitetit financiar dhe publikut

5.1 Operacionet dhe Manaxhimi i *Cash*-it


BPK-ja ka përgjegjësi për sigurimin e një furnizimi të duhur me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve të *cash*-it në ekonomi. Duke qenë se euro është valuta kryesore e lejuar për përdorim në Kosovë, përgjegjësitë e BPK-së lidhur me operacionet e dhe manaxhimin e cash-it lidhen me euron.

Grafik 49. Furnizimi me kartëmonedha euro



Burimi: BPK (2006)

Grafik 50. Furnizimi me monedha euro




Burimi: BPK (2006)

Siç tregohet në Grafikët më lart, gjatë vitit 2005, BPK-ja i furnizoi bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera me mbi 4.1 milionë kartëmonedha euro që arrinin në shumën prej afërsisht 205 milionë euro dhe 2.6 milionë monedha euro, që u llogaritën në gati 0.5 milionë euro. Llogaritur sipas vlerës, cash-i i furnizuar gjatë vitit 2005 u ul me pothuajse 16.8 krahasuar me vitin 2004, ndërkohë që struktura e furnizimit të cash-it sipas prerjeve ka ndryshuar dukshëm nga viti në vit. Ndërkohë që furnizimi me kartëmonedha të prerjes 5 euro u rrit, furnizimi me prerjet e tjera u ul. Përsa i përket monedhave, furnizimi me monedhën me prerje më të madhe (monedha 1 dhe 2-euro) u ul, ndërkohë që furnizimi me monedhën me prerje më të vogël (monedhat 1, 2, 5, 10, 20, dhe 50-eurocent) u rrit. Këtu vlen të përmendet rritja e theksuar nga viti në vit e furnizimit me monedha të prerjes më të vogël (monedhat 1, 2, 5-eurocent). Në vitet e mëparshme, gjendja (disponueshmëria) e monedhave me prerjen më të vogël në ekonomi ishte më e ulët sesa nevojitej, kështu që në vitin 2005, BPK-ja u angazhua në mënyrë aktive jo vetëm në furnizimin e bankave të nivelit të dytë me to, por dhe në promovimin e përdorimit të tyre nga agjentët e caktuar ekonomikë.

Nga ana tjetër, në vitin 2005, BPK-ja pranoi nga bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera më shumë se 7.2 milionë kartëmonedha euro dhe më shumë se 2.2 milionë monedha euro si depozita cash-i. Shpehur në vlerë, këto depozita arritën përkatësisht në afërsisht 453.7 milionë euro dhe 1.6 milionë euro. Në ndryshim nga cash-i i furnizuar nga BPK-ja, totali i vlerës së cash-it i depozituar në BPK tregon një rritje prej 7.5 për qind krahasuar me vitin e mëparshëm.


Në mënyrë të ngjashme me vitet e kaluara, në vitin 2005, cash-i i depozituar në BPK ishte më i lartë sesa cash-i i furnizuar nga BPK-ja. Llogaritur në rreth 249.8 milionë euro në vitin 2005, ndryshimi ishte më i ndjeshëm sesa në dy vitet e mëparshme, kur ishte përkatësisht rreth 176.8 milionë euro dhe 176.1 milionë euro. Duke qenë se BPK-ja mban në thesar vetëm nivelin minimal të detyrueshëm të cash-it duke eksportuar tepriçën në euro zonë ku ai kthehet në asete me interes të fituar, rritja vjetore e cash-it të depozituar mbi cash-in e furnizuar ka rezultuar gjithashtu në rritjen e eksportit të cash-it neto. Eksporti i cash-it neto në vitin 2005 në nivelin 237.5 milionë euro ishte shumë më i lartë sesa në vitet 2004 dhe 2003, kur ky nivel ishte përkatësisht 191 milionë euro dhe 167.2 milionë euro.

Procesimi i kartëmonedhave dhe monedhave të depozituara në BPK vijoi të kryhet përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat standarde. Gjatë vitit 2005, më shumë se 2.4 milionë kartëmonedha euro (33.7 për qind e kartëmonedhave euro të depozituara në BPK) u klasifikuan si të njollosura dhe u hoqën nga qarkullimi e u eksportuan në euro zonë. Një vëllim i tillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro të njollosura të hequra nga qarkullimi kontribuoi në përmirësimin e cilësisë së cash-it në qarkullim.

Grafik 51. Kartëmonedhat e njollosura të hequra nga qarkullimi në vitin 2005

Burimi: BPK (2006)


Cilësia e cash-it në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit me kartëmonedha të reja euro, të cilat u importuan nga euro zona. Gjatë vitit 2005, BPK-ja furnizoi me afërsisht 1.7 milionë kartëmonedha të reja euro (41.1 për qind e të gjitha kartëmonedhave euro të furnizuara). Shumica e kartëmonedhave të reja të furnizuara ishin kartëmonedha të prerjes së vogël, të cilat kryesisht iu furnizuan bankave të nivelit të dytë me qëllim furnizimin e ATM-ve të tyre. Kartëmonedhat e reja euro të furnizuara ishin të standardit më të mirë përse i përket cilësisë.

Grafik 52. Raporti i kartëmonedha të reja euro të furnizuara ndaj totalit

Burimi: BPK (2006)

Përsa iu përket masave kundër falsifikimit, BPK-ja vazhdoi gjatë gjithë vitit 2005 të analizojë rastet e kartëmonedhave të falsifikuara. Gjatë vitit, në BPK u dorëzuan 218 kartëmonedha euro të identifikuara si të falsifikuara, ku më pas BPK-ja i dorëzoi ato tek NJIFV²⁰. Pjesa më e madhe e kartëmonedhave të falsifikuara të raportuara ishin kartëmonedha të prerjes 50-euro (79) dhe kartëmonedha të prerjes 200-euro (43).

Grafik 53. Kartëmonedhat e raportuara të falsifikuara



Burimi: BPK (2006)

Me qëllim përmirësimin e qarkullimit të cash-it në ekonomi, në vitin 2005, BPK-ja zbatoi tre udhëzime dhe një rekomandim:

- Udhëzimi Nr. 2 "Mbi Shmangien e Kartëmonedhave të Falsifikuara Euro nga Qarkullimi",
- Udhëzimi Nr. 3 "Mbi Standardet Minimale për Klasifikimin e Gjendjes Fizike të Kartëmonedhave Euro nga Palët Tregtare",
- Udhëzimi Nr. 4 "Mbi Paketimin e Kartëmonedhave dhe Monedhave Euro për Depozitimin e Sasisë në BPK", si dhe
- Rekomandimi Nr. 1. "Mbi Kontrollin e Standardeve për Riciklimin e Kartëmonedhave nga Palët Tregtare".

Të tre udhëzimet dhe rekomandimi u përgatitën në përputhje me dispozitat përkatëse të BOE-së.

Në fund të vitit 2005, BPK-ja në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e UNMIK-ut dhe Shërbimin Policor të Kosovës organizoi një seminar mbi "Zbulimin e Kartëmonedhave të Falsifikuara Euro dhe


²⁰ Njësia Investiguese e Falsifikimit të Valutës (UNMIK dhe IPVO).

Lufta kundër Mashtrimit“. Seminari ishte dizenuar kryesisht për të gjithë përdoruesit profesionistë të cash-it, personat të cilët mbikëqyrin ose trajnojnë përdoruesit e cash-it, si dhe personat që merren me sigurimin. Ky seminar tërhoqi vëmendjen e një grupi të madh interesi, në të cilin u trajtuan jo vetëm veçoritë e sigurisë të monedhës euro, por dhe të dollarit amerikan.

5.2 Shërbimet për Thesarin

Funksioni i bankierit për Thesarin, BPK-së i është dhënë në përputhje me Rregulloren Nr. 1999/20, e amenduar, në paragrafin mbi autoritetet e veçanta të BPK-së. BPK-ja kryen shërbime bankare në emër të dhe për llogari të jo vetëm Thesarit, por dhe për IPVQ-të e tjera dhe për ATK-në. Ajo gjithashtu ofron shërbime bankare për kompanitë më të mëdha të shërbimeve publike. Në vitin 2005, në mënyrë të ngjashme me vitet e mëparshme, këto shërbime konsistojnë kryesisht në mirëmbajtjen e llogarisë dhe operacioneve të pagesës, duke përjashtuar kredidhënien.

Grafik 54. Zhvillimi i depozitave të Thesarit, IPVQ-ve dhe të ATK-së, 2004 - 2005



Burimi: BPK (2006)

Depozitat e Thesarit dhe të IPVQ-ve përbënin pjesën më të madhe të totalit të depozitave në llogaritë në BPK. Deri më 31 dhjetor 2005, depozitat e Thesarit dhe të IPVQ-ve u llogaritën në 113.7 milionë euro. Gjatë këtij viti, depozitat e ATK-së u rritën në mënyrë të konsiderueshme, për shkak të intensifikimit të procesit të privatizimit, duke arritur në fund të vitit në 113.1 milionë euro. Zhvillimi i depozitave të Thesarit dhe të IPVQ-ve, si dhe të ATK-së të mbajtura në llogaritë e BPK-së paraqitet në grafikun e mësipërm.

Gjithashtu, pjesa më e madhe e operacioneve të brendshme të pagesave kryhen në emër të dhe për llogari të Thesarit. Gjatë vitit 2005, BPK-ja vazhdoi të mbështesë përmirësimin e proceseve të transaksioneve dhe të bashkërendimit të Thesarit dhe të IPVQ-ve. Për disa agjenci qeveritare janë vendosur disa marrëveshje për të marrë raporte unike të detajuara lidhur me të ardhurat e mbledhura përmes sistemit bankar.

5.3 Manaxhimi i Mjeteve

Operacionet e përditshme të investimit të BPK-së, të cilat drejtohen nga dispozitat e Rregullores dhe Politikës së Investimit të BPK-së, janë përgjegjësia kryesore e Departamentit të Manaxhimit të Mjeteve në BPK. Politika e Investimit merr në konsideratë kufizimet e matura të rrezikut, duke i dhënë përparësi sigurisë dhe mjaftueshmërisë së likuditetit mbi të ardhurat.

Në operacionet e saj të investimit, Politika e Investimit të BPK-së drejton Departamentin e Manaxhimit të Mjeteve. Një vëmendje e veçantë i jepet objektivave kryesore të investimit të BPK-së, të cilat sipas përparësisë janë si më poshtë:

- siguria,
- likuiditeti, dhe
- kthimi në investime.

Siguria e Investimeve – Të gjitha operacionet e investimit kryhen me bankat më të vlerësuara, të cilat i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Politikën e Investimeve. Pjesa më e madhe e homologeve të investimit të BPK-së janë të vlerësuara në dy kategoritë e para më të mira (Aaa dhe Aa).


Likuiditeti – Likuiditeti i mjaftueshëm, në mungesë të huamarrjes, është me rëndësi të madhe për BPK-në. Portofoli i investimeve mbetet në të gjitha kohërat mjaftueshëmshik likuid me qëllim mundësimin e BPK-së për të përmbushur kërkesat e saj të fluksit të parasë. Në sigurimin e likuditetit të mjaftueshëm, ndihmojnë një mori instrumentesh dhe maturitetesh financiare, të cilat janë të mirë-ekuilibruara.

Kthimi në Investime – Departamenti i Manaxhimit të Mjeteve ka strukturuar portofolin e aseteve me objektivin e maksimizimit të kthimit në investime për BPK-në dhe prioriteti më i lartë është që ai të

mbetet i tillë. Për rrjedhojë, ky department identifikon oportunitetet më të mira të investimit në tregjet financiare të BE-së, me qëllim rritjen e të ardhurave të BPK-së.

Burimet financiare që ndodhen nën administrimin e BPK-së përbëhen nga depozita e IPVQ/MEF (53%) dhe, në një shkallë më të vogël, depozita e institucioneve të Sektorit Financiar (22%), ATK (16%), sektori jofinanciar (4%) dhe kapitali i BPK-së (5%).

Grafik 55. Burimet financiare, sipas origjinës, fundi i vitit 2005




Burimi: BPK (2006)

Rregullorja e BPK-së dhe Politika e Investimeve përcakton se krahas "kartëmonedhave dhe monedhave të mbajtura në Kosovë", gjithashtu 'ari', 'bilancet e bankës jashtë' dhe 'letrat me vlerë të borxhit të emetuara ose të garantuara nga shtetet ose bankat qendrore të Bashkimit Evropian' janë kategori të përshtatshme mjete për investimet e burimeve financiare të BPK-së. Shpërndarja aktuale e burimeve paraqitet në grafikun si më poshtë:

BPK-ja i mban depozitat e llogarisë rrjedhëse në një bankë qendrore dhe gjithashtu vendos depozita të tregut të parave në disa banka evropiane të nivelit të dytë, detyrimet afatshkurtra të të cilave vlerësohen si një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë më të njohura në mbarë botën të vlerësimit të kredive. Llogaritë e depozitave me bankat qendrore dhe të bankave të nivelit të dytë mirëmbahen me qëllim sigurimin e likuditetit të përditshëm, si dhe shërbimet e kleringut dhe të pagesave. Totali i depozitave në secilën bankë të nivelit të dytë nuk tejkalon 15% të portofolit të investimit të BPK-së dhe të gjitha limitet e depozitave individuale vendosen dhe rishikohen në mënyrë periodike në përputhje me rregullat e Politikës së Investimit.


Grafik 56. Shpërndarja e burimeve të BPK-së, fundi i vitit 2005



Burimi: BPK (2006)

BPK-ja gjithashtu investon në bono thesari, me maturitet brenda 180 ditëve, të cilat denominohen dhe paguhen në monedhën euro, dhe emetohen nga disa qeveri të Bashkimit Evropian. Të gjitha letrat me vlerë, aktualisht të përfshira në portofolin e Investimeve të BPK-së, karakterizohen nga një treg riblerjeje i thellë, likuid dhe i mirë-zhvilluar. Investimet në këto letra me vlerë kufizohen në 70% të totalit të portofolit të investimeve dhe jo më shumë se 40% e totalit të portofolit të investimeve investohet në letrat me vlerë të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose bankës së tij qendrore.

Grafik 57. Cilësia e mjeteve të investimeve të BPK-së, fundi i vitit 2005



Burimi: BPK (2006)

Në vitin 2005, cilësia e mjeteve të portofolit të investimeve të BPK-së u përmirësua në mënyrë të ndjeshme, siç demonstron nga cilësia e lartë e kreditimit të korrespondentëve të investimit, të gjitha të vlerësuara me 'A' ose më lart. Kjo dëshmohet dhe nga cilësia e lartë e kredisë së portofolit të investimeve, të gjitha të vlerësuara me A ose më lart, prej të cilave 50% të vlerësuara me AAA ose risk sovran, dhe 35% u vlerësuan me AA.

5.4 Shërbimet për Komunitetin Financiar


5.4.1 Sistemi i Pagesave

Një nga parimet kryesore të BPK-së është krijimi i një sistemi efikas dhe të sigurtë të pagesave në vend. BPK-ja e ka arritur këtë objektiv që prej krijimit të saj, dhe një hap i madh u hodh në maj të vitit 2001, kur u krijua Sistemi Ndërbankar i Kleringut (SNK) me qëllim lehtësimin e operacioneve të pagesave në vend përmes sistemit bankar.

BPK-ja jo vetëm drejton dhe monitoron SNK-në, por gjithashtu merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në operacionet e saj bashkë me të gjitha bankat e nivelit të dytë. Procedurat e kleringut dhe të shlyerjes përcaktohen bazuar në Rregulloren Nr. 2001/26 "Mbi Transaksionet e Pagesave" dhe në Rregullën Bankare Nr. XVIII "Mbi Kleringun dhe Operacionet e Llogarive të Shlyerjes."


Vëllimi dhe vlera e transaksioneve të kanalizuar përmes SNK-së është rritur në mënyrë të vazhdueshme, duke pasqyruar kështu rritjen e besimit në sistemin bankar vendor. Ndërkohë, SNK ka pësuar zhvillime të vazhdueshme teknike dhe mënyrat e kryerjes së transaksioneve janë kompjuterizuar dhe përmirësuar.

Në mënyrë të ngjashme me vitet e mëparshme, në vitin 2005 rritja vjetore si në vëllim ashtu dhe në vlerë të transaksioneve SNK ishte e ndjeshme. Gjatë vitit 2005, përmes SNK-së u kanalizuan rreth 327,3 mijë transaksione me një vlerë në total prej 1,932.8 milionë euro. Krahasuar me transaksionet SNK të vitit të mëparshëm, në vitin 2005, vëllimi i transaksioneve u rrit me 23.4%, dhe vlera e transaksioneve u rrit me 12.1%.

Grafik 58. Zhvillimi i vëllimit të transaksioneve të SNK-së (të dhëna standarde), 2002 - 2005

Burimi: BPK (2006)

Rritja e ndjeshme e transaksioneve SNK mund të vihet re gjithashtu nga të dhënat mesatare ditore. Vlera ditore e transaksioneve SNK në vitin 2005 ishte rreth 8.1 milionë euro, krahasuar me rreth 7.2 milionë euro në vitin 2004. Ndërsa, vëllimi ditor i transaksioneve SNK në vitin 2005 ishte rreth 1.4 mijë, krahasuar me rreth 1.1 mijë transaksione në vitin 2004.

Grafik 59. Zhvillimi i vlerës së transaksioneve SNK (të dhëna standarde), 2002 - 2005

Burimi: BPK (2006)

Pagesat e rregullta (pagesat e gjeneruara nga ana e një pale të vetme urdhëruese në llogari të një përfituesi të vetëm) përbënin rreth 99 për qind të transaksioneve SNK. Megjithatë, dallohen dy lloje të tjera transaksionesh: pagesat në masë (pagesa të gjeneruara nga ana e një pale të vetme urdhëruese

në llogari të shumë përfituesve) të cilat u rritën në vëllim në vitin 2005, dhe pagesat giro (pagesat e gjeneruara nga ana e shumë palëve urdhëruese në llogari të një përfituesi të vetëm) të cilat u lançuan në vitin 2005. Bazuar në kohën e kryerjes së kleringut dhe shlyrjes, transaksionet SNK përcaktohen si të paguara dhe të shlyera në fund të ditës (neto) ose të paguara dhe të shlyera menjëherë (në kohë reale). Në vitin 2005, rreth 99 për qind e transaksioneve SNK u paguan dhe u shlyen në sesione të rregullta në fund të ditës. Megjithatë, vlen të përmendet se vëllimi dhe vlera e transaksioneve SNK të paguara dhe të shlyera menjëherë u rrit ndjeshëm në vitin 2005.

Si një pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në SNK, BPK-ja merr pjesë në kanalizimin e pagesave vendore/urdhër transfertave në emër të ose për llogari të klientëve të saj. Gjatë vitit 2005, BPK-ja dërgoi përmes SNK-së mbi 91.2 mbi urdhra dalëse (pagesa/transferta në emër të klientëve të saj), dhe pranoi përmes SNK-së 50.3 mijë urdhra hyrëse (pagesa/transferta për llogari të klientëve të saj). E shprehur në vlerë, shuma e urdhrave dalëse në vitin 2005 ishte 696.8 milionë euro, dhe shuma e urdhrave hyrëse ishte 826.5 milionë euro. Në terma vlere dhe vëllimi të transaksioneve, BPK-ja mbetet pjesëmarrësja më e madhe në SNK.

5.4.2 Kos-giro

Skema për pagesat *giro*, njohur si Kos-giro, u lançua zyrtarisht në vitin 2005. Kjo skemë është një arritje në zhvillimin e pagesave me vlerë të vogël/vëllim të madh. Ajo ka për qëllim lehtësimin e pagesave me faturë përmes standardizimit dhe automatizimit të një skeme efikase për të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë: BPK, bankat e nivelit të dytë, faturuesit e mëdhenj dhe paguesit e tyre.

Kos-giro bazohet në standardet e pranuar ndërkombëtare dhe ajo mundëson rrugën për paguesin që të paguajë faturat tek faturuesit përmes sistemit bankar. Faturuesi i dërgon paguesit faturën me një formular standard pagese i bashkëngjitur, i cili përmban të dhënat e pagesës në një *bar code*. Kur formulari paraqitet në bankë, të dhënat e pagesës automatikisht merren përmes pajisjes lexuese të *bar code*-it dhe kështu fillon kryerja e pagesës; llogaria e paguesit debitohet ose paguesi paguan në para *cash*. Nëse faturuesi ka llogari në të njëjtën bankë, pagesa kryhet menjëherë përmes kreditimit të llogarisë së faturuesit. Një mënyrë alternative është kryerja e pagesës përmes kanalizimit në SNK. Gjithashtu, Kos-giro mundëson një mënyrë të standardizuar dhe efikase për sigurimin e të dhënave të nevojshme faturuesit për bashkërendimin e automatizuar.

Përsa i përket lançimit të Kos-giro, BPK-ja ka luajtur rolin e zhvillimit dhe manaxhimit të këtij produkti, dhe ajo është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kësaj skeme. BPK-ja filloi zhvillimin e skemës Kos-giro në vitin 2004, në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në, të gjitha bankat e nivelit të dytë dhe dy shërbimet (faturuesit) më të mëdha publike në Kosovë: kompania e telekomit - PTK dhe kompania energjitike - KEK. Skema është dizenuar për faturues të tjerë të mëdhenj, gjithashtu.

Kos-giro ka impakte pozitive për BPK-në, bankat e nivelit të dytë, faturuesit e mëdhenj dhe paguesit. Së pari, ai kontribuon në arritjen e objektivave kryesore të BPK-së duke përmirësuar efikasitetin e sistemit të pagesave në vend dhe likuiditetin në ekonomi. Kos-giro e ka përmirësuar sistemin e pagesave me një skemë moderne pagesash, e cila kontribuon në zvogëlimin e përdorimit të *cash*-it në qarkullim, rritjen e depozitave në bankat e nivelit të dytë, dhe në përmirësimin e likuiditetit në tërësi. Së dyti, ai iu mundëson bankave të nivelit të dytë që të përmirësojnë shërbimet ndaj klientit dhe procesimin më të shpejtë dhe në mënyrë më efektive të pagesave. Së treti, ai iu ofron faturuesve të mëdhenj efikasitet të përmirësuar dhe reduktim të kostos, si dhe informacione më të shpejta dhe të sakta mbi gjendjen e tyre financiare dhe të përgjithshme. Së fundi, Kos-giro iu mundëson paguesve një zgjedhje tjetër për pagesën e faturave, e cila është jo vetëm efektive, por dhe e volitshme.

5.4.3 Regjistri i Kredive të Kosovës

Zhvillimi një regjistri modern të kredive filloi në vitin 2004 dhe vazhdoi gjatë vitit 2005. Ai u zhvillua nga BPK-ja në bashkëpunim me kredihënësit dhe u financua nga Banka Botërore. Pas fazës së testimit në fund të vitit 2005, regjistri i zhvilluar i kredive, njohur si Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK), u lançua në fillim të vitit 2006.

Fillimisht, Rregulla Bankare Nr. XXVIII "Mbi Raportimin e Kredive", miratuar në muajin nëntor 2004, bëri raportimin e informacionit të kredive nga kredihënësit të detyrueshëm, dhe gjithashtu rregulloi mbledhjen e të dhënave mbi raportimin e kredive të huamarrësve të mundshëm. Në të njëjtën kohë, BPK-ja inicioi zhvillimin e një sistemi bashkëkohor të teknologjisë informative për regjistrin e kredive. Puna mbi zhvillimin e sistemit të teknologjisë informative të regjistrin të kredive vijoi në vitin 2005, ndërkohë që BPK-ja përfshiu në projekt dhe i njohu me regjistrin e kredive të gjitha institucionet kredituese (bankat e nivelit të dytë dhe institucionet mikrofinanciare). Krahas Rregullës Bankare Nr. XXVIII dhe bazuar në sistemin e zhvilluar të RKK-së, BPK-ja përgatiti Udhëzime Operacionale lidhur me RKK-në.

Sistemi i RKK-së është dizenuar si një aplikacion i bazuar në web, i cili mundëson përdorimin *online* dhe në kohë reale të tij nga stafi i autorizuar i institucioneve kredituese. Institucionet kredituese, duhet të shënojnë në sistem kreditë e miratuara deri në fund të ditës tjetër të punës pas datës së tyre të vlerës. Më pas, ato duhet të përditësojnë statusin e secilës kredi në baza mujore brenda ditës së 15-të kalendarike të muajit vijues.

Institucionet kredituese mund të marrin nga sistemi një raport përmbledhës mbi nivelin dhe statusin e kredive të secilit aplikues/huamarrës. Ata gjithashtu do të njoftohen mbi kolateralin në rastet e kolateralizimit. Përveç kësaj, ata do të marrin informacione të nevojshme mbi lidhjen e aplikuesit për kredi me kreditë e tjera. Megjithatë, me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit të biznesit të tyre, institucionet kredituese nuk informohen mbi kushtet e kredive të miratuara dhe mbi identitetin e institucioneve kredituese, të cilat kanë miratuar këto kredi. RKK-ja është dizenuar gjithashtu që secili person i interesuar mund të marrë informacione mbi kreditë e tij përmes BPK-së. Ai gjithashtu i shërben Mbikëqyrjes Bankare të BPK-së për qëllime mbikëqyrjeje.

Të gjitha të dhënat e regjistruara në RKK sigurohen sipas parimeve më të mira ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të dhënave. Konfidencialiteti i çdo të dhëne mbi personin është i garantuar. Të dhënat mbahen në sistem për pesë vite pas mbylljes së kredisë. Të gjitha të dhënat më të vjetra se pesë vite do të arkivohen.

Si projekt, RKK-ja ka për qëllim sigurimin e një infrastrukture më të mirë për funksionimin e tregut financiar. Ai do të jetë një instrument i institucioneve kredituese për vlerësimin më të mirë të aftësisë paguese të huamarrësit/aplikuesit të kredisë dhe rreziqeve të mundshme, dhe për rrjedhojë, do të lehtësojë huadhënien, si në vëllim ashtu dhe në kosto.

5.5 Veprimtaritë lidhur me Kërkimet dhe Statistikat

Në vitin 2005, BPK-ja përmirësoi funksionin e saj në dhënien e informacioneve për publikun mbi zhvillimet në ekonominë e Kosovës, me theks të veçantë në zhvillimet e sektorit financiar. Kjo u arrit përmes përmirësimit të cilësisë së publikimeve ekzistuese dhe botimin e publikimeve të reja.

BPK-ja vijoi me publikimin e Buletinit Mujor Statistikor (BMS) me përmbajtjen e tanishme që mbulon statistikat monetare dhe financiare, si dhe statistika të sektorëve të tjerë. Lidhur me këtë, është krijuar një *software* i ri mbi statistikat monetare dhe financiare. Mjaft përpjekje janë bërë në publikimin e të

dhënave të **serive kohore** të përfshira në BMS, të cilat iu prezantuan publikut në fillim të vitit 2006. Gjithashtu, ky buletin përmban një Vlerësim Tremujor mbi zhvillimet kryesore të ekonomisë në Kosovë, me theks të veçantë në sistemin financiar.

Përveç kësaj, BPK-ja prezantoi dy publikime të reja. Së pari ja publikuar dy botime të **Buletinit të BPK-së**: 1) Struktura e Sektorit Bankar Tregtar dhe 2) Struktura e Sektorit Financiar; dhe së dyti, janë publikuar **Seritë e Materialeve të Diskutimit** – i pari në vitin 2005: “Normat e Interesit në Kosovë, Disa Krahasime dhe Përcaktuesit e Mundshëm”; dhe i dyti në fillim të vitit 2006: “Euroizimi jashtë euro Zonës: Asetet dhe Sfidat, Përvoja e Kosovës.”

Përsa iu përket Statistikave të **Bilancit të Pagesave** (BP) vlen të përmendet prezantimi i Sistemit të Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN), i cili është duke u zbatuar si një metodologji e hartimit të BP-së në linjë me standardet e FMN-së. Në këtë drejtim është bërë një punë e vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe krijimin e statistikave të përgjithshme mbi zhvillimet në sektorin e jashtëm. Në këtë projekt do të angazhohen burime shtesë dhe hartimi i suksesshëm i statistikave të Bilancit të Pagesave do të ngushtojë hendekun lidhur me zhvillimet në ekonominë e Kosovës në përgjithësi.

6. Zhvillimet e Brendshme

6.1. Drejtimi dhe Kontrolli i Brendshëm

Inspektori i Përgjithshëm i raporton Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit Drejtues përmes Komitetit të Auditimit. Ai është përgjegjës për funksionet si më poshtë:

Departamenti i Auditimit të Brendshëm – Ky departament kryen auditime të plota, si dhe të pjesshme, në linjë me programin e auditimit i miratuar nga Komiteti i Auditimit. Në të njëjtën kohë, kjo njësi është përgjegjëse për zbulimin e faktorëve të rrezikut.

Për arritjen e synimeve të saj, njësia e auditimit të brendshëm ka vendosur përparësitë dhe objektivat e saj gjatë vitit 2005, si p.sh.: përmirësimi i procedurave për një menaxhim më efikas, vlerësim të aseteve, vlerësim të faktorëve të rrezikut, vlerësim i funksionit të auditimit të brendshëm, ruajtja e reputacionit dhe imazhit të BPK-së, dhënia e rekomandimeve dhe këshillave me qëllim përmirësimin e funksionimit të BPK-së dhe çështjeve organizative, si dhe shpërndarjen efikase dhe përdorimin e burimeve.

Manaxhimi efikas i aseteve nënkupton përdorimin racional të aseteve të disponueshme. Gjatë vitit 2005, auditimi i brendshëm monitoroi dhe hetoi mënyrën e manaxhimit të aseteve. Ai ka dhënë vlerësime dhe rekomandime lidhur me struktura të ndryshme të BPK-së me përmirësimin e funksionimit të saj. BPK-ja nuk ka një departament të veçantë për administrimin e rrezikut, kështu që barra për vlerësimin dhe identifikimin e rreziqeve bie mbi auditimin e brendshëm. Auditimi i brendshëm i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të BPK-së. Aspektet praktike që monitorohen nga ky funksion mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Përbushja e objektivave dhe synimeve të veprimtarive të përcaktuara nga manaxhmenti;
- Përdorimi racional dhe efikas i burimeve;
- Detyrimi dhe integriteti lidhur me informacionet;
- Pajtueshmëria me politikat, planet, procedurat, ligjet dhe rregulloret përkatëse.

Kështu, auditimi i brendshëm bën verifikimin e procedurave (kontrolleve) përpara kryerjes së tyre. Gjithashtu, roli i auditimit të brendshëm është të vlerësojë se sa funksionale janë kontrollet e brendshme brenda BPK-së. Përsa iu përket rekomandimeve, gjatë vitit 2005, njësia e auditimit ka dhënë rekomandime për përmirësime në fushat që kishin nevojë. Departamenti i Auditimit të Brendshëm prodhon gjithashtu raporte tremujore dhe vjetore (Raporti i Ndjekjes së Rekomandimeve). Këto raporte dërgohen si informacione plotësuese tek Manaxhmenti i BPK-së me qëllim identifikimin e statusit zbatues të rekomandimeve të dhëna. Ky raport gjithashtu përfshin përgjigjen e manaxhmentit (p.sh. komentet e manaxherëve mbi funksionet e audituara) mbi çdo gjetje dhe përfundim, dhe ndjekjen e vazhdueshme të rekomandimeve të propozimeve të auditimit. Me qëllim zbatimin e kësaj veprimtarie në mënyrë të suksesshme, njësia e auditimit të brendshëm ka përgatitur një plan vjetor për vitin 2005, i cili ka qenë mbështetja kryesore në përcaktimin dhe organizimin e ngarkesës së punës së veprimtarive të auditimit. Frekuenca e punës audituese dhe vlerësimi i veprimtarive të BPK-së bëhen në përputhje me planin e auditimit i planifikuar më parë. Ky departament përgatit raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

Për planin e vitit 2006, janë marrë parasysh fushat e mëposhtme:

- Përvoja e fituar përmes punës së kryer nga auditimet e mëparshme;
- Njohuria e fituar gjatë trajnimeve dhe seminareve të ndryshme të organizuara gjatë këtyre viteve dhe në veçanti gjatë vitit 2005, me fokus të veçantë mbi Auditimin e Brendshëm në bankat qendrore.

Në përcaktimin e Planit të Auditimit të Brendshëm, metodologjia bazohet në rreziqet e pritshme duke përdorur metodën "Nga Lart Poshtë" në përcaktimin e rrezikut. Synimi është përqendrimi në fushat e auditimit ku rreziku i humbjes së aseteve financiare dhe reputacionit të BPK-së janë më të larta.

Plani vjetor i punës përfshin disa ndryshime thelbësore që përqendrohen kryesisht në rritjen e cilësive të rezervuara të auditeve, që nënkupton uljen e sasisë së auditimeve të kryera duke i lënë më shumë hapësirë auditimeve më cilësore gjatë vitit 2006. Këto ndryshime janë si më poshtë:

- Ndryshime në kohën e kryerjes së auditimeve të planifikuara;
- Shpeshësia e auditimeve të përfunduara;
- Auditimet e rekomanduara nga **Drejtori i Përgjithshëm, Komiteti i Auditimit dhe Inspektori i Përgjithshëm**;
- Plani i auditimit lë hapësira për kryerjen e kontrolleve *ex-ante* (auditime të hershme) ose kontrolle *ad-hoc* (kontrolle të paplanifikuara) në varësi të rrethanave.

Me qëllim kryerjen e punëve dhe objektivave të tij në mënyrë të suksesshme, funksioni i auditimit kërkon një staf të kualifikuar. Kështu, gjatë vitit 2005 stafi i këtij departamenti ka marrë pjesë në seminare të organizuara nga institucione të ndryshme (shiko tabelën 8 dhe 9 mbi trajnimet).

Departamenti i Buxhetit dhe Financave – Analiza Operacionale dhe Kontabiliteti i Shpenzimeve. Përsa i përket kontrollit të buxhetit dhe zbatimit të tij, është punuar mjaft për mundësimin e përdorimit më racional të burimeve ekzistuese duke qenë në linjë me buxhetin e miratuar. Synimi ynë është që buxheti i BPK-së të zbatohet me më tepër efikasitet.

Departamenti i Buxhetit dhe Financave përgatit një raport mujor në përputhje me tendencat e *cash*-it, një raport gjashtëmujor dhe një raport vjetor së bashku me analizat operacionale që tregojnë ecurinë kundrejt objektivit fillestar.

Gjithashtu, detyrat dhe përgjegjësitë përfshijnë monitorimin e procesit të prokurimit dhe pjesëmarrjen si anëtarë në mbledhjet e Komitetit të Prokurimeve, duke këshilluar dhe asistuar në të gjitha çështjet që lidhen me kontrollin e shpenzimeve. Përsa iu përket të ardhurave të BPK-së, duhet të ndiqet si më poshtë:

- Kontrolli dhe mbikëqyrja e të ardhurave, veçanërisht e të ardhurave të realizuara nga depozitat afatgjate në bankat e huaja, si dhe nga letrat me vlerë;
- Ndjekja dhe verifikimi i depozitave të klientëve në baza mujore, si dhe investimet e BPK-së në bankat e huaja, duke qenë se të ardhurat nga interesat në depozitat dhe letrat me vlerë përfaqësojnë 88% të të ardhurave të përgjithshme të BPK-së, ndërkohë që shpenzimet e interesit në shpenzimet e përgjithshme deri më 31 dhjetor 2005 u llogaritën në 58%.

Zbatimi i kontabilitetit të shpenzimeve nënkupton një përdorim më tepër analitik të burimeve, një kontroll më strikt i shpenzimeve, duke lehtësuar në këtë mënyrë procesin e vendimmarrjes të Manaxhmentit të BPK-së lidhur me shpërndarjen e buxhetit.

Prioritetet e njësisë së kontabilitetit të shpenzimeve në të ardhmen janë si më poshtë:

- Zbatimi praktik i sistemit të kontabilitetit të shpenzimeve në përputhje me dokumentacionin bazë dhe kronologjinë e dokumentacionit;
- Përcaktimi i strategjive për shpërndarjen e shpenzimeve jo të drejtpërdrejta të buxhetit të BPK-së;

Departamenti i Buxhetit dhe Financave – Analizat Operacionale dhe Kontabiliteti i Shpenzimeve në këtë periudhë ka punuar gjithashtu në krijimin dhe zhvillimin e Procedurave – rrjedhën e dokumentacionit brenda BPK-së nën drejtimin e Inspektorit të Përgjithshëm dhe në koordinim me Departamentin e Auditimit të Brendshëm, ku janë përfunduar prokurimi dhe procedurat e magazinimit.

Zbatimi i sistemit të kontabilitetit të shpenzimeve duhet të ndryshojë gjithashtu procedurat e brendshme të qarkullimit të dokumentacionit. Kjo do të ndikonte në një funksionim më efikas të kontrolleve të brendshme të BPK-së, ndërkohë që funksionimi më efikas i kontrolleve të brendshme do të ndihmonte që raporti manaxhues dhe tabelat financiare të mos kishin gabime të konsiderueshme.

6.2 Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Gjatë vitit 2005 BPK-ja ka vijuar zhvillimin e burimeve të saj njerëzore. Rol të rëndësishëm në këtë ka luajtur Departamenti i Burimeve Njerëzore, i cili është përgjegjës për planifikimin e burimeve njerëzore, rekrutimin dhe zgjedhjen e duhur të cilësisë së stafit; vlerësimin e nevojave të trajnimit dhe zhvillimin e stafit në bazë të nevojave të punës, organizimin e trajnimeve, vlerësimin e ecurisë së punonjësve, pagat dhe shpërblimet, si dhe ruajtjen e marrëdhënieve ndërmjet punonjësve.

Gjatë vitit 2005, është bërë rishikimi i përshkrimit të punës për çdo pozicion, si dhe janë përcaktuar kërkesat e punës. Në vitin 2005, janë bërë 14 shpallje për vende të lira pune në gazetën kryesore të Kosovës, si dhe në faqen e internetit të BPK-së. Për rrjedhojë, janë rekrutuar 15 punonjës të rinj, dy me kontrata me kohë të caktuar dhe trembëdhjetë me kontrata me kohë të pacaktuar. Një punonjës ka diplomë Master, 11 punonjës kanë diplomë universitare dhe 3 prej tyre diplomë të shkollës së mesme. Gjatë vitit 2005, janë larguar nga puna me dëshirë 9 punonjës.

Gjatë vitit 2005, numri i punonjësve arriti në 135, (4.7% më e lartë krahasuar me vitin 2004), ku sipas strukturës së gjinisë 47% janë femra dhe 53% meshkuj. Mosha mesatare e të gjithë stafit të BPK-së është 40; struktura sipas moshës jepet si më poshtë:

Mosha	Përqindja
18-25	6%
26-30	20%
31-35	19%
36-40	6%
41-45	8%
46-50	18%
51-55	10%
56-60	9%
60-65	4%

Klasifikimi sipas kriterit të arsimimit për vitin 2005 është si vijon:

Diplomë Master	–	5 punonjës,
Diplomë Universitare	–	68 punonjës,
Shkollë e Lartë	–	3 punonjës,
Shkollë e Mesme	–	56 punonjës.
Shkollë Filllore	–	3 punonjës
Gjithsej	–	135 punonjës

Gjithashtu, bazuar në nevojat e trajnimit dhe promovimit të studentëve të Universitetit (studentë në vitin e fundit), BPK-ja ka krijuar Programin e Praktikës për Studentë, i cili iu jep studentëve një mundësi unike për të fituar përvojë pune në BPK, si dhe në rritjen e njohurive të tyre teorike në praktikë.

Gjatë vitit 2005, BPK-ja ka zgjedhur grupin e parë prej 10 studentësh, të cilët kanë përfunduar me sukses 90 ditët e tyre të praktikës në departamentet e Administrimit, Auditimit të Brendshëm,

Kontabilitetit, Burimeve Njerëzore, Buxhetit, Zyrës Ligjore dhe në Departamentin për Kërkime dhe Statistika. BPK është në mënyrë të përhershme e angazhuar në shtimin e njohurive të punonjësve të saj, përmirësimin e aftësisë dhe ekspertizës së duhur në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi në përputhje me standardet më të mira me qëllim arritjen e kapaciteteve më të mëdha. BPK-ja ka zhvilluar politikën e trajnimit të personelit në përputhje me nevojat profesionale të saj përmes: trajnimeve, kurseve, seminareve, kualifikimit akademik dhe post-akademik (duke përfshirë mbështetjen financiare).

Trajnimet e ndjekura gjatë vitit 2005, në vend dhe jashtë vendit, paraqiten në tabelën si më poshtë:

Tabela 8. Trajnimet në Kosovë gjatë vitit 2005

Institucioni	Programi/Tema	Kohëzgjatja	Nr. i Pjesëmarrësve
BPK –Universiteti Amerikan i Kosovës (AUK)	Kursi mbi Aftësimin e Shkrimit në Biznes	12 ditë	26
Cactus	MCSE 2003	9 ditë	1
Shoqata e Sigurimeve të Kosovës	Sigurimet	18 ditë	2
	Trajnim MITC	9 ditë	2
KBA (Shoqata Bankare e Kosovës)	Manaxhimi i Burimeve Njerëzore	5 ditë	2
	Standardet e Raportimit Financiar Ndërkombëtar Standards	5 ditë	2
	Seminar b@nksim	5 ditë	2
	Përkujdesi i Klientit dhe Manaxhimi i Shitjeve	5 ditë	4
	Politika e Kreditimit dhe Kontrolli i Procesit të Kreditimit	5 ditë	2
	CreditStrat	5 ditë	2
	Pagesat Ndërkombëtare	5 ditë	1
	Auditimi i Brendshëm në Banka	5 ditë	2
	Manaxhimi Bazë	5 ditë	2
	Marketing	5 ditë	1
Kredidhënia për biznesin e vogël dhe personat privatë	5 ditë	2	
Njësia e Prokurimit	Prokurimi Publik në Kosovë	1 ditë	1
Kryqi i Kuq, Prishtinë	Ndihma e Parë	2 ditë	34
Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SCAAK)	Kontabiliteti dhe Auditimi	56 ditë	4
	Kontabiliteti dhe Auditimi	44 ditë	1
USAID World Learning – Prishtinë	Lidershipi dhe Aftësitë Manaxheriale	4 ditë	5
Banka Botërore, Prishtinë	Kontabiliteti	1 ditë	1

Tabela 9. Trajnimi jashtë vendit gjatë vitit 2005

Institucioni	Programi/Tema	Kohëzgjatja	Nr. i Pjesëmarrësve
Banka e Shqipërisë	Seminar mbi "Stress Testing" në Tiranë	2 ditë	2
Banque de France	Auditimi i Brendshëm në një Bankë Qendrore	4 ditë	1
	Aspektet Ligjore të Bankingut Qendror	5 ditë	1
TAIEX- Komisioni Evropian/Bruksel	Seminar mbi Bashkimin Evropian Monetar në Bruksel	2 ditë	2
	TAIEX Seminar mbi Shërbimet Financiare	1 ditë	3
	Tur Studimor në Bruksel mbi Manaxhimin e Burimeve Njerëzore	5 ditë	1
Centre of Excellence në Financa – Ljubljana	Seminar mbi Auditimin e Brendshëm në Bankat Qendrore	2 ditë	2
	Statistikat e Llogarive Financiare	5 ditë	1
Këshilli i Evropës/Lufta kundër Pastrimit të Parave - Kroaci	Shkëmbimi i Informacionit ndërmjet FIU Kroaci	2 ditë	1
Banka Kombëtare Çeke	Roli dhe Praktika e Auditimit të Brendshëm në një Bankë Qendrore	3 ditë	1
	Siguria dhe Manaxhimi i Krizave në Bankën Qendrore	3 ditë	1
	Sistemi i Shlyerjes së Pagesave dhe i Letrave me Vlerë	2 ditë	1
Deutsche Bundesbank	X-12 ARIMA Axhustimi sezonal i të dhënave ekonomike	5 ditë	1
	Mbikëqyrja Bankare në vend	5 ditë	1
	Auditimi i Brendshëm	5 ditë	1
Bankingu Qendror - Angli	Seminar mbi Manaxhimin e Teknologjisë Informative për Bankierët Qendrorë dhe Mbikëqyrësit	5 ditë	1
Instituti i Stabilitetit Financiar Bazel-Zvicër	<i>Problem Bank Resolution</i>	3 ditë	1
FMN Instituti i Vjenës	Lufta kundër pastrimit të parave/lufta kundër financimit të terrorizmit për mbikëqyrësit	4 ditë	1
	Stabiliteti dhe zhvillimi financiar	2 ditë	1
	Statistikat monetare dhe financiare të mbledhura dhe të hartuara nga SEBQ	5 ditë	1
	Statistikat monetare dhe financiare	15 ditë	1
	Manaxhimi operacional dhe i rrezikut të portofolit	5 ditë	2
	Konverjenca reale dhe çështjet e politikës monetare për vendet drejt anëtarësimit në BE	4 ditë	2
FMN Uashington DC	Programimi dhe politikat financiare	32 ditë	1
Banka Kombëtare e Austrisë	Qarkullimi i cash-it dhe sistemet e pagesave në Austri	5 ditë	2
	Pastrimi i parave	3 ditë	1
Universiteti Oracle në Ljubljana	Trajnim Oracle	20 ditë	1
Qendra Studimore Gerzensee- Zvicër	Çështjet monetare dhe financiare në vendet në zhvillim	15 ditë	1
Universiteti Starffordshire - MB	Program Ph.D	56 ditë	1
Banka Kombëtare e Zvicrës	Instrumentet e tregjeve financiare	14 ditë	1
Vizor Irlandë	Parimet e mbikëqyrjes së sigurimeve	10 ditë	2
	Parimet e mbikëqyrjes së sigurimeve	9 ditë	3
TIBS Varshavë - Poloni	CEEC Mbikëqyrja rajonale e sigurimeve	5 ditë	1
	Bankat e dobëta dhe insolvente në vendet me ekonomi në zhvillim	5 ditë	1

7. Pasqyrat Financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVËS (BPK)

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2005

**PËRGATITUR NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE
TË RAPORTIMIT FINANCIAR**

RAPORTI I PAVARUAR I AUDITORËVE PËR BORDIN DREJTUES TË AUTORITETIT BANKAR DHE TË PAGESAVE TË KOSOVËS

Ne kemi audituar bilancin e bashkëngjitur të gjendjes të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (“BPK”) deri më 31 dhjetor 2005 dhe pasqyrat përkatëse të të ardhurave, ndryshimet në kapital dhe rezervat, si dhe fluksin e parasë për vitin e përfunduar. Këto pasqyra financiare të paraqitura në faqet 1 deri në 25 janë përgjegjësi e manaxhmentit të BPK-së. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin e kryer prej nesh.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të siguruar që këto pasqyra financiare nuk përmbajnë informacione të gabuara. Një auditim përfshin inspektimin në baza testimi, evidenca që mbështesin shumat dhe informacionin e dhënë në pasqyrat financiare. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve të përdorura dhe llogaritjet e kryera nga manaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së pasqyrave të përgjithshme financiare. Ne besojmë se auditimi ynë jep baza të arsyeshme për opinionin tonë.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat e bashkëngjitura financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet financiare, gjendjen financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës deri më 31 dhjetor 2005 dhe rezultatet e operacioneve dhe fluksit të parasë së tij për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Pa e kualifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se në këto kohë ekziston një pasiguri në Kosovë në drejtim të drejtimit të mundshëm në të ardhmen e politikës ekonomike, politikës rregullative dhe zhvillimeve politike në vend. Ne nuk mund të parashikojmë çfarë ndryshimesh do të ndodhin dhe çfarë ndikimesh mund të kenë ato në gjendjen financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës.

PricewaterhouseCoopers dooel

Shkup,

22 maj 2006

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)
Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005

Tabela e përmbajtjes	Faqe
Raporti i pavarur i auditorëve	-
Informacione të përgjithshme	1
Bilanci i gjendjes	3
Pasqyra e të ardhurave	4
Pasqyra e fluksit të parasë	5
Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe rezerva	6
Shënime mbi pasqyrat financiare	7
1 Bazat e përgatitjes dhe formati i prezantimit.....	7
2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit.....	12
3 Manaxhimi i rrezikut financiar.....	17
4 Llogaritë korrente në bankat jorezidente.....	20
5 Bonot e thesarit.....	20
6 Llogaritë e depozitave në bankat jorezidente.....	20
7 Prona dhe pajisjet.....	21
8 Asete të tjera.....	22
9 Detyrimet ndaj bankave vendore.....	22
10 Detyrimet ndaj institucioneve vendore qeveritare.....	23
11 Detyrimet ndaj entiteteve publike dhe tregtare.....	23
12 Detyrimet e tjera të brendshme.....	23
13 Fondi statutor.....	24
14 Fondi i rezervave.....	24
15 Të ardhura të tjera operative.....	25
16 Shpenzimet për personelin.....	25
17 Shpenzime të përgjithshme dhe administrative.....	25
18 Transaksionet me palët e lidhura.....	26
19 Angazhimet dhe mundësitë.....	27
20 Ngjarjet pas datës së bilancit.....	27

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005

Informacione të përgjithshme

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (“BPK”) është një entitet publik i veçantë me autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në territorin e Kosovës. BPK-ja është themeluar në përputhje me dispozitat e Rregullores Nr. 1999/20 datë 15 nëntor, 1999 (amenduar më 1 tetor, 2001 me Rregulloren 2001/24) të Misionit të Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) “Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave në Kosovë”. Sipas kësaj rregulloreje, objektivat kryesorë të BPK-së janë për të:

- Siguruar një sistem efikas dhe të sigurtë për pagesat në vend, dhe
- Siguruar likuiditetin, aftësinë paguese dhe funksionimin efikas të një tregu të qëndrueshëm të sistemit financiar, duke përfshirë rregullimin e bankave, kompanive të sigurimeve dhe institucioneve të tjera financiare.

BPK-ja ka autoritetet specifike të mëposhtme:

- Rekomandimin e udhëzimeve gjithëpërfshirëse të politikave të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në fushat nën përgjegjësinë e tij, nën drejtimin e Zëvendës Përfaqësuesit Special për Rindërtim dhe Zhvillim Ekonomik;
- Hartimin dhe zbatimin e masave, si dhe mbikëqyrjen dhe rregullimin e pagesave dhe sistemeve të shlyerjes për transaksionet në monedhën e vendit dhe në valutë të huaj në Kosovë;
- Zotërimin dhe operimin e një ose më shumë sistemeve të pagesave;
- Veprimin si bankier për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe dhënien e këshillimeve financiare sipas kërkesës së saj;
- Veprimin si agjent fiskal për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave;
- Mbajtjen e depozitave në valutë të bankave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si dhe të entiteteve të tjera;
- Sigurimin e furnizimit të mjaftueshëm të kartëmonedhave dhe monedhave për kryerjen e transaksioneve të *cash-it*;
- Mirëmbajtjen e një thesari për ruajtjen e sigurtë të valutës dhe letrave me vlerë;
- Licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare;
- Kryerjen e analizave të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, publikimin e rezultateve, dhe paraqitjen e propozimeve dhe masave përpara Misionit të Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë në bazë të këtyre analizave.

BPK-ja operon nga zyra e saj qendrore në Prishtinë. Më 31 dhjetor 2005, BPK-ja kishte 138 punonjës (31 dhjetor 2004: 134 punonjës).

Zyra e regjistruar e BPK-së është Rruga Garibaldi, Nr. 33, Prishtinë, Kosovë.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005

Bordi Drejtues

Bordi drejtues përcakton politikat për operacionet e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Sipas rregulloreve të UNMIK-ut, Bordi Drejtues përbëhet nga shtatë anëtarë emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Më 31 dhjetor 2005, Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Z. Ajri Begu, Kryetar i Bordit Drejtues

Z. Michel Svetchine, Drejtor i Përgjithshëm i BPK-së

Z. Edward Nolan, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Mbikëqyrjen e Sektorit Financiar

Z. Benoit Waelkens, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Sistemin e Pagesave

Z. Joachim Rücker, Zëvendës Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Zj. Chiara Bronchi, Zyrtare për Çështje Fiskale

Z. Gazmend Luboteni

Më 1 janar 2006, Z. Benoit Waelkens u zëvendësua nga z. Gani Gërguri (Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Sistemin e Pagesave) si anëtar i Bordit Drejtues.

Më 1 shkurt 2006, Z. Edward Nolan u zëvendësua nga z. Hashim Rexhepi (Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Mbikëqyrjen e Sektorit Financiar) si anëtar i Bordit Drejtues.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)**Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005**

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

Bilanci i gjendjes

	Shënime	Më 31 dhjetor	
		2005	2004
Asetet			
Paraja e gatshme		24,464	12,064
Llogaritë rrjedhëse me bankat jorezidente	4	23,765	8,929
Bonot e thesarit	5	159,269	124,418
Llogaritë e depozitave me bankat jorezidente	6	190,633	204,480
Prona dhe pajisjet	7	494	665
Asetet e tjera	8	790	111
Totali i aseteve		399,415	360,667
Detyrimet			
Depozitat nga bankat vendore	9	82,518	72,899
Detyrimet ndaj institucioneve vendore qeveritare	10	229,891	225,209
Detyrimet ndaj entiteteve publike dhe tregtare	11	64,126	32,826
Detyrimet e tjera të brendshme	12	3,158	2,220
Totali i Detyrimeve		379,693	333,154
Kapitali dhe Rezervat			
Fondi Statutor	13	10,000	10,000
Fitimet e Mbajtura		500	-
Fondi i rezervave	14	9,222	7,513
Totali i kapitalit dhe rezervave		19,722	17,513
Totali i detyrimeve, kapitalit dhe rezervave		399,415	350,667

Pasqyrat financiare u miratuan nga Bordi Drejtues i BPK-së më 22 maj 2006 dhe u nënshkruan nga:

Michel Svetchine
Drejtor i Përgjithshëm

Gani Gërguri
Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm

Shënimet e paraqitura në faqet 7 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)**Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005**

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

Pasqyra e të ardhurave

	Shënime	Më 31 dhjetor	
		2005	2004
Të ardhurat nga interesi dhe të ngjashme		7,474	8,307
Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme		<u>(3,431)</u>	<u>(4,049)</u>
Të ardhurat neto nga interesi		4,043	4,258
Të ardhurat nga tarifa dhe komisioni		613	570
Shpenzimet nga tarifa dhe komisioni		<u>(12)</u>	<u>(107)</u>
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisioni		601	463
Të ardhurat nga grantet	12	218	250
Humbjet nga ndryshimet në vlerën e bonove të thesarit		(105)	(113)
Të ardhura të tjera operative	15	<u>651</u>	<u>380</u>
Të ardhura operative neto		<u>5,408</u>	<u>5,238</u>
Shpenzime operative			
Shpenzime për personelin	16	(1,085)	(1,015)
Zhvlerësimi	7	(366)	(371)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	17	<u>(1,366)</u>	<u>(807)</u>
Totali i shpenzimeve operative		<u>(2,817)</u>	<u>(2,193)</u>
Fitimi neto i vitit		<u>2,591</u>	<u>3,045</u>

Pasqyrat financiare u miratuan nga Bordi Drejtues i BPK-së më 22 maj 2006 dhe u nënshkruan nga:

Michel Svetchine
Drejtor i Përgjithshëm

Gani Gërguri
Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm

Shënimet e paraqitura në faqet 7 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)**Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005**

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

Pasqyra e fluksit të parasë

Shënime	Më 31 dhjetor	
	2005	2004
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative		
Interesi i pranuar	7,426	8,585
Interesi i paguar	(3,431)	(4,071)
Tarifa dhe komisioni i pranuar	613	570
Tarifa dhe komisioni i paguar	(12)	(107)
Pranimet e tjera	651	380
Pagesat në <i>cash</i> të punonjësve dhe furnizuesve	<u>(2,524)</u>	<u>(1,922)</u>
Flukset e parasë nga fitimet operative përpara ndryshimeve në asetet dhe detyrimet operative	2,723	3,435
Ndryshimi në asetet dhe detyrimet operative		
Ulja në llogaritë e depozitave të bankave jorezidente	13,847	199,733
Rritja në asetet e tjera	(679)	(15)
Rritja në depozitat nga bankat vendore	9,617	13,287
Rritja/(ulja) në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare vendore	4,682	(126,244)
Rritja në detyrimet ndaj entiteteve publike dhe tregtare	31,300	4,887
Rritja në detyrimet e tjera të brendshme	<u>938</u>	<u>95</u>
Paraja <i>cash</i> nga aktivitetet operative	<u>62,430</u>	<u>95,178</u>
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe pajisjeve	<u>(343)</u>	<u>(141)</u>
Paraja <i>cash</i> neto e përdorur në aktivitetet investuese	(343)	(141)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese		
Fondet grant të pranuar	<u>-</u>	<u>-</u>
Paraja <i>cash</i> neto nga aktivitetet financuese	<u>-</u>	<u>-</u>
Rritja neto në parane <i>cash</i> dhe ekuivalentët e <i>cash-it</i>	62,087	95,037
Paraja <i>cash</i> dhe ekuivalentët e <i>cash-it</i> më 1 janar	<u>145,411</u>	<u>50,374</u>
Paraja <i>cash</i> dhe ekuivalentët e <i>cash-it</i> më 31 dhjetor	<u>207,498</u>	<u>145,411</u>

Shënimet e paraqitura në faqet 7 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)**Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005**

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe rezerva

	Fondi statutor	Fondi i rezervave	Fitimet e mbajtura	Total
Bilanci më 1 janar 2004	2,556	11,912	-	14,468
Transferta në kapital (shënim 14)	7,444	(7,444)	-	-
Fitimi neto i vitit	-	-	3,045	-
Transferta në fondin e rezervave (Shënim 14)	-	3,045	(3,045)	-
Bilanci më 31 dhjetor 2004/ 1 janar 2005	10,000	7,531	-	17,513
Pagesat për Ministrinë e Financave (Shënim 14)	-	(382)	-	(382)
Fitimi neto i vitit	-	-	(2,591)	2,591
Transferta në fondin rezervë (Shënim 14)	-	2,091	(2,091)	-
Bilanci më 31 dhjetor 2005	<u>10,000</u>	<u>9,222</u>	<u>500</u>	<u>19,722</u>

Shënimet e paraqitura në faqet 7 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

1. Bazat e përgatitjes dhe formati i prezantimit

Këto pasqyra financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (“BPK”) janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”). Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur sipas marrëveshjes historike të kostos, të modifikuara nga rivlerësimi i bonove të thesarit.

1.1 Valuta e prezantimit

Deri më 31 dhjetor 2001, pasqyrat financiare të BPK-së paraqiteshin në monedhën e përdorur në territorin e Kosovës, marka gjermane (“DEM”), e cila ishte monedha funksionale dhe raportuese në territorin e Kosovës. Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/4, euro (“EUR”) u adoptua si një nga monedhat zyrtare në Kosovë nga 1 janari, 2002. Për rrjedhojë, duke filluar nga kjo datë vlerat e denominuara në DEM u konvertuan në EUR duke përdorur normën fikse të pakthyeshme të këmbimit prej EUR 1 = DEM 1.95583. Aktualisht, euro është monedha ekzistuese në Kosovë. Duke filluar nga 1 janari, 2002, regjistrat dhe të dhënat e BPK-së janë mbajtur në monedhën euro, e cila është monedha funksionale e BPK-së. Këto pasqyra financiare janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe.

1.2 Bazat e kontabilitetit

BPK-ja i mban regjistrat e saj të kontabilitetit në përputhje me praktikat e pranura gjerësisht të kontabilitetit në territorin e Kosovës administruar nga Kombet e Bashkuara dhe ajo përgatit pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

1.3 Përdorimi i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në vlerat e raportuara të aseteve dhe detyrimeve, zbulimit të aseteve dhe detyrimeve të mundshme në datën e pasqyrave financiare dhe në vlerat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportuar. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato vlerësime.

1.4 Riklasifikimi i vlerave krahasuese

Aty ku është e nevojshme, shifrat krahasuese janë axhustuar për të qenë në përputhje me ndryshimet në paraqitjen e vitit aktual.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

1. Bazat e përgatitjes dhe formati i prezantimit (vazhdim)

1.5 SNRF-ja e re dhe e amenduar

Interpretimet dhe amendimet e standardeve të publikuara që hyjnë në fuqi në vitin 2005

Në vitin 2005, BPK-ja adoptoi SNRF-të e mëposhtme, të cilat nevojiten në operacionet e saj:

- SNK 1 (rishikuar në 2003) Prezantim i Pasqyrave Financiare
- SNK 2 (rishikuar në 2003) Inventarët
- SNK 8 (rishikuar në 2003) Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet dhe Gabimet e Kontabilitetit
- SNK 10 (rishikuar në 2003) Ngjarjet pas Datës së Bilancit të Gjendjes
- SNK 16 (rishikuar në 2003) Prona, Godina dhe Pajisjet
- SNK 17 (rishikuar në 2003) Qiradhëniet
- SNK 21 (rishikuar në 2003) Efektet e Ndryshimeve në Kursin e Këmbimit të Huaj
- SNK 24 (rishikuar në 2003) Zbulimet e Palëve të Lidhura
- SNK 27 (rishikuar në 2003) Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta
- SNK 28 (rishikuar në 2003) Investimet në Shoqëritë Simotra (ky standard nuk është relevant për BPK-në)
- SNK 32 (rishikuar në 2003) Instrumentet Financiare: Informacioni dhe Paraqitja
- SNK 33 (rishikuar në 2003) Fitimet për Pjesëmarrje (ky standard nuk është relevant për BPK-në)
- SNK 39 (rishikuar në 2003) Instrumentet Financiare: Vlerësimi dhe Matja
- SNRF 2 (rishikuar në 2004) Pagesat e Bazuara në Pjesëmarrje (ky standard nuk është relevant për BPK-në)
- SNRF 3 (rishikuar në 2004) Kombinimet e Biznesit (ky standard nuk është relevant për BPK-në)
- SNK 36 (rishikuar në 2004) Dëmtimi i Aseteve
- SNK 38 (rishikuar në 2004) Asetet e Paqëndrueshme
- KIRNF 2, Aksionet e Anëtarëve në Entitetet Kooperative dhe Instrumentet e Ngjashme (në fuqi nga 1 janari 2005) (ky standard nuk është relevant për BPK-në)

- SIC 12 (Amendim), Konsolidimi – Entitetet me Qëllim të Veçantë (në fuqi nga 1 janari 2005 (ky standard nuk është relevant për BPK-në) dhe
- SNK 39 (Amendim), Tranzicioni dhe Vlerësimi Fillestar i Aseteve Financiare dhe Detyrimeve Financiare (në fuqi nga 1 janari 2005).

1. Bazat e përgatitjes dhe formati i prezantimit (vazhdim)

1.5 SNRF-ja e re dhe e amenduar (vazhdim)

Standardet, interpretimet dhe amendimet e standardeve të publikuara të cilat nuk janë ende në fuqi

Disa standarde, amendime dhe interpretime të reja të standardeve ekzistuese janë publikuar dhe ato janë të detyrueshme për periudhat e kontabilitetit të BPK-së që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2006 ose në periudha më të vonshme, por që BPK-ja nuk i ka adoptuar më herët: Ato janë:

- *SNK 19 (Amendim), Përfitimet e Punonjësve (në fuqi nga 1 janari 2006)*. Ky amendim paraqet opsionin e një paraqitjeje alternative për fitimet dhe humbjet aktuariale. Ai mund të paraqesë kërkesa shtesë për planet multi-punëdhënëse ku ka informacione të pamjaftueshme për aplikimin e kontabilitetit të përcaktuar të përfitimit. Gjithashtu ai ka kërkesa të reja që kanë të bëjnë me zbulimin e informacionit. Duke qenë se BPK-ja nuk do të ndryshojë politikën e kontabilitetit adoptuar për paraqitjen e fitimeve dhe humbjeve aktuariale, dhe nuk merr pjesë në ndonjë plan multi-punëdhënës, adoptimi i këtij amendimi do të ndikojë vetëm mbi formatin dhe shkallën e zbulimit të informacionit të paraqitura në llogari. Manaxhmenti e shqyrtoi këtë amendim të SNK 19 dhe doli në përfundimin se nuk është relevant për BPK-në.

- *SNK 39 (Amendim), Kontabiliteti i Kufizimit të Fluksit të Parasë Cash i Transaksioneve të Parashikuara të Intragrupit (në fuqi nga 1 janari 2006)*. Ky amendim lejon rrezikun e valutës së huaj të një transaksioni të mundshëm të parashikuar të intragrupit të kualifikohet si një zë i kufizuar në pasqyrat e konsoliduara financiare, me kusht që: (a) transaksioni të denominohet në një valutë tjetër nga ajo e valutës funksionale të entitetit të përfshirë në transaksion; dhe (b) rreziku i valutës së huaj do të ndikojë fitimin ose humbjen e konsoliduar. Ky amendim nuk është relevant për operacionet e BPK-së, për shkak se BPK-ja nuk ka transaksione intragrupi, të cilat mund të kualifikoheshin si një zë i kufizuar në pasqyrat e konsoliduara financiare të 31 dhjetorit 2005 dhe 2004.

- *SNK 39 (Amendim), Opsioni i Vlerës Reale (në fuqi nga 1 janari 2006)*. Ky amendim ndryshon përcaktimin e instrumenteve financiare të klasifikuara në vlerë reale përmes fitimit ose humbjes dhe kufizon mundësinë e përcaktimit të instrumenteve financiare si pjesë e kësaj kategorie.

Një entitet mund të përdorë këtë përcaktim vetëm kur një gjë e tillë rezulton në një informacion më tepër relevant sepse ose:

(i) eliminon ose zvogëlon në një masë të konsiderueshme mospërputhshmërinë e matjes ose vlerësimit (referuar ndonjëherë si “një mospërputhje kontabiliteti”) që të do lindte nga matja e asetëve ose detyrimeve ose vlerësimi i fitimeve dhe humbjeve në baza të ndryshme; ose

(ii) një grup asetesh financiare, detyrimesh financiare ose të dyja manaxhohet dhe ecuria e tij vlerësohet në baza të vlerës reale, në përputhje me një manaxhim rreziku të dokumentuar ose strategjie investimi, dhe informacioni mbi grupin jepet në mënyrë të brendshme personelit (siç përcaktohet në SNK 24 Zbulimet e Palëve të Lidhura (rishikuar në 2003)), për shembull bordit të drejtorëve të entitetit dhe zyrtarit kryesor ekzekutiv.

ose shton derivate të tjerë të rëndësishëm.

BPK-ja beson se ky amendim nuk duhet të ketë ndikim të madh mbi klasifikimin e instrumenteve financiare, duke qenë se BPK-ja duhet të pajtohet me kriteret e amenduara për përcaktimin e instrumenteve financiare në vlerë reale përmes fitimit dhe humbjes, sepse asetet financiare të BPK-së të përcaktuara në vlerë reale përmes fitimit ose humbjes do të manaxhohen dhe ecuria e tyre do të vlerësohet në baza të vlerës reale.

- *SNK 39 dhe SNRF 4 (Amendim), Kontratat e Garancisë Financiare (në fuqi nga 1 janari 2006)*. Ky amendim kërkon që garancitë e emtuara financiare, përveç atyre të shpallura nga entiteti si kontrata sigurimi, të vlerësohen fillimisht në vlerën e tyre reale, dhe më pas të maten në: (a) bilancin e paamortizuar të tarifave përkatëse të pranuar ose të shtyra, dhe (b) shpenzimet e kërkuara për shlyerjen e angazhimit në datën e bilancit. Manaxhmenti e shqyrtoi këtë amendim të SNK 3 dhe doli në përfundimin se nuk është relevant për BPK-në.

- *SNRF 1 (Amendim), Adoptimi i Herës së Parë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe SNRF 6 (Amendim), Eksplorimi dhe Vlerësimi i Burimeve Minerale (në fuqi nga 1 janari 2006)*. Këto amendime nuk janë relevante për operacionet e BPK-së, duke qenë se BPK-ja nuk është një adoptuese e herës së parë dhe nuk kryen eksplorime dhe vlerësime të burimeve minerale.

- *SNRF 6, Eksplorimi dhe Vlerësimi i Burimeve Minerale (në fuqi nga 1 janari 2006)*. SNRF 6 nuk është relevant për operacionet e BPK-së.

- *SNRF 7, Instrumentet Financiare: Zbulimet, dhe një Amendament shtesë i SNK 1, Paraqitja e Pasqyrave Financiare – Zbulimet e Kapitalit (në fuqi nga 1 janari 2007)*. SNRF 7 paraqet zbulime të reja me qëllim përmirësimin e informacionit mbi instrumentet financiare. Ai kërkon zbulimin e informacioneve cilësore dhe sasiore mbi ekspozimin e rreziqeve nga instrumentet financiare, duke përfshirë zbulimet minimale të specifikuar mbi rrezikun kreditor, rrezikun e likuiditetit dhe të tregut, duke përfshirë analizat sensitive për rrezikun e tregut. Ai zëvendëson SNK 30, Zbulimet në Pasqyrat Financiare të Bankave dhe Institucioneve të Ngjashme Financiare, dhe kërkesat e zbulimit në SNK 32, Instrumentet Financiare: Zbulimi dhe Paraqitja. Është i aplikueshëm për të gjitha entitetet të cilat raportojnë nën SNRF. Amendimi i SNK 1 paraqet zbulime mbi nivelin e kapitalit të një entiteti dhe se si e manaxhon ai kapitalin. BPK-ja e vlerësoi ndikimin e SNRF 7 dhe amendimin e SNK 1 dhe doli në përfundimin se zbulimet kryesore shtesë do të jenë analizat sensitive të rrezikut të tregut dhe zbulimet e informacionit mbi kapitalin të kërkuara nga amendimi i SNK 1. BPK-ja do të aplikojë SNRF 7 dhe amendimin e SNK 1 nga periudhat vjetore duke filluar më 1 janar 2007.

- *KIRNF 4, Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qeramarrje (në fuqi nga 1 janari 2006).* KIRNF 4 kërkon përcaktimin nëse një marrëveshje është ose përmban një qeramarrje

bazuar në substancën e marrëveshjes. Ai kërkon një vlerësim nëse: (a) përmbushja e marrëveshjes varet në përdorimin e një asemi specific ose asemi (aseti); dhe (b) marrëveshja jep të drejtën e përdorimit të asemi. KIRNF 4 nuk është relevant për operacionet e BPK-së.

- *KIRNF 5, Të drejtat e Interesit nga Mospërdorimi, Rivendosja dhe Rehabilitimi Mjedisor i Fondeve (në fuqi nga 1 janari 2006).* KIRNF 5 nuk është relevant për operacionet e BPK-së.

- *KIRNF 6, Detyrimet nga Pjesëmarrja në një Treg Specific – Pajisjet e Mbetjeve Elektrike dhe Elektronike (në fuqi nga 1 dhjetori 2005).* KIRNF 6 nuk është relevant për operacionet e BPK-së.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit

2.1 Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave për të gjitha instrumentet interes-bartëse në baza akruale, duke përdorur metodën e yield-it efektiv bazuar në çmimin aktual të blerjes. Të ardhurat nga interesi përfshin skontimin e përlllogaritur dhe premiumin mbi bonot e thesarit dhe instrumentet e tjera të skontuara.

Kur një aset financiar ose grup asetesh financiare është regjistruar si rrjedhojë e një humbjeje, të ardhurat nga interesi paraqiten duke përdorur normën e interesit e përdorur për skontimin e flukseve të ardhshme të parave *cash* me qëllim matjen e humbjes.

2.2 Të ardhurat nga tarifa dhe komisioni

Të ardhurat nga tarifa dhe komisioni konsiston në tarifatat e transaksionit për llogaritë operative dhe transfertat e fondeve.

Tarifatat dhe komisionet përgjithësisht paraqiten në baza akruale atëherë kur sigurohet shërbimi.

2.3 Konvertimi i valutës së huaj

Transaksionet e valutës së huaj konvertohen në valutën e matjes duke përdorur normat e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor që vijnë si rezultat i kryerjes së transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi në normat e këmbimit në fund të vitit të aseteve dhe detyrimeve monetare të denominuara në valuta të huaja paraqiten në pasqyrën e të ardhurave.

2.4 Paraja *cash* dhe ekuivalentët e saj

Për shkak të pasqyrës së fluksit të parasë *cash*, paraja *cash* dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë *cash*, llogaritë rrjedhëse në bankat jorezidente dhe bonot e thesarit.

2.5 Asetet financiare

Banka i klasifikon asetet e saj financiare në kategoritë e mëposhtme: asetet financiare në vlerën reale përmes fitimit ose humbjes dhe kreditë dhe arkëtimet e pritshme. Manaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të saj në vlerësimin fillestar.

(a) Asetet financiare në vlerën reale përmes fitimit ose humbjes

Kjo kategori përfshin asetet financiare të përcaktuara në fillim në vlerë reale përmes fitimit ose humbjes.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

2.5 Asetet financiare (vazhdim)

Banka i klasifikon bonot e saj të thesarit si asete financiare të përcaktuara në fillim në vlerë reale përmes fitimit ose humbjes. Përpara 1 janarit 2005, bonot e thesarit klasifikoheshin si investime të disponueshme për shitje. Investimet e disponueshme për shitje ishin investimet që mbaheshin për një periudhë të pacaktuar kohore, të cilat mund të shiten në përgjigje të nevojave për likuiditet ose ndryshimeve në normat e interesit, kurset e këmbimit ose çmimet e kapitalit. Të ardhurat e interesit nga asetet financiare të përcaktuara në vlerë reale përmes fitimit ose humbjes dhe investimet e disponueshme për shitje regjistrohen në pasqyrën financiare si “të ardhura nga interesi dhe të ngjashme”. Fitimet dhe humbjet nga asetet financiare të përcaktuara në vlerë reale përmes fitimit ose humbjes dhe investimet e disponueshme për shitje regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave si “Fitimi ose humbja nga ndryshimet në vlerën e rregullt të bonove të thesarit”. Ndryshimet në vlerën e rregullt shprehen gjithashtu në pasqyrën e të ardhurave.

(b) Kreditë dhe arkëtimet e pritshme

Kreditë dhe arkëtimet e pritshme janë asete financiare të pavarura me pagesa fikse ose të përcaktuashme, duke përfshirë arkëtimet e tjera të pritshme dhe depozitat në bankat e tjera, të cilat nuk kuotohen në një treg aktiv.

Kreditë dhe arkëtimet e pritshme barten në kosto të amortizuar, e cila përcaktohet si vlera e rregullt e parave *cash* të dhëna për iniciimin e këtyre kredive të përcaktuara sipas çmimeve të tregut në datën e fillimit. Kostoja e amortizuar zbritet me provigjonet për humbjet. Të gjitha kreditë dhe arkëtimet e pritshme shprehen kur paraja *cash* iu jepet huamarrësve.

2.6 Humbja e asetëve financiare

BPK-ja vlerëson në çdo datë bilanci nëse ka evidencë të vlefshme që një asset financiar ose grup asetesh financiare humbet. Një asset financiar ose grup asetesh financiare humbasin dhe humbjet ndodhin nëse ka evidencë të vlefshme të humbjes si rrjedhojë e një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas pasqyrimin fillestar të asetit dhe që ngjarjet kanë ndikuar në flukset e vlerësuar të *cash*-it në të ardhmen e asetit financiar ose grupit të asetëve financiare që mund të llogariten në mënyrë të besueshme. Evidenca e vlefshme që një asset financiar ose grup asetesh financiare ka pësuar humbje përfshin të dhënat rreth ngjarjeve të mundshme të humbjes:

- (i) vështirësi e madhe financiare e debitorit;
- (ii) prishje kontrate, si p.sh. mospagim i interesit ose principalit;
- (iii) shkaqe ekonomike ose ligjore që lidhen me vështirësinë financiare të huamarrësit;

(iv) është e mundshme që huamarrësi të jetë drejt falimentimit;

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(v) zhdukja e një tregu aktiv për atë aset financiar për shkak të vështirësive financiare; ose

(vi) ekzistojnë të dhëna që tregojnë se ka një rënie të flukseve të vlerësuara të *cash*-it në të ardhmen nga një grup asetesh financiare që prej vlerësimit fillestar të atyre asetëve, edhe

pse rënia nuk mund të identifikohet ende në asetet financiare individuale në grup, duke përfshirë:

- ndryshime të pafavorshme në statusin e pagesës së huamarrësve në grup; ose
- kushteve lokale ekonomike të cilat lidhen me mospagime të asetëve në grup.

2.7 Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet shprehen në koston historike minus zhvlerësimin e akumuluar dhe provigjionin për humbjet atëherë kur është e nevojshme.

Kostot vijuese përfshihen në shumën e bartur të asetit ose shprehen si një aset i veçantë, vetëm kur ekziston mundësia që përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhen me objektin do të rrjedhin në BPK dhe kostoja e objektit mund të llogaritet si duhet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtja ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Zhvlerësimi në pronë dhe pajisje llogaritet duke përdorur metodën lineare për alokimin e kostove të tyre në vlerën e tyre të mbetur gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar, si vijon:

Zhvlerësimi	Norma vjetore	Jetëgjatësia
Mjetet e transportit	20%	5 vite
Pajisje zyre dhe të tjera	20%	5 vite
Pajisje kompjuteri	33.3%	3 vite

Vlerat e mbetura të asetëve dhe jetëgjatësia e tyre rishikohen dhe axhustohen në mënyrën e duhur në çdo datë bilanci.

Prona dhe pajisjet rishikohen për humbje në rastet kur ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se shuma bartëse mund të mos jetë e rekuperueshme. Një shumë bartëse e asetit regjistrohet menjëherë në shumën e tij të rekuperueshme nëse shuma bartëse e asetit është më e madhe sesa shuma e vlerësuar e rekuperueshme. Shuma e rekuperueshme është më e lartë se vlera reale e asetit minus kostot e shitjes dhe vlerën në përdorim.

Fitimet dhe humbjet në dispozicion të pronës dhe pajisjeve shprehen në pasqyrën e të ardhurave në vitin e disponueshmërisë.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

2.8 Të ardhurat nga grantet

Grantet e pranuar me qëllim blerjen e pronës dhe pajisjeve, ose prona dhe pajisjet e dhëna si grant, regjistrohen në bilancin e gjendjes si grant i ardhshëm dhe njihen si të ardhura nga grantet në të njëjtën periudhë si kohëzgjatja e objektit të pronës dhe pajisjeve. Grantet e pranuar për financimin e shpenzimeve të BPK-së kreditohen drejtpërdrejtë në të ardhurat nga grantet në pasqyrën e të ardhurave në periudhën kur ka ndodhur ky shpenzim.

2.9 Pagat e financuara nga donatorët

Disa anëtarë të manaxhmentit të BPK-së janë ekspertë ndërkombëtarë të emëruar nga organizata ndërkombëtare, të cilat sigurojnë mbështetje financiare për BPK-në. Gjithashtu, këto organizata ndërkombëtare emërojnë ekspertë dhe konsulentë afatshkurtër sipas nevojave. Mbështetja financiare e këtyre organizatave financiare përfshin, por jo vetëm, pagesën e pagave të të emëruarëve të manaxhmentit dhe konsulentët. Duke qenë se kjo asistencë paguhet nga organizatat ndërkombëtare drejtpërdrejtë tek i emëruari, niveli i këtyre pagesave nuk njihet dhe ato nuk përfshihen në këto pasqyra financiare. Kohëzgjatja e emërimit të personelit të manaxhmentit nuk është tërësisht e përcaktuar, megjithëse objektivi i organizatave ndërkombëtare është që të emëruarit të zëvendësohen nga stafi vendor.

2.10 Veprimtaritë fiduciare

Në disa raste të veçanta, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës vepron si agjent fiskal dhe agjent pagues për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Asetet dhe të ardhurat që rezultojnë nga këto veprimtari përjashtohen nga këto pasqyra financiare ku Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës vepron si fiduciar, si p.sh. i emëruar ose agjent.

2.11 Vlera reale e instrumenteve financiare

Vlera reale është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion rrjedhës ndërmjet palëve, ndryshe nga një shitje e detyruar apo likuidim, dhe evidentohet më mirë nga një çmim i kuotuar tregu.

Asetet afatshkurtra të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës pasqyrohen në pasqyrat financiare në koston e cila i përfaqëson vlerën e tyre reale sepse këto instrumente kanë afate të shkurtra maturiteti dhe janë të këmbyeshme në para *cash* dhe shlyhen pa kosto të mëdha transaksioni.

Bonot e thesarit klasifikohen si asete financiare të përcaktuara në vlerë reale përmes fitimit ose humbjes. Vlera reale e vlerësuar përcaktohet duke përdorur çmimet e tregut ose kuotimet e brokerëve/agjentëve. Në rastet kur ky informacion nuk ekziston, vlera reale vlerësohet duke përdorur flukset e skontuara të parasë *cash* me norma interesi mbizotëruese për instrumentet me rrezik të ngjashëm kredie dhe maturitet të mbetur.

2.12 Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/20 datë 15 nëntor, 1999 (amenduar më 1 tetor, 2001) "Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës", Banka përjashtohet nga taksa mbi të ardhurat dhe i kërkohet me ligj që të paguajë çdo bilanc të të ardhurave të saj neto drejtpërdrejtë tek Ministria e Ekonomisë dhe Financave pas vendosjes për plotësimin e nivelit të fondeve rezervë drejtuar nga Bordi Drejtues.

2.13 Detyrimet financiare

Detyrimet financiare përfshijnë depozitat nga klientët dhe ato shprehen fillimisht në vlerën e tyre reale. Detyrimet financiare më pas shprehen në kosto të amortizuar; çdo diferencë ndërmjet të ardhurave neto të koston së transaksionit dhe vlerës së pagesës shprehet në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës së depozitës duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2.14 Rezerva e përgjithshme

Në përputhje me Rregulloren (e amenduar) të UNMIK-ut Nr. 1999/20, çdo vit BPK-ja do të derdhë të ardhurat neto në llogarinë e rezervës së përgjithshme deri sa kapitali dhe llogaritë e rezervës së përgjithshme arrijnë në 5% të shumës totale, shumë e bilanceve të kredisë së të gjitha llogarive të mbajtura në regjistrat e BPK-së nga llogari-mbajtësit të paraqitura në bilancin e gjendjes së BPK-së në fundin e çdo viti financiar.

2.15 Përfitimet e punonjësve

BPK-ja i jep shtetit kontribute në këmbim të shërbimit të dhënë një entiteti nga punonjësit gjatë një periudhe.

Gjithashtu, BPK-ja bën kontribute fikse të pagueshme në një fond të veçantë pensional, i cili mbahet nga BPK-ja. BPK-ja nuk ka detyrime ligjore të paguajë kontribute të tjera.

Detyrimet e BPK-së lidhur me pensionet më 31 dhjetor 2005 ishin 221 mijë euro (31 dhjetor 2004: 135 mijë euro).

2.16 Provigjionet

Provigjionet për ristrukturimin e kostove dhe pretendimet ligjore kryhen kur: BPK-ja ka një detyrim ligjor si rrjedhojë e ngjarjeve të kaluara; ka të ngjarë që për përmbushjen e detyrimit të nevojitet një dalje burimesh. Shuma është vlerësuar në mënyrë të besueshme.

2.17 Kompensimi

Asetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto raportohet në bilancin e gjendjes kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për të kompensuar shumën e caktuar në baza neto, ose përmbushur asetin dhe shlyer detyrimin në të njëjtën kohë.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

3. Manaxhimi i rrezikut financiar

Gjatë veprimtarisë së saj normale, BPK-ja është e ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh, ku më të rëndësishmet prej së cilave janë rreziqet operacionale, të kredisë, normës së interesit, likuiditetit dhe ato valutore. Struktura e asetëve dhe detyrimeve të BPK-së kryesisht përcaktohet më tepër nga natyra e funksioneve statutores të BPK-së sesa nga faktorët e natyrës komerciale. Manaxhimi i rrezikut të BPK-së rregullohet përmes udhëzimeve të saj të brendshme dhe ai monitorohet nga afër nga Bordi Drejtues dhe Komitetet e BPK-së.

3.1 Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes shkaktuar nga mosfunksionimi i kontrolleve të brendshme. BPK-ja e manaxhon këtë rrezik përmes Departamentit të Auditimit të Brendshëm të BPK-së, i cili ushtron kontroll mbi politikat dhe procedurat e kontabilitetit dhe funksionimin efektiv të sistemit të kontrolleve të brendshme të BPK-së.

Ndarja e detyrave ndërmjet departamenteve të ndryshme të BPK-së konsiderohet gjithashtu si një nga mekanizmat e manaxhimit të rrezikut operacional.

3.2 Rreziku i kredisë

BPK-ja është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që një palë nuk do të mundë të paguajë shumat e plota në kohën e caktuar.

Rreziku i kredisë manaxhohet përmes miratimit të transaksioneve dhe fondeve të plasmanit, përcaktimit të limiteve të cilat kufizojnë rrezikun dhe përmes monitorimit të vazhdueshëm të gjendjeve.

Palët pranohen vetëm kur ato kanë vlerësimet më të mira lidhur me kreditin dhe nëse iu nënshtrohen inspektimeve të rregullta të kreditit.

3.3 Rreziku i normës së interesit

BPK-ja është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit si rezultat i investimit në shuma në norma fikse dhe për periudha të cilat ndryshojnë nga ato të depozitave nga qeveria dhe klientëve të tjerë.

Rivlerësimi kontraktual i asetëve dhe detyrimeve nga bilanci i gjendjes së BPK-së korrespondon me datat e maturimit, për shkak se normat e interesit janë fikse. Një përmbledhje e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit mund të gjendet në tabelat e përfshira në rrezikun e likuiditetit.

Tabela e mëposhtme përmbledh normat efektive të interesit për instrumentet financiare monetare:

	2005	2004
Llogaritë rrjedhëse në bankat jorezidente	1.08%	1.14%
Depozitat me afat në bankat jorezidente	2.03%	1.99%
Bonot e thesarit	2.10%	2.07%
Detyrimet ndaj bankave vendore	1%	1%
Detyrimte ndaj institucioneve qeveritare	1%	1%
Detyrimet ndaj entiteteve publike dhe tregtare	1%	1%
Depozitat me afat të entiteteve publike dhe tregtare	1.84%	1.87%

3.4 Rreziku i likuiditetit

BPK-ja është e ekspozuar ndaj kërkesave të përditshme mbi burimet e saj të disponueshme të parave *cash* nga llogaritë rrjedhëse. BPK-ja nuk mban burime të parave *cash* për të plotësuar të gjitha nevojat e mundshme, pasi përvoja tregon se një nivel minimal i riinvestimit të fondeve në maturim mund të parashikohet me një nivel të lartë sigurie. Bordi përcakton limitet mbi nivelin minimal të fondeve në maturim të disponueshme për të plotësuar kërkesa të tilla dhe mbi nivelin minimal të parave *cash* në dispozicion, të cilat duhet të jenë për të mbuluar tërheqjet në nivele të papritura të kërkesës.

Tabela e mëposhtme analizon asetet dhe detyrimet e BPK-së në grupe maturimi përkatëse bazuar në periudhën e mbetur në datën e bilancit të gjendjes ndaj datës së maturimit kontraktual:

Më 31 dhjetor 2005	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 deri në 5 vite	Total
Asete					
Paraja <i>cash</i>	24,464	-	-	-	24,464
Llogaritë rrjedhëse në bankat jorezidente	23,765	-	-	-	23,765
Llogaritë depozituese në bankat jorezidente	190,633	-	-	-	190,633
Bonot e thesarit	44,943	69,722	44,604	-	159,269
Prona dhe pajisjet	-	-	-	494	494
Asete të tjera	790	-	-	-	790
Totali i aseteve	284,595	69,722	44,604	494	399,415

Detyrimet

Detyrimet ndaj bankave vendore	82,518				82,518
-----------------------------------	--------	--	--	--	--------

3.4 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare	229,891				229,891
Detyrimet ndaj entiteteve publike dhe tregtare	60,026	4,100			64,126
Detyrime të tjera	<u>3,158</u>				<u>3,158</u>
Totali i detyrimeve	<u>375,593</u>	<u>4,100</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>379,693</u>

Gepi neto i likuiditetit	<u>(90,998)</u>	<u>65,622</u>	<u>44,604</u>	<u>494</u>	<u>19,722</u>
---------------------------------	-----------------	---------------	---------------	------------	---------------

Më 31 dhjetor 2004	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 deri në 5 vite	Total
Asete					
Paraja <i>cash</i>	12,064	-	-	-	12,064
Llogaritë rrjedhëse në bankat jorezidente	8,929	-	-	-	8,929
Llogaritë depozituese në bankat jorezidente	27,121	174,859	2,500	-	204,480
Bonot e thesarit	24,974	44,846	54,598	-	124,418
Prona dhe pajisjet	-	-	-	665	665
Asete të tjera	<u>111</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>111</u>
Totali i aseteve	<u>73,199</u>	<u>219,705</u>	<u>57,098</u>	<u>665</u>	<u>350,667</u>

Detyrimet

Detyrimet ndaj bankave vendore	72,899	-	-	-	72,899
Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare	225,209	-	-	-	225,209
Detyrimet ndaj entiteteve publike dhe tregtare	27,704	3,005	2,117	-	32,826
Detyrime të tjera	<u>2,220</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>2,220</u>
Totali i detyrimeve	<u>328,032</u>	<u>3,005</u>	<u>2,117</u>	<u>-</u>	<u>333,154</u>

Gepi neto i likuiditetit	<u>(254,833)</u>	<u>216,700</u>	<u>54,981</u>	<u>665</u>	<u>17,513</u>
---------------------------------	------------------	----------------	---------------	------------	---------------

3.5 Rreziku i valutës

Rreziku i valutës është rreziku që mund të ndodhë nëse vlera e instrumenteve financiare do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e këmbimit valutor.

Përveç vlerave të papërfillshme, asetet dhe detyrimet e BPK-së përgjithësisht denominohen në monedhën euro; për këtë arsye BPK-ja nuk është mjaft e ekspozuar ndaj rrezikut valutor.

Me qëllim paraqitjen e pasqyrës së fluksit të parasë, paraja *cash* dhe ekuivalentët e saj përfshijnë bilancet e mëposhtme me maturitet më pak se 90 ditë:

	2005	2004
Paraja <i>cash</i>	24,464	12,094
Llogaritë rrjedhëse në bankat jorezidente	23,765	8,929
Bonot e thesarit	<u>159,269</u>	<u>124,418</u>
	<u>207,498</u>	<u>145,411</u>

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)**Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005**

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

4 Llogaritë rrjedhëse në bankat jorezidente

	2005	2004
Deutsche Bundesbank	22,788	8,597
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	2	90
Commerzbank AG	851	10
Svenska Handelsbanken	33	162
Dresdner Bank	91	70
	<u>23,765</u>	<u>8,929</u>

Më 31 dhjetor 2005 llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja denominohen në euro dhe bartin interes nga 1% në 1.08% (31 dhjetor 2004: 1% dhe 1.06%).

5 Bonot e thesarit

Bonot e thesarit janë letra me vlerë të borxhit të skontuara të emetuara nga vendet e BE-së për një periudhë tremujore, gjashtëmujore ose një vit. Të gjitha bonot denominohen në euro dhe nëse mbahen në maturitet kanë një *yield* që varion nga 2% në 2.44% (2004: nga 2.04% në 2.14%).

6 Llogaritë e depozitave në bankat jorezidente

	2005	2004
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	33,507	8,703
Commerzbank AG	500	1,100
Dresdner Bank	15,411	25,219
Deutsche Bundesbank	5,002	10,010
ING Bank	33,663	34,360
KBC	21,499	32,391
Rabobank	8,344	13,181
Svenska Handelsbanken	36,020	39,420
HBOS Treasury Services Plc	29,402	27,908
Danske Bank	7,285	12,188
	<u>190,633</u>	<u>204,480</u>

Më 31 dhjetor 2005, depozitat në bankat e huaja denominohen në euro dhe bartin interes nga 1.95% në 2.4% (31 dhjetor 2004: nga 1.92% në 2.20%).

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)**Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005**

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

7 Prona dhe pajisjet

	Pajisjet	Kompjuter dhe Software	Automjete	Asete në ndërtim	Total
Më 1 Janar 2004					
Kostoja	457	1,016	83	-	1,556
Zhvlerësimi i akumuluar	(160)	(483)	(18)	-	(661)
Shuma neto e regjistruar	297	533	65	-	895
31 dhjetor 2004					
Shuma fillestare neto e regjistruar	297	533	65	-	895
Shtesat	12	17	-	112	141
Shitjet	-	-	-	-	-
Tarifa e zhvlerësimit	(93)	(260)	(18)	-	(371)
Shuma neto e mbyllur e regjistruar	216	290	47	112	665
31 dhjetor 2004					
Kostoja	469	1,033	83	112	1,697
Zhvlerësimi i akumuluar	(253)	(743)	(36)	-	(1,032)
Shuma neto e regjistruar	216	290	47	112	665
31 dhjetor 2005					
Shuma fillestare neto e regjistruar	216	290	47	112	665
Shtesat	-	206	-	137	343
Transfertat	-	45	-	(45)	-
Shitjet	(4)	-	(1)	(143)	(148)
Tarifa e zhvlerësimit	(83)	(264)	(19)	-	(366)
Shuma neto e mbyllur e regjistruar	(129)	(277)	(27)	61	494
31 dhjetor 2005					
Kostoja	465	848	82	61	1,456
Zhvlerësimi i akumuluar	(336)	(571)	(55)	-	(962)
Shuma neto e regjistruar	129	277	27	61	494

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)**Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005**

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

8 Asete të tjera

	2005	2004	
Subvencion i Ministrisë së Financave	413	-	
Të ardhura të përlogaritura	335	55	
Llogari për t'u arkëtuar dhe parapagesa	42	56	
	<u>790</u>	<u>111</u>	

9 Detyrimet ndaj bankave vendore

	2005	2004
Banka ProCredit	11,812	14,916
Banka e Re e Kosovës	2,455	2,486
Banka për Biznes	2,108	2,022
Banka Raiffeisen e Kosovës (ish Banka Amerikane e Kosovës)	7,833	6,370
Banka Ekonomike e Kosovës	1,818	1,451
Banka Kreditore e Prishtinës	1,281	2,456
Kasabank	4,875	3,590
Totali i rezervave të detyrueshme të likuiditetit	<u>32,182</u>	<u>33,291</u>
Banka ProCredit	14,627	9,238
Banka e Re e Kosovës	4,461	9,119
Banka për Biznes	3,362	5,872
Banka Raiffeisen e Kosovës (ish Banka Amerikane e Kosovës)	7,864	4,279
Banka Ekonomike e Kosovës	4,905	3,484
Banka Kreditore e Prishtinës	2,394	3,238
Kasabank	12,723	4,378
Totali i llogarive rrjedhëse	<u>50,336</u>	<u>39,608</u>
Totali	<u>82,518</u>	<u>72,899</u>

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)**Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005**

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

Sipas Rregullës XVII të mbikëqyrjes së BPK-së, bankave të nivelit të dytë në Kosovë iu kërkohet të mbajnë rezerva likuiditeti në vlerën 10% të totalit të depozitave të klientëve përkatës të tyre. Të paktën gjysma e këtyre bilanceve rezervë duhet të mbahet në llogari në BPK.

Bilancet e rezervës më shumë se 5%, deri në 10%, të totalit të depozitave të klientëve bartin interes prej 1% më 31 dhjetor 2005 (31 dhjetor 2004: 1%). Shumat nën 5% dhe mbi 10% nuk bartin interes.

10 Detyrimet ndaj institucioneve vendore qeveritare

	2005	2004
UNMIK	3,099	5,179
Thesari i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dogana dhe taksat	113,021	172,606
Detyrimet ndaj komunave të qeverive vendore	-	674
Detyrimet ndaj institucioneve të tjera qeveritare	266	14,000
Detyrimet ndaj Agjencisë së Trustit Kosovar	113,132	32,750
Totali	<u>229,891</u>	<u>225,209</u>

11 Detyrimet ndaj entiteteve publike dhe tregtare

	2005	2004
Kompanitë e Sigurimeve	18,218	17,529
Korporatat e shërbimeve publike	37,584	12,055
Fondet pensionale të entiteteve tregtare duke përfshirë fondet pensionale të BPK-së	8,322	3,232
Të tjera	2	10
Totali	<u>64,126</u>	<u>32,826</u>

Norma e interesit e aplikuar në llogaritë rrjedhëse më 31 dhjetor 2005 ishte 1% (31 dhjetor 2004: 1%).

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)**Pasqyrat Financiare deri më 31 dhjetor 2005**

(të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijë euro, nëse nuk ceket ndryshe)

12 Detyrimet e tjera të brendshme

	2005	2004
Detyrimet ndaj Qeverisë (Shënim a) 1,189		1,697
Të ardhurat e shtyra nga grantet (Shënim b) 469		570
Detyrimet ndaj ish Bankës Kombëtare të Kosovës (Shënim c) 450		450
Kreditorët dhe përlllogaritjet e ndryshme 77		406
Detyrime të tjera të brendshme 35		<u>35</u>
Totali <u>2,220</u>		<u>3,158</u>

Shënim a: Më 31 dhjetor 2005, detyrimet ndaj Qeverisë përfshijnë 1,285 mijë euro qera e arkëtuar për ndërtesat publike deri në vendosjen e pronësisë (31 dhjetor 2004: 872 mijë euro) dhe 408 mijë euro gjoba të arkëtuara nga mbikëqyrja (31 dhjetor 2004: 313 mijë euro).

Shënim b:

Totali	CFA	USAID	Të	tjera
Të ardhurat e shtyra nga grantet më 1 janar 2004	597	101	21	719
Transfertat në të ardhurat nga grantet (211)	(211)	(26)	(13)	(250)
Të ardhurat e shtyra nga grantet më 31 dhjetor 2004	386	75	8	469
Grantet e pranuar gjatë vitit	20	-	300	319
Transfertat në të ardhurat nga grantet (167)	(167)	(25)	(26)	(218)
Të ardhurat e shtyra nga grantet më 31 dhjetor 2005	<u>238</u>	<u>50</u>	<u>282</u>	<u>570</u>

Shënim c: Vlera e detyrimeve ndaj Bankës Kombëtare të Kosovës lidhet me bilancet e parasë *cash* në valuta të ndryshme të cilat i përkasin atij entiteti, të cilat ishin fizikisht të gatshme në fillim të Bankës. Këto bilance u konvertuan në markën gjermane më 22 dhjetor 2000, u transferuan fizikisht në Commerzbank AG në Frankfurt dhe u përfshinë në bilancin e llogarisë korrente të BPK-së në atë entitet.

13 Fondi statutor

